



PLANI VENDOR I SHËRBIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Bashkia Skrapar

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	9
1. Hyrje dhe metodologjia e hartimit të planit	9
1.1 Qëllimi i Planit Vendor të shërbimit të Arsimit Parauniversitar	9
1.2 Objekti dhe periudha e planifikimit 2027–2029	9
1.3 Metodologjia e përdorur për hartimin e planit	10
1.4 Burimet e të dhënave dhe anekset e përdorura	10
1.5 Procesi i konsultimit institucional dhe publik	10
2. Profili administrativ, demografik dhe social i Bashkisë Skrapar	11
2.1 Pozicioni gjeografik dhe karakteristikat territoriale	11
2.2 Njësitë administrative dhe vendbanimet që mbulohen	11
2.3 Popullsia sipas njësive administrative	12
2.4 Popullsia sipas grupmoshave arsimore	12
2.5 Profili social dhe grupet në nevojë	13
2.6 Implikimet e profilit territorial dhe demografik për planifikimin arsimor	13
3. Kuadri ligjor dhe institucional	14
3.1 E drejta për arsim dhe detyrimet publike	14
3.2 Përgjegjësitë e bashkisë në arsimin parashkollor	15
3.3 Roli mbështetës i bashkisë në arsimin bazë dhe të mesëm	15
3.4 Roli i ZVA-së dhe institucioneve arsimore	16
3.5 Mbrojtja e fëmijës dhe shërbimet sociale në mbështetje të arsimit	16
3.6 Financimi vendor dhe lidhja me PBA-në	17
3.7 Strukturat pjesëmarrëse: bordet, këshillat e prindërve dhe komisionet e sigurisë	17
3.8 Përgjegjësitë institucionale për zbatimin e planit	18
4. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor	19
4.1 Rrjeti i kopshteve në Bashkinë Skrapar	19
4.2 Shpërndarja e kopshteve sipas njësive administrative	19
4.3 Regjistrimi dhe frekuentimi i fëmijëve në kopshte	20
4.4 Grupet, kapaciteti dhe organizimi i shërbimit	20
4.5 Fëmijët nga grupet vulnerabël dhe mbështetja sociale	21
4.6 Burimet njerëzore në kopshte	21
4.7 Infrastruktura, mobilimi dhe kushtet fizike	22
4.8 Aksesit, shërbimet bazë dhe siguria	22

4.9 Shëndeti, higjiena dhe ushqimi në kopshte	23
4.10 Mjetet didaktike, pajisjet dhe TIK	23
4.11 Bordi, këshilli i prindërve dhe pjesëmarrja komunitare	24
4.12 Problematikat kryesore dhe nevojat për ndërhyrje	25
4.13 Gjetje kryesore për arsimin parashkollor	25
4.14 Tabela SWOT për arsimin parashkollor	26
5. Analiza e shërbimit të arsimit bazë dhe të mesëm	27
5.1 Rrjeti i shkollave në Bashkinë Skrapar	27
5.2 Shpërndarja e shkollave sipas njësive administrative	27
5.3 Nxënësit sipas nivelit, klasës dhe gjinisë	28
5.4 Frekuentimi dhe nxënësit me mungesa të larta	29
5.5 Nxënësit nga grupet vulnerabël dhe masat mbështetëse	29
5.6 Stafi mbështetës dhe shërbimet në shkolla	29
5.7 Infrastruktura dhe kapaciteti fizik i shkollave	30
5.8 Aksesit, shërbimet bazë dhe siguria në shkolla	31
5.9 Pajisjet, mobilimi, mjetet didaktike dhe TIK	31
5.10 Transporti, bursat dhe masat kundër braktisjes	32
5.11 Bordi i shkollës, këshilli i prindërve dhe pjesëmarrja	33
5.12 Problematikat kryesore dhe nevojat për ndërhyrje	33
5.13 Gjetje kryesore për arsimin bazë dhe të mesëm	34
5.14 Tabela SWOT për arsimin bazë dhe të mesëm	35
6. Analiza sipas njësive administrative	36
6.1 Qëllimi i analizës territoriale	36
6.2 Njësia Administrative Çorovodë	36
6.3 Njësia Administrative Qendër Skrapar	37
6.4 Njësia Administrative Bogovë	37
6.5 Njësia Administrative Gjerbës	37
6.6 Njësia Administrative Leshnjë	37
6.7 Njësia Administrative Potom	37
6.8 Njësia Administrative Çepan	38
6.9 Njësia Administrative Zhepë	38
6.10 Njësia Administrative Vëndreshë	38
6.11 Tipologjia e nevojave sipas njësive administrative	38
6.12 Planifikimi territorial të shërbimit arsimor	39
7. Qendra Kulturore e Fëmijëve “Meleq Staravecka”	39

7.1 Roli i Qendrës Kulturore të Fëmijëve në arsimin parauniversitar	39
7.2 Kurset dhe pjesëmarrja e fëmijëve	39
7.3 Kalendari vjetor i aktiviteteve	40
7.4 Kontributi i QKF-së në zhvillimin e fëmijëve	41
7.5 Bashkëpunimi me shkollat, kopshtet dhe komunitetin	41
7.6 Çështje për vëmendje dhe nevoja për përmirësim	41
7.7 Drejtimit prioritarë për periudhën e planit	42
8. Analiza dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve në kopshte dhe shkolla	43
8.1 Qëllimi i prioritarizimit	43
8.2 Kriteret e prioritarizimit	43
8.3 Klasifikimi i ndërhyrjeve sipas urgjencës	43
8.4 Ndërhyrjet prioritare në kopshte	44
8.5 Ndërhyrjet prioritare në shkolla	45
8.6 Ndërhyrjet për siguri, higjienë dhe akses PAK	45
8.7 Ndërhyrjet për pajisje, mobilim, TIK dhe mjete didaktike	46
8.8 Prioritetet territoriale sipas njësive administrative	47
8.9 Lidhja e ndërhyrjeve me buxhetin dhe PBA-në	47
9. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe rezultatet	48
9.1 Vizioni i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar	48
9.2 Qëllimi strategjik 1: Përmirësimi i kushteve fizike, sigurisë dhe higjienës	48
9.3 Qëllimi strategjik 2: Rritja e aksesit dhe gjithëpërfshirjes	49
9.4 Qëllimi strategjik 3: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit edukativ	50
9.5 Qëllimi strategjik 4: Forcimi i menaxhimit vendor, të dhënave dhe pjesëmarrjes	51
9.6 Qëllimi strategjik 5: Forcimi i rolit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve në zhvillimin artistik, kulturor, sportiv dhe social të fëmijëve	52
9.7 Rezultatet e pritshme deri në vitin 2029	53
10. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të arsimit parauniversitar	54
10.1 Qëllimi i planifikimit buxhetor	54
10.2 Programet buxhetore që lidhen me arsimin parauniversitar	55
10.3 Shpenzimet për arsimin bazë dhe parashkollor	55
10.4 Shpenzimet për arsimin e mesëm të përgjithshëm	56
10.5 Shpenzimet për konviktin/QKF	56
10.6 Shpenzimet operative: mirëmbajtje, higjienë, energji, ujë, ngrohje	57
10.7 Shpenzimet për bursa dhe mbështetje sociale	57
10.8 Shpenzimet për materiale didaktike, TIK dhe pajisje	58

11. Plani i veprimit 2027–2029	58
11.1 Qëllimi i planit të veprimit	58
11.2 Matrica e aktiviteteve sipas qëllimeve strategjike	58
11.3 Plani sipas viteve: 2027, 2028, 2029	69
11.4 Treguesit kryesorë të zbatimit	70
12. Plani i investimeve kapitale	72
12.1 Qëllimi i planit të investimeve kapitale	72
12.2 Prioritarizimi i investimeve sipas viteve 2027–2029	72
12.3 Burimet e mundshme të financimit	72
13. Monitorimi dhe vlerësimi	73
13.1 Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit	73
13.2 Struktura përgjegjëse për monitorimin	73
13.3 Treguesit kryesorë të monitorimit	73
13.4 Raportimi vjetor i progresit	74
13.5 Vlerësimi i ndikimit në akses, siguri dhe cilësi	75
13.6 Përfshirja e shkollave, kopshteve, ZVA-së dhe komunitetit në monitorim	75
14. Rishikimi dhe përshtatja e planit	76
14.1 Procesi i rishikimit vjetor	76
14.2 Lidhja me procesin e buxhetit dhe PBA-së	76
14.3 Përditësimi i të dhënave dhe prioriteteve	76
14.4 Përshtatja e masave sipas ndryshimeve demografike, financiare dhe infrastrukturore	77
14.5 Miratimi i ndryshimeve nga strukturat vendore	77
15. Raportimi dhe transparenca	77
15.1 Raportimi në Këshillin Bashkiak	77
15.2 Publikimi i planit dhe raporteve të zbatimit	78
15.3 Konsultimi me prindërit, shkollat, kopshtet dhe komunitetin	78
15.4 Transparenca mbi investimet, mirëmbajtjen dhe shpenzimet	78
15.5 Mekanizmat e reagimit dhe propozimeve nga komuniteti	79
16. Anekset	80
Aneks A1. Përmbledhje e Kuadrit ligjor dhe nënligjor për arsimin parauniversitar	80
Aneks A2. Pasqyrë e popullsisë dhe territorit sipas të dhënave territoriale	81
Aneks 3. Të dhëna administrative dhe territoriale sipas njësive administrative (burimi - CENSI i Popullsisë viti 2023)	81
Aneks A4. Të dhëna për fëmijët/nxënësit jashtë sistemit ose në risk	82
Tabela e të dhënave për kopshtet	83

Aneks B. Përmbledhje e të dhënave sipas kopshtit / grupit	83
Aneks B1. Identifikimi i kopshtit	84
Aneks B2. Regjistrimi dhe frekuentimi i fëmijëve sipas moshës dhe gjinisë	84
Aneks B3. Grupet, kapaciteti dhe mbingarkesa	86
Aneks B4. Fëmijë nga grupe vulnerabël dhe mbështetja sociale	87
Aneks B5. Stafi i kopshtit dhe nevojat për burime njerëzore	87
Aneks B6. Infrastruktura, kapaciteti fizik dhe mobilimi	87
Aneks B7. Aksesit, shërbimet bazë dhe siguria	88
Aneks B8. Shëndeti, ushqimi, higjiena dhe siguria ushqimore	88
Aneks B9. Mjete didaktike, pajisje dhe TIK	89
Aneks B10. Bordi, këshilli i prindërve dhe KSHS (Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit)	89
Tabela e të dhënave për shkollat	90
Aneks C1. Të dhëna për shkollat	90
Aneks C2. Nxënësit sipas klasës, nivelit dhe gjinisë	93
Aneks C3. Nxënës nga grupe vulnerabël dhe mbështetja	96
Aneks C4. Stafi mbështetës dhe shërbimet në shkollë	97
Aneks C5. Infrastruktura fizike dhe kapaciteti fizik i shkollës	99
Aneks C6. Aksesit, shërbimet bazë dhe siguria në shkollë	101
Aneks C7. Pajisje, mobilim, mjete didaktike dhe TIK	104
Aneks C8. Bordi i shkollës, këshilli i prindërve dhe pjesëmarrja	107
Aneks C9. Transporti, konvikti, bursa dhe masa kundër braktisjes	110
Aneks C10. Problematikat dhe nevojat për ndërhyrje në shkollë	111
Qendra Kulturore e Fëmijëve – Viti shkollor 2025–2026	113
Aneks F1. Regjistrimet sipas kursit	113
Aneks F2. Renditja e kurseve sipas numrit të regjistrimeve	113
Aneks F3. Përmbledhje sipas fushës së aktivitetit	114
Aneks F4. Tregues statistikorë për përdorim në plan	114
Aneks D1: Buxheti në lekë për arsimin bazë përfshirë arsimin parashkollor	115
Aneks D2: Buxheti në lekë për arsimin e mesëm	117
Aneks D3: Buxheti në lekë për mbështetjen e shërbimit të konviktit	119
Aneks D4: Buxheti në lekë për funksionimin e konviktit	120
Aneks D5: Përmbledhje e buxhetit në lekë:	120
Aneks E1: Të dhëna për numrin e stafit edukator dhe shërbimeve mbështetëse në arsimin parauniversitar	122

Aneks E2: Buxheti në lekë për garantimine funksionimit dhe shërbimit të stafit në institucionet e arsimit parauniversitar.....	122
Aneks: Matrica e trajtimit të komenteve nga konsultimi publik.....	124

Falënderime

Bashkia Skrapar shpreh falënderimet e saj për grupin e punës së bashkisë, i cili u angazhua në mbledhjen, sistemimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme për hartimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar. Kontributi i strukturave vendore, i njësive përgjegjëse për arsimin, shërbimet sociale, financën, shërbimet publike dhe institucioneve arsimore ka qenë i rëndësishëm për të ndërtuar një dokument të mbështetur në të dhëna konkrete dhe në nevojat reale të kopshteve, shkollave, fëmijëve, nxënësve dhe komunitetit.

Falënderime të veçanta i drejtohen Këshillit Bashkiak Skrapar dhe Komisionit të Arsimit pranë Këshillit Bashkiak për mbështetjen institucionale, orientimin dhe angazhimin në procesin e konsultimit publik.

Gjithashtu, Bashkia Skrapar falënderon Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë për mbështetjen teknike të ofruar gjatë hartimit të planit, si dhe për kontributin në strukturimin e procesit, analizën e të dhënave dhe formulimin e prioriteteve për zhvillimin e shërbimit të arsimit parauniversitar në nivel vendor.



Të dashur qytetarë të Bashkisë Skrapar,
të nderuar prindër, mësues, edukatorë, nxënës dhe përfaqësues të
komunitetit,

Arsimi është një nga përgjegjësitë më të rëndësishme publike dhe një nga investimet më të vlefshme që mund të bëjmë për të ardhmen e fëmijëve dhe të rinjve tanë. Për një bashki si Skrapari, me territor të gjerë, relief malor, fshatra të shpërndara dhe komunitete me nevoja të ndryshme, garantimi i një shërbimi arsimor të aksesueshëm, të sigurt dhe cilësor është një detyrë që kërkon vëmendje të vazhdueshme, bashkëpunim dhe planifikim të kujdesshëm.

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar 2027–2029 është dokumenti që orienton punën tonë për përmirësimin e kushteve në kopshte, shkolla dhe konvikt. Ai bazohet në të dhënat e mbledhura nga institucionet arsimore, në nevojat e evidentuara në territor dhe në prioritetet që lidhen me sigurinë, higjienën, aksesin, transportin, gjithëpërfshirjen dhe mbështetjen e fëmijëve e nxënësve që kanë më shumë nevojë.

Ky plan nuk është thjesht një dokument teknik. Ai është një angazhim i Bashkisë Skrapar për të qenë më pranë institucioneve arsimore, më pranë familjeve dhe më pranë çdo fëmije, pavarësisht nëse jeton në qytetin e Çorovodës apo në një fshat të largët të bashkisë. Për ne, çdo shkollë dhe çdo kopsht ka rëndësi, sepse aty nis zhvillimi i fëmijëve, forcohet lidhja me komunitetin dhe ndërtohet besimi për të ardhmen.

Gjatë viteve 2027–2029, prioriteti ynë do të jetë përmirësimi gradual i kushteve fizike në institucionet arsimore, me fokus të veçantë te tualetet, higjiena, siguria, rrethimi, ndriçimi, aksesueshmëria dhe mirëmbajtja e objekteve. Po ashtu, do të vijojmë të mbështesim transportin, bursat, konviktin dhe masat që ndihmojnë nxënësit nga zonat e largëta apo familjet në nevojë të ndjekin arsimin pa ndërprerje.

Një pjesë e rëndësishme e këtij plani është bashkëpunimi me Zyrën Vendore Arsimore, drejtuesit e shkollave dhe kopshteve, mësuesit, edukatorët, prindërit dhe komunitetin. Vetëm përmes këtij bashkëpunimi mund të kemi të dhëna më të sakta, vendimmarrje më të mirë dhe ndërhyrje më të drejta në territor.

Bashkia Skrapar do ta përdorë këtë plan si udhërrëfyes për buxhetimin, përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe ndjekjen e investimeve në arsim. Çdo vit, prioritetet do të rishikohen sipas nevojave reale, mundësive financiare dhe ndryshimeve që ndodhin në komunitet.

Falënderoj të gjithë ata që kontribuuan në hartimin e këtij plani: drejtuesit e institucioneve arsimore, mësuesit, edukatorët, administratën e bashkisë, ZVA-në, prindërit dhe partnerët mbështetës. Kontributi i secilit është i rëndësishëm për të ndërtuar një shërbim arsimor më të mirë, më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës.

Me këtë plan, Bashkia Skrapar rikonfirmon angazhimin e saj për të mbështetur arsimin parauniversitar si një prioritet vendor dhe si një investim të drejtpërdrejtë në të ardhmen e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve tona.

Kryetari

Adriatik Mema

Përmbledhje ekzekutive

Plani Vendor i Shërbimit të Arsimit Parauniversitar 2027–2029 për Bashkinë Skrapar është dokumenti kryesor orientues për planifikimin, përmirësimin dhe monitorimin e shërbimit arsimor në territorin e bashkisë. Ai mbështetet në të dhënat e mbledhura nga Bashkia, kopshtet, shkollat, gjimnazi, konvikti dhe dokumentet buxhetore/PBA.

Plani merr në konsideratë karakterin e veçantë të Skraparit: një territor i gjerë, kryesisht rural dhe malor, me fshatra të shpërndara dhe me sfida të dukshme për aksesin në arsim. Për këtë arsye, dokumenti nuk fokusohet vetëm te numri i fëmijëve dhe nxënësve, por edhe te distanca, transporti, kushtet fizike, siguria, higjiena, konvikti, grupet në nevojë dhe roli që çdo kopsht apo shkollë ka për komunitetin.

Nga analiza rezulton se prioritetet kryesore për periudhën 2027–2029 janë: përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare, rritja e sigorisë në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtja e objekteve, mbështetja e transportit dhe konviktit, pajisja e kopshteve me mjete didaktike bazë, si dhe forcimi i koordinimit ndërmjet Bashkisë, ZVA-së, institucioneve arsimore dhe komunitetit.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet shkollave dhe grupeve parashkollore në zonat rurale, të cilat edhe kur kanë numër të ulët fëmijësh apo nxënësish, mbeten të rëndësishme për garantimin e aksesit në arsim. Plani synon që ndërhyrjet të jenë të lidhura me buxhetin vendor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm, në mënyrë që prioritetet të kthehen në masa konkrete dhe të monitorueshme.

Zbatimi i planit kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm institucional, përditësim të të dhënave çdo vit, konsultim me komunitetin dhe raportim të rregullt në Këshillin Bashkiak. Në këtë mënyrë, plani shërben si instrument praktik për përmirësimin gradual të arsimit parauniversitar në Bashkinë Skrapar.

1. Hyrje dhe metodologjia e hartimit të planit

1.1 Qëllimi i Planit Vendor të shërbimit të Arsimit Parauniversitar

Qëllimi i Planit Vendor të shërbimit të Arsimit Parauniversitar është të përcaktojë drejtimet kryesore për përmirësimin e shërbimit arsimor në Bashkinë Skrapar gjatë periudhës 2027–2029. Plani synon të ndihmojë Bashkinë në planifikimin më të mirë të ndërhyrjeve në kopshte, shkolla dhe konvikt, duke u mbështetur në të dhëna konkrete dhe në nevojat reale të territorit.

Në qendër të planit janë fëmijët dhe nxënësit. Dokumenti synon të garantojë që çdo fëmijë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve sociale, të ketë mundësi të ndjekë arsimin në kushte më të sigurt, më të përshtatshme dhe më dinjitoze.

1.2 Objekti dhe periudha e planifikimit 2027–2029

Ky plan mbulon shërbimin e arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë Skrapar, duke përfshirë arsimin parashkollor, arsimin bazë, arsimin e mesëm të përgjithshëm, arsimin me kohë të pjesshme dhe shërbimin e konviktit.

Periudha e planifikimit është 2027–2029. Kjo periudhë lidhet me nevojën për të përfshirë masat prioritare në buxhetin vendor dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm. Planit është konceptuar si dokument i përditësueshëm, që mund të rishikohet çdo vit në bazë të ndryshimeve demografike, buxhetore, infrastrukturore dhe institucionale.

1.3 Metodologjia e përdorur për hartimin e planit

Hartimi i planit është mbështetur në analizën e të dhënave të mbledhura nga Bashkia Skrapar, kopshtet, shkollat, gjimnazi dhe konvikti. Të dhënat janë analizuar sipas disa fushave kryesore: rrjeti i institucioneve, numri i fëmijëve dhe nxënësve, stafi, infrastruktura, siguria, higjiena, transporti, bursat, konvikti, pajisjet, grupet vulnerabël dhe nevojat për ndërhyrje.

Metodologjia ka ndjekur këto hapa:

- mbledhja e të dhënave nga formularët e plotësuar;
- verifikimi i të dhënave kryesore dhe evidentimi i mospërputhjeve;
- analiza e situatës sipas kopshteve, shkollave dhe njësive administrative;
- identifikimi i problematikave kryesore;
- prioritarizimi i ndërhyrjeve sipas urgjencës;
- lidhja e nevojave me buxhetin dhe PBA-në;
- formulimi i vizionit, qëllimeve strategjike dhe planit të veprimit.

1.4 Burimet e të dhënave dhe anekset e përdorura

Burimet kryesore të të dhënave janë tabelat e plotësuar nga Bashkia Skrapar, tabelat për çdo kopsht, tabelat për çdo shkollë, të dhënat për gjimnazin dhe konviktin, si dhe dokumentet buxhetore të lidhura me arsimin.

Në hartimin e planit janë përdorur këto grupe aneksesh:

- Anekset A, bashkëngjitur;
- Anekset B, bashkëngjitur;
- Anekset C, bashkëngjitur;
- Anekset D, bashkëngjitur;
- Anekset E, bashkëngjitur;

1.5 Procesi i konsultimit institucional dhe publik

Konsultimi publik për Planin Vendor të Shërbimit të Arsimit Parauniversitar të Bashkisë Skrapar u zhvillua në datën 16.07.2026, ora 10:00, në Sallën e Këshillit Bashkiak, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bashkisë, Nënprefektit, drejtuesve dhe mësuesve të institucioneve arsimore, përfaqësuesve të institucioneve vendore, prindërve dhe qytetarëve. Gjatë takimit u prezantuan përmbajtja kryesore e planit, gjendja aktuale, prioritetet dhe objektivat strategjike për periudhën 2027–2029.

Komentet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë konsultimit u fokusuan kryesisht në forcimin e rolit të konviktit, mundësinë e zhvillimit të arsimit profesional, përmirësimin e sigurisë dhe rrethimit në shkolla,

përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, nevojën për materiale didaktike në arsimin parashkollor, mbështetjen psiko-sociale në parashkollor, nxitjen e leximit përmes bibliotekës dhe menaxhimit më të mirë të përdorimit të telefonave/pajisjeve personale në shkolla. Këto propozime janë marrë në konsideratë në finalizimin e planit dhe janë pasqyruar në objektivat, planin e veprimit, treguesit e zbatimit dhe masat e monitorimit.

2. Profili administrativ, demografik dhe social i Bashkisë Skrapar

2.1 Pozicioni gjeografik dhe karakteristikat territoriale

Bashkia Skrapar ndodhet në pjesën juglindore të Qarkut Berat, me qendër administrative qytetin e Çorovodës. Ajo kufizohet në veri me Bashkinë Gramsh, në lindje me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkitë Këlcyrë dhe Përmet, ndërsa në perëndim me Bashkinë Poliçan. Ky pozicion e vendos Skraparin në një territor ndërmjet qendrave urbane të qarkut Berat, zonave malore të juglindjes dhe korridoreve natyrore që lidhen me luginën e Osunit dhe Malin e Tomorrit.

Bashkia ka sipërfaqe të gjerë territoriale, rreth 833 km², dhe karakter të theksuar rural e malor. Territori përbëhet kryesisht nga kodra, male, lugina dhe zona me shpërndarje të madhe të vendbanimeve. Sipas të dhënave të bashkisë, rreth 66.5% e territorit ndodhet në lartësinë 400–1000 m, 27.5% në lartësinë 1000–2000 m dhe vetëm 4.2% deri në 400 m. Kjo strukturë gjeografike ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, përfshirë shërbimin arsimor.

Një tipar i rëndësishëm territorial është shpërndarja e vendbanimeve në shumë fshatra të vegjël, shpesh të vendosur në zona të largëta ose me lidhje të kufizuara rrugore ndërmjet tyre. Fshatrat lidhen kryesisht me qendrën e njësive administrative, por jo gjithmonë me njëri-tjetrin. Kjo e bën ofrimin e shërbimeve arsimore më kompleks dhe më të kushtueshëm, sepse kërkon planifikim të kujdesshëm për transportin, mirëmbajtjen e objekteve, shpërndarjen e stafit dhe ruajtjen e aksesit në zonat me numër të ulët fëmijësh.

2.2 Njësitë administrative dhe vendbanimet që mbulohen

Bashkia Skrapar është krijuar pas reformës administrativo-territoriale nga bashkimi i 9 njësive të mëparshme të qeverisjes vendore: Çorovodë, Qendër Skrapar, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, Potom, Leshnjë, Gjerbës dhe Zhepë. Territori përfshin qytetin e Çorovodës dhe 103 fshatra, çka tregon një rrjet të gjerë vendbanimesh rurale që kërkojnë mbulim të organizuar me shërbime arsimore.

Çorovoda është qendra kryesore administrative, ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe kulturore e bashkisë. Ajo përqendron pjesën më të madhe të shërbimeve publike dhe institucioneve kryesore, duke shërbyer jo vetëm për banorët e qytetit, por edhe për banorët e njësive rurale. Njësia Qendër Skrapar ka rol lidhës ndërmjet zonës urbane dhe fshatrave përreth, ndërsa njësitë Bogovë, Potom, Gjerbës, Zhepë, Çepan, Vëndreshë dhe Leshnjë kanë karakter kryesisht rural, me reliev kodrinor-malor dhe vendbanime të shpërndara.

Njësia administrative	Karakteri territorial	Numri i fshatrave / lagjeve	Roli në planifikimin arsimor
Çorovodë	Qendër urbane	6 lagje kryesore dhe 2 periferike	Qendra kryesore e shërbimeve arsimore dhe administrative
Qendër Skrapar	Rurale, pranë qendrës urbane	24 fshatra	Zonë lidhëse mes Çorovodës dhe fshatrave përreth

Bogovë	Rurale, kodrinore-malore	9 fshatra	Zonë me potencial turistik dhe nevojë për ruajtje të aksesit
Vëndreshë	Rurale, pranë Çorovodës	8 fshatra	Zonë me lidhje relativisht më të afërt me qendrën
Çepan	Rurale, malore	14 fshatra	Zonë me shpërndarje territoriale dhe distanca të rëndësishme
Potom	Rurale, malore	11 fshatra	Njësi e largët, me nevojë të veçantë për akses dhe transport
Leshnjë	Rurale, kodrinore-malore	8 fshatra	Njësi me popullsi të ulët dhe nevojë për shërbime të ruajtura në territor
Gjerbës	Rurale, malore	14 fshatra	Zonë me lidhje me Malin e Tomorrit dhe vendbanime të shpërndara
Zhepë	Rurale, malore	15 fshatra	Njësi e largët, me lidhje funksionale edhe drejt Gramshit

2.3 Popullsia sipas njësive administrative

Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, Bashkia Skrapar ka 10,750 banorë. Të dhënat e aneksit të bashkisë paraqesin një vlerë totale 10,450 banorë, por shuma e njësive administrative dhe publikimi i INSTAT japin vlerën 10,750; për këtë arsye, në këtë kapitull përdoret vlera e rakorduar me Censin 2023.

Popullsia është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Çorovoda dhe Njësia Qendër Skrapar përqendrojnë pjesën më të madhe të banorëve, ndërsa njësitë malore si Leshnjë, Zhepë, Çepan, Gjerbës dhe Potom kanë popullsi më të ulët dhe vendbanime më të shpërndara. Ky raport është i rëndësishëm për planifikimin arsimor, sepse tregon se rrjeti i institucioneve nuk duhet të vlerësohet vetëm nga numri i fëmijëve, por edhe nga funksioni që shkolla ose kopshti ka për ruajtjen e aksesit në komunitete të largëta.

Njësia administrative	Popullsia gjithsej	Femra	Meshkuj
Çorovodë	3,918	2,028	1,890
Qendër Skrapar	2,331	1,152	1,179
Bogovë	932	442	490
Vëndreshë	806	384	422
Potom	729	349	380
Gjerbës	603	294	309
Çepan	583	279	304
Zhepë	508	241	267
Leshnjë	340	162	178
Gjithsej Bashkia Skrapar	10,750	5,331	5,419

Të dhënat tregojnë se raporti gjinor është relativisht i balancuar, me një diferencë të lehtë në favor të meshkujve. Në nivel bashkie, popullsia mashkullore përbën rreth 50.4%, ndërsa popullsia femërore rreth 49.6%.

2.4 Popullsia sipas grupmoshave arsimore

Struktura moshore e Bashkisë Skrapar tregon një peshë relativisht të ulët të grupmoshës 0–14 vjeç dhe një peshë të lartë të popullsisë mbi 65 vjeç. Sipas Censit 2023, në Bashkinë Skrapar janë 1,133

banorë të grupmoshës 0–14 vjeç, 7,033 banorë të grupmoshës 15–64 vjeç dhe 2,584 banorë të moshës 65 vjeç e lart.

Grupmosha	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Pesha në popullsi
0–14 vjeç	1,133	593	540	10.5%
15–64 vjeç	7,033	3,528	3,505	65.4%
65+ vjeç	2,584	1,298	1,286	24.0%
Gjithsej	10,750	5,419	5,331	100%

Për planifikimin e arsimit parauniversitar, grupmosha 0–14 vjeç është treguesi bazë për nevojën e shërbimeve parashkollore dhe të arsimit bazë. Pesha e lartë e popullsisë 65+ tregon një tendencë të plakjes demografike dhe uljes së numrit të fëmijëve në shumë fshatra. Kjo nuk e ul rëndësinë e shërbimit arsimor; përkundrazi, kërkon një qasje më të kujdesshme për ruajtjen e aksesit në zonat rurale, sidomos aty ku numri i fëmijëve është i vogël, por distanca nga qendra është e madhe.

2.5 Profili social dhe grupet në nevojë

Profili social i Bashkisë Skrapar lidhet ngushtë me karakterin rural, malor dhe me shpërndarjen e popullsisë në shumë fshatra të vegjël. Ekonomia lokale mbështetet kryesisht në bujqësi, blegtori, pemëtari, bletari, shërbime, administratë dhe në potencialin turistik që lidhet me Kanionet e Osumit, Ujëvarën e Bogovës dhe Malin e Tomorrit. Këto burime krijojnë mundësi zhvillimi, por nuk e zhbëjnë faktin se një pjesë e territorit përballet me distanca, lëvizshmëri të kufizuar dhe kosto më të larta për akses në shërbime.

Në kontekstin arsimor, grupet që kërkojnë vëmendje të veçantë janë fëmijët dhe nxënësit nga familje në nevojë ekonomike, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në zona të largëta, nxënësit me mungesa të larta, fëmijët që kanë nevojë për transport dhe fëmijët nga komunitete vulnerabël. Të dhënat e kopshteve evidentojnë raste të kufizuara të fëmijëve egjiptianë që frekuentojnë arsimin parashkollor, ndërsa të dhënat e shkollave evidentojnë nxënës me ndihmë ekonomike dhe nxënës që përfitojnë transport.

Një element i rëndësishëm social është edhe roli i konviktit dhe mbështetjes për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm. Të dhënat e shkollës së mesme “Ramiz Aranitasi” tregojnë praninë e nxënësve në konvikt dhe përfituesve të bursave, çka e bën mbështetjen sociale pjesë të domosdoshme të planifikimit të arsimit parauniversitar në Bashkinë Skrapar.

2.6 Implikimet e profilit territorial dhe demografik për planifikimin arsimor

Profili territorial dhe demografik i Bashkisë Skrapar ka disa pasoja të drejtpërdrejta për planifikimin e shërbimit të arsimit parauniversitar. Së pari, shpërndarja e popullsisë në 103 fshatra dhe relievi malor kërkojnë një rrjet arsimor që nuk matet vetëm me eficiencë numerike, por edhe me akses territorial. Në disa zona, një shkollë apo grup parashkollor me pak fëmijë mund të ketë rëndësi të madhe për ruajtjen e shërbimit në komunitet.

Së dyti, përqendrimi i popullsisë në Çorovodë dhe Qendër Skrapar e bën këtë zonë boshtin kryesor të shërbimeve arsimore, por njësitë e largëta si Potom, Zhepë, Gjerbës, Çepan dhe Leshnjë kërkojnë masa të diferencuara për transportin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e kushteve minimale në objektet ekzistuese. Në këto njësi, distanca dhe koha e lëvizjes janë po aq të rëndësishme sa numri i nxënësve.

Së treti, struktura demografike me peshë të ulët të fëmijëve dhe peshë të lartë të popullsisë së moshuar kërkon një planifikim realist të rrjetit arsimor. Bashkia duhet të shmangë investimet e fragmentuara dhe të orientojë burimet drejt institucioneve që kanë rol qendror për disa vendbanime, duke ruajtur njëkohësisht aksesin për fëmijët në fshatrat më të largëta.

Së katërti, planifikimi duhet të lidhet me shërbimet mbështetëse. Transporti, bursat, mbështetja psiko-sociale, ndjekja e fëmijëve në nevojë dhe aksesueshmëria për fëmijët me aftësi të kufizuara janë elementë që duhet të trajtohen si pjesë e të njëjtit sistem, jo si masa të veçuara. Për Bashkinë Skrapar, kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të relievit, distancave dhe numrit të lartë të vendbanimeve rurale.

Në përfundim, profili i Bashkisë Skrapar kërkon një plan arsimor të bazuar në tre parime kryesore: ruajtjen e aksesit në territor, përqendrimin e investimeve aty ku ndikimi është më i madh dhe mbështetjen e fëmijëve e nxënësve që rrezikojnë të mbeten jashtë përfitimit të plotë nga shërbimi arsimor.

3. Kuadri ligjor dhe institucional

Kuadri ligjor dhe institucional për Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar të Bashkisë Skrapar përcakton bazën mbi të cilën organizohet, financohet, mbështetet dhe monitorohet shërbimi arsimor në nivel vendor. Ky kuadër ndan përgjegjësitë ndërmjet institucioneve qendrore, strukturave arsimore vendore, Bashkisë, institucioneve arsimore, shërbimeve sociale dhe komunitetit.

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar nuk zëvendëson kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit apo të Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare, por shërben si instrument vendor për planifikimin e shërbimeve, mirëmbajtjes, investimeve, sigurisë, aksesit dhe mbështetjes sociale në kopshte, shkolla dhe institucione të tjera që lidhen me arsimin parauniversitar në territorin e Bashkisë Skrapar.

3.1 E drejta për arsim dhe detyrimet publike

E drejta për arsim është një e drejtë themelore dhe përbën detyrim publik për institucionet shtetërore dhe vendore. Në sistemin arsimor parauniversitar, kjo e drejtë konkretizohet përmes garantimit të aksesit në arsim, ndjekjes së arsimit të detyrueshëm, sigurimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve dhe nxënësve, si dhe mbështetjes së grupeve që kanë nevojë për trajtim të veçantë.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton parimet, strukturën dhe organizimin e arsimit parauniversitar, duke përfshirë arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm. Ministria e Arsimit e ka publikuar këtë ligj të azhurnuar bashkë me aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat përbëjnë bazën kryesore për funksionimin e institucioneve arsimore.

Në këtë kuadër, Bashkia Skrapar ka detyrimin të mbështesë garantimin e së drejtës për arsim në territorin e saj, veçanërisht përmes sigurimit të kushteve fizike, mirëmbajtjes së objekteve, aksesit të fëmijëve dhe nxënësve, koordinimit me ZVA-në, mbështetjes sociale dhe planifikimit të burimeve vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një bashki me territor të gjerë, reliev malor dhe vendbanime të shpërndara, ku aksesit fizik në shërbim është pjesë e drejtpërdrejtë e garantimit të së drejtës për arsim.

3.2 Përgjegjësitë e bashkisë në arsimin parashkollor

Arsimi parashkollor është fusha ku përgjegjësia vendore është më e drejtpërdrejtë. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përcakton bashkinë si njësinë bazë të vetëqeverisjes vendore dhe i jep asaj përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve publike në territorin e saj.

Në këtë kuadër, Bashkia Skrapar ka rol kryesor në funksionimin e arsimit parashkollor publik. Përgjegjësitë e saj lidhen me mirëmbajtjen e kopshteve, sigurimin e kushteve bazë, mbështetjen me staf ndihmës sipas strukturës vendore, furnizimet e nevojshme, higjienën, ngrohjen, ujin, energjinë, sigurinë, mobilimin, pajisjet dhe planifikimin e ndërhyrjeve infrastrukturore.

Në Skrapar, ku një pjesë e kopshteve ndodhen në zona rurale ose pranë shkollave, roli i bashkisë është edhe më i rëndësishëm. Kopshtet me numër të vogël fëmijësh nuk duhen parë vetëm nga këndvështrimi i eficiencës financiare, por edhe si shërbime bazë që mbajnë fëmijët pranë komunitetit dhe ndihmojnë familjet të mos përballen me distanca të mëdha për edukimin e hershëm.

Për arsimin parashkollor, Bashkia duhet të sigurojë:

- mjedise të sigurta dhe funksionale;
- mirëmbajtje të rregullt të godinave;
- kushte higjieno-sanitare të përshtatshme për fëmijët;
- ngrohje dhe furnizim me ujë e energji;
- materiale didaktike dhe pajisje bazë;
- mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- bashkëpunim me prindërit, ZVA-në dhe shërbimet sociale;
- përfshirje të nevojave të kopshteve në buxhet dhe PBA.

3.3 Roli mbështetës i bashkisë në arsimin bazë dhe të mesëm

Në arsimin bazë dhe të mesëm, përgjegjësitë kryesore pedagogjike, kurrikulare dhe të menaxhimit të procesit mësimor i takojnë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, institucioneve të saj të varësisë dhe ZVA-së. Megjithatë, bashkia ka rol të rëndësishëm mbështetës, sepse cilësia e mësimdhënies lidhet drejtpërdrejt me kushtet fizike, sigurinë, aksesin dhe shërbimet mbështetëse në institucionet arsimore.

Për Bashkinë Skrapar, ky rol përfshin mirëmbajtjen e objekteve shkollore, mbështetjen për stafin ndihmës të paguar nga bashkia, ndërhyrjet për tualete, ujë, energji, ngrohje, rrethim, siguri, akses PAK, si dhe bashkëpunimin për transportin, bursat dhe masat kundër braktisjes shkollore.

Të dhënat e PBA-së së bashkisë e ndajnë financimin vendor të arsimit në dy programe kryesore: “Arsimi bazë, përfshirë arsimin parashkollor” dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”. Në këto programe përfshihen paga për staf të paguar nga bashkia, sigurime, shpenzime operative, mirëmbajtje, higjienë, energji, ujë, ngrohje, materiale didaktike, ushqim, bursa dhe zëra të tjerë mbështetës për funksionimin e institucioneve arsimore.

Në këtë kuadër, roli i Bashkisë Skrapar nuk është të ndërhyjë në përmbajtjen e procesit mësimor, por të krijojë kushte që ky proces të zhvillohet në mënyrë të sigurt, të rregullt dhe gjithëpërfshirëse.

3.4 Roli i ZVA-së dhe institucioneve arsimore

Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare ka rol kyç në administrimin arsimor, ndjekjen e zbatimit të politikave kombëtare, mbështetjen e shkollave dhe kopshteve, monitorimin e procesit mësimor dhe koordinimin me drejtuesit e institucioneve arsimore. ZVA-ja është institucioni që lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies, zbatimin e kurrikulës, menaxhimin pedagogjik, stafin mësimor dhe ndjekjen e frekuentimit.

Institucionet arsimore, nga ana tjetër, janë përgjegjëse për organizimin e përditshëm të procesit edukativ dhe mësimor, menaxhimin e të dhënave për fëmijët dhe nxënësit, identifikimin e nevojave, raportimin e problematikave, funksionimin e bordeve dhe këshillave të prindërve, si dhe bashkëpunimin me bashkinë për çështjet e infrastrukturës, sigurisë dhe shërbimeve mbështetëse.

Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, e miratuar nga Ministria e Arsimit me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, dhe e ndryshuar më pas, përbën një nga aktet kryesore nënligjore për organizimin e jetës institucionale në shkolla dhe kopshte. Ministria e Arsimit ka publikuar edhe ndryshime të mëvonshme në këtë rregullore, përfshirë Urdhrin nr. 300, datë 19.06.2024 dhe Urdhrin nr. 420, datë 27.08.2025.

Për zbatimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar në Skrapar, bashkëpunimi Bashki–ZVA–institucione arsimore duhet të jetë i strukturuar, i rregullt dhe i bazuar në të dhëna. Ky bashkëpunim duhet të përfshijë rakordimin e numrit të fëmijëve dhe nxënësve, listën e problematikave infrastrukturore, nevojat për transport, rastet sociale, fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesat e larta dhe prioritetet për ndërhyrje.

3.5 Mbrojtja e fëmijës dhe shërbimet sociale në mbështetje të arsimit

Arsimi nuk mund të trajtohet i shkëputur nga mbrojtja e fëmijës dhe shërbimet sociale. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton përgjegjësitë institucionale për garantimin e të drejtave, mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Po ashtu, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe rolin e institucioneve publike për mbështetjen e individëve dhe familjeve në nevojë. Ky ligj është i rëndësishëm për planin e arsimit, sepse një pjesë e fëmijëve dhe nxënësve që rrezikojnë mospërfshirjen ose frekuentimin e parregullt kanë nevojë për ndërhyrje të koordinuar arsimore dhe sociale.

Në nivel vendor, Bashkia Skrapar, përmes strukturave të shërbimit social dhe Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, duhet të bashkëpunojë me ZVA-në, shkollat dhe kopshtet për identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve nga familje me ndihmë ekonomike, nxënësve me risk braktisjeje, fëmijëve që kanë nevojë për transport dhe atyre që kërkojnë mbështetje psiko-sociale.

Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore është pjesë e rëndësishme e mbështetjes për nxënësit dhe është rregulluar përmes Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020, të ndryshuar, ndërsa në vitin 2025 është miratuar Urdhri nr. 110, datë 13.03.2025, për një ndryshim dhe shtesë në këtë kuadër.

Në një bashki si Skrapari, ku distancat dhe shpërndarja territoriale ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin në shërbim, mbrojtja e fëmijës duhet të lidhet me masat konkrete të planit: transportin, bursat, ndjekjen e mungesave, mbështetjen për familjet në nevojë, referimin në shërbime sociale dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

3.6 Financimi vendor dhe lidhja me PBA-në

Zbatimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar kërkon lidhje të qartë me buxhetin vendor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm. Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, përcakton rregullat për financimin, planifikimin dhe menaxhimin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për këtë arsye, plani nuk duhet të mbetet një dokument i shkëputur nga buxheti. Ai duhet të shërbejë si bazë për përgatitjen e PBA-së, duke përkthyer nevojat e kopshteve dhe shkollave në masa, aktivitete, kosto, burime financimi dhe afate zbatimi.

Në Bashkinë Skrapar, shpenzimet për arsimin lidhen kryesisht me programet buxhetore të arsimit bazë/parashkollor dhe arsimit të mesëm të përgjithshëm. Të dhënat e PBA-së përfshijnë zëra për paga dhe sigurime, shpenzime operative, mirëmbajtje, higjienë, energji, ujë, ngrohje, materiale didaktike, ushqim, bursa dhe shpenzime të tjera mbështetëse. Në të njëjtën kohë, tabelat buxhetore evidentojnë edhe zërat për investime kapitale, të cilët duhet të lidhen me nevojat reale të raportuara nga institucionet arsimore.

Planifikimi financiar duhet të ndjekë disa parime:

- prioritet për ndërhyrjet që lidhen me sigurinë dhe higjienën;
- ruajtje e aksesit në zonat e largëta;
- lidhje e fondeve me problematikat e evidentuara në çdo institucion;
- ndarje e qartë midis mirëmbajtjes së zakonshme dhe investimeve kapitale;
- përditësim vjetor i nevojave dhe kostove;
- raportim i përdorimit të fondeve në Këshillin Bashkiak dhe ndaj komunitetit.

Këshilli Bashkiak ka rol të rëndësishëm në këtë proces, sepse miraton buxhetin, PBA-në dhe dokumentet vendore që orientojnë zhvillimin e shërbimeve publike. Për këtë arsye, Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar duhet të jetë pjesë e diskutimeve buxhetore dhe të përdoret si dokument reference për vendimmarrjen vjetore.

3.7 Strukturat pjesëmarrëse: bordet, këshillat e prindërve dhe komisionet e sigurisë

Pjesëmarrja e prindërve, komunitetit dhe përfaqësuesve vendorë është element i rëndësishëm për funksionimin e mirë të institucioneve arsimore. Bordi i institucionit arsimor, këshilli i prindërve dhe komisionet për sigurinë, shëndetin, mirëmbajtjen dhe mjedisin krijojnë mundësi për bashkëpunim, transparencë dhe zgjidhje të problematikave në nivel institucioni.

Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor” përcakton rolin e bordit si organ kolegjal në institucionet arsimore. Ky udhëzim është plotësuar më tej me Udhëzimin nr. 15, datë 13.03.2025, për disa shtesa në udhëzimin e vitit 2018.

Për Bashkinë Skrapar, këto struktura kanë rëndësi të veçantë sepse shumë institucione ndodhen në fshatra të vegjël, ku komunikimi me prindërit dhe komunitetin është thelbësor për ndjekjen e frekuentimit, evidentimin e nevojave, ruajtjen e objektit, sigurinë e fëmijëve dhe përfshirjen e familjeve në zgjidhjen e problemeve.

Në kuadër të këtij plani, strukturat pjesëmarrëse duhet të përdoren për:

- identifikimin e nevojave reale të kopshteve dhe shkollave;
- raportimin e problematikave të sigurisë, higjienës dhe mirëmbajtjes;
- nxitjen e frekuentimit të rregullt;
- mbështetjen e fëmijëve në nevojë;
- konsultimin e prioriteteve për investime;
- rritjen e transparencës mbi ndërhyrjet e bashkisë;
- ndërtimin e një marrëdhënieje më të fortë shkollë–familje–komunitet.

Bashkia, ZVA-ja dhe drejtuesit e institucioneve arsimore duhet të nxisin funksionimin real të këtyre strukturave, jo vetëm ngritjen formale të tyre. Për planin vendor, kjo do të thotë që bordet, këshillat e prindërve dhe komisionet e sigurisë të përfshihen në monitorimin vjetor të nevojave dhe në konsultimin e masave që lidhen me arsimin në territor.

3.8 Përgjegjësitë institucionale për zbatimin e planit

Për zbatimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar 2027–2029, përgjegjësitë institucionale duhet të jenë të qarta dhe të ndara sipas rolit të secilit aktor.

Institucioni / struktura	Roli kryesor në zbatimin e planit
Bashkia Skrapar	Planifikon, financon dhe ndjek mirëmbajtjen, shërbimet mbështetëse, investimet, sigurinë, higjienën dhe aksesin në institucionet arsimore
Këshilli Bashkiak	Miraton buxhetin, PBA-në, planin dhe raportet kryesore të zbatimit; ushtron rol mbikëqyrës dhe përfaqësues
ZVA	Ndjek procesin arsimor, stafin mësimor, frekuentimin, cilësinë e mësimdhënies dhe bashkëpunimin me institucionet arsimore
Kopshtet dhe shkollat	Mbledhin të dhëna, raportojnë nevojat, ndjekin fëmijët dhe nxënësit, menaxhojnë strukturat pjesëmarrëse dhe zbatojnë detyrat institucionale
Shërbimi social dhe NJMF	Identifikojnë dhe mbështesin fëmijët në nevojë, rastet e mbrojtjes së fëmijës, familjet në vështirësi dhe nxënësit me risk
Prindërit dhe komuniteti	Marrin pjesë në konsultim, raportojnë problematika, mbështesin frekuentimin dhe kontribuojnë në funksionimin e strukturave pjesëmarrëse
Partnerët dhe donatorët	Mund të mbështesin investime, pajisje, trajnime, digjitalizim dhe masa gjithëpërfshirëse

Ky kuadër institucional e bën planin të zbatueshëm vetëm nëse shoqërohet me koordinim të rregullt, të dhëna të përditësuara, ndarje të qartë detyrash dhe lidhje të drejtpërdrejtë me buxhetin vendor. Në këtë mënyrë, Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar për Bashkinë Skrapar kthehet në një instrument praktik për përmirësimin gradual të kushteve, aksesit dhe cilësisë së shërbimit arsimor në të gjithë territorin.

4. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor

4.1 Rrjeti i kopshteve në Bashkinë Skrapar

Shërbimi i arsimit parashkollor në Bashkinë Skrapar ofrohet përmes kopshteve dhe grupeve parashkollore të vendosura kryesisht në qytetin e Çorovodës dhe në disa fshatra të njësive administrative. Ky rrjet ka rëndësi të veçantë për një bashki me territor të gjerë, reliev malor dhe vendbanime të shpërndara, ku prania e një kopshti apo grupi parashkollor pranë komunitetit ndikon drejtpërdrejt në aksesin e fëmijëve në edukimin e hershëm.

Shërbimi i arsimit parashkollor në Bashkinë Skrapar ofrohet përmes kopshteve “Nr. 1”, “K. Ylli”, “Sharovë” dhe “Kuvajt Nr. 2”. Krahas tyre, dhe grupet parashkollore në Kalanjas, Therepel, Backë, Potom, Osojë, Zalosnjë, Gjerbës, Kakrukë dhe Bogovë. Kjo tregon se shërbimi nuk është i përqendruar vetëm në qendrën urbane, por shtrihet edhe në pika të vogla rurale, shpesh me grupe të përziera dhe me numër të kufizuar fëmijësh.

Në terma funksionale, rrjeti parashkollor i Skraparit ka dy tipare kryesore: nga njëra anë, kopshtet urbane në Çorovodë kanë më shumë fëmijë dhe kapacitet më të madh organizativ; nga ana tjetër, grupet rurale kanë numër të ulët fëmijësh, por rëndësi të lartë për ruajtjen e aksesit në zonat e largëta. Për këtë arsye, planifikimi i arsimit parashkollor në Skrapar duhet të balancojë eficiencën financiare me nevojën sociale për të mos e larguar shërbimin nga komunitetet rurale.

4.2 Shpërndarja e kopshteve sipas njësive administrative

Shpërndarja e kopshteve dhe grupeve parashkollore ndjek strukturën territoriale të bashkisë. Qyteti i Çorovodës përfaqëson qendrën kryesore të shërbimit, ku raportohen kopshtet “Nr. 1”, “K. Ylli” dhe “Kuvajt Nr. 2”. Këto institucione mbulojnë pjesën urbane dhe kanë numrin më të lartë të fëmijëve të regjistruar.

Në zonat rurale, shërbimi ofrohet përmes kopshteve ose grupeve të vogla, si në Sharovë, Kalanjas, Therepel, Backë, Potom, Osojë, Zalosnjë, Gjerbës, Kakrukë dhe Bogovë. Në këto raste, shërbimi ka më shumë karakter komunitar dhe shpesh organizohet në grupe të përziera, për shkak të numrit të vogël të fëmijëve sipas moshës.

Zona / vendbanimi i raportuar	Forma e shërbimit	Karakteristika kryesore
Çorovodë – Kopshti Nr. 1	Kopsht më vete	Me ushqim, me numër më të lartë fëmijësh dhe me shërbime më të plota
Çorovodë – K. Ylli	Grup pranë shkollës	Pa ushqim, por me numër të konsiderueshëm fëmijësh
Çorovodë / Skrapar – Kuvajt Nr. 2	Kopsht më vete	Pa ushqim, me kapacitet fizik më të madh të raportuar
Sharovë	Kopsht më vete	Shërbim rural me numër të vogël fëmijësh
Kalanjas, Therepel, Backë, Potom, Osojë, Zalosnjë, Gjerbës, Kakrukë, Bogovë	Grupe parashkollore	Grupe të përziera, me numër të ulët fëmijësh dhe rol të rëndësishëm për aksesin rural

Të dhënat tregojnë se shpërndarja territoriale e shërbimit është e lidhur ngushtë me demografinë lokale. Në fshatra me pak fëmijë, ruajtja e shërbimit kërkon forma fleksibël organizimi, ndërsa në Çorovodë kërkohet vëmendje më e madhe për cilësinë, pajisjet, ushqimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e ambienteve.

4.3 Regjistrimi dhe frekuentimi i fëmijëve në kopshte

Na të dhënat e regjistrimit dhe frekuentimit në katër kopshte: “Nr. 1”, “K. Ylli”, “Sharovë” dhe “Kuvajt Nr. 2” rezultojnë gjithsej 93 fëmijë të regjistruar të moshës 3–5 vjeç. Nga këta, 35 janë vajza dhe 58 janë djem. Frekuentimi i rregullt rezulton shumë i lartë, me 92 fëmijë që frekuentojnë rregullisht dhe vetëm 1 fëmijë që nuk frekuenton rregullisht.

Kopshti	Vajza të regjistruara	Djem të regjistruar	Gjithsej të regjistruar	Gjithsej frekuentojnë rregullisht
Nr. 1	11	17	28	27
K. Ylli	13	18	31	31
Sharovë	0	3	3	3
Kuvajt Nr. 2	11	20	31	31
Gjithsej	35	58	93	92

Kopshtet në Çorovodë kanë peshën kryesore të fëmijëve të regjistruar. “K. Ylli” dhe “Kuvajt Nr. 2” kanë nga 31 fëmijë, ndërsa kopshti “Nr. 1” ka 28 fëmijë. Kopshti Sharovë ka vetëm 3 fëmijë, por mbetet i rëndësishëm për aksesin në një zonë rurale.

Të dhënat tregojnë se sfida kryesore nuk është frekuentimi i fëmijëve të regjistruar, pasi ai është pothuajse i plotë, por identifikimi i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që mund të jenë jashtë sistemit parashkollor. Për këtë arsye, në vitet në vijim është e nevojshme që Bashkia, ZVA-ja dhe institucionet arsimore të rakordojnë të dhënat e gjendjes civile me të dhënat e kopshteve, për të kuptuar më mirë nivelin real të përfshirjes.

4.4 Grupet, kapaciteti dhe organizimi i shërbimit

Organizimi i shërbimit parashkollor ndryshon ndërmjet kopshteve urbane dhe grupeve rurale. Në kopshtin “Nr. 1” janë të organizuara tre grupe sipas moshës, me 28 fëmijë gjithsej. Në “K. Ylli” ka dy grupe të përziera dhe një grup të tretë, me 31 fëmijë. Në Sharovë funksionon një grup i përzier me 3 fëmijë.

Në tabelën e grupeve raportohen gjithsej 16 grupe parashkollore, me 102 fëmijë të evidentuar në grupe.

Treguesi	Vlera e raportuar
Grupe të raportuara në tabelën e grupeve	16
Fëmijë të evidentuar në grupe	102
Vajza në grupe	45
Djem në grupe	57
Tipologjia dominuese	Grupe të përziera

Grupet me numër të ulët fëmijësh janë tipike për zonat rurale të Skraparit. Ato nuk përbëjnë problem nga pikëpamja e mbingarkesës, por kërkojnë vëmendje për cilësinë e shërbimit, sepse edukatorja duhet të punojë me fëmijë të moshave të ndryshme në të njëjtin grup. Në këto kushte, nevojitet mbështetje profesionale për edukatorët, materiale didaktike të përshtatshme për grupe të përziera dhe monitorim i rregullt i zhvillimit të fëmijëve.

4.5 Fëmijët nga grupet vulnerabël dhe mbështetja sociale

Në Bashkinë Skrapar evidentohet një fëmijë nga komuniteti egjiptian në kopshtin “Nr. 1”, i cili frekuenton kopshtin. Nuk raportohen të dhëna të tjera të detajuara për fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë nga familje me ndihmë ekonomike, fëmijë në risk apo kategori të tjera.

Ky rezultat nuk duhet interpretuar automatikisht si mungesë e rasteve në territor. Më shumë tregon nevojën për një sistem më të mirë identifikimi dhe rakordimi ndërmjet kopshtit, shërbimit social, NJMF-së, ZVA-së dhe njësive administrative. Në një bashki me fshatra të shpërndara dhe distanca të konsiderueshme, disa raste mund të mos identifikohen në kohë nëse të dhënat nuk mbledhen në mënyrë të rregullt.

Gjatë konsultimit publik u evidentua nevoja për identifikim më të hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta zhvillimore, aftësi të kufizuara ose vështirësi që kërkojnë mbështetje profesionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në arsimin parashkollor, ku ndërhyrja e hershme mund të ndikojë ndjeshëm në zhvillimin e fëmijës dhe në përfshirjen e tij të mëtijshme në sistemin arsimor. Për këtë arsye, Bashkia, kopshtet, shërbimi social, NJMF-ja dhe ZVA-ja duhet të forcojnë bashkëpunimin për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale ose shërbime të specializuara.¹

Për periudhën 2027–2029, plani duhet të parashikojë forcimin e identifikimit të fëmijëve në nevojë, ndjekjen e frekuentimit, referimin në shërbime sociale kur është e nevojshme dhe mbështetjen e familjeve që kanë vështirësi për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve në edukimin parashkollor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët në zonat rurale, për fëmijët me nevoja zhvillimore dhe për familjet me vështirësi ekonomike.

4.6 Burimet njerëzore në kopshte

Të dhënat për stafin tregojnë se në kopshtet e raportuara ka prani të edukatoreve dhe stafit ndihmës, por edhe nevojë për rakordim të mëtijshëm të informacionit. Për kopshtin “Nr. 1” raportohen 6 edukatorë aktualë dhe 3 punonjës ndihmës, për “K. Ylli” 2 edukatorë dhe 1 punonjës ndihmës, ndërsa për Sharovë 1 edukator dhe pa staf ndihmës. Për kopshtin “Kuvajt” tabela paraqet të dhëna që kërkojnë verifikim, pasi numri i edukatorëve aktualë është shënuar 14, ndërkohë që raporti fëmijë për edukator paraqitet 6.

Kopshti	Edukatorë aktualë	Edukatorë të nevojshëm	Staf ndihmës aktual
Nr. 1	6	6	3

¹ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

K. Ylli	2	2	1
Sharovë	1	1	0
Kuvajt Nr.2	14	0	1

Trajnimi i stafit është një nevojë e përbashkët për të gjitha kopshtet. Kjo është e rëndësishme sidomos për punën me grupe të përziera, fëmijë me nevoja të ndryshme zhvillimore, sigurinë, higjienën, komunikimin me prindërit dhe përdorimin e materialeve didaktike.

Përveç nevojës për rakordimin e të dhënave mbi stafin edukativ dhe ndihmës, gjatë konsultimit publik u ngrit edhe çështja e mbështetjes psiko-sociale në arsimin parashkollor. Kopshtet kanë nevojë për mekanizma më të qartë bashkëpunimi me shërbimin psiko-social, ZVA-në dhe strukturat e shërbimit social, me qëllim identifikimin e hershëm të fëmijëve me nevoja zhvillimore ose aftësi të kufizuara. Bashkia duhet të ketë rol koordinues dhe mbështetës, ndërsa siguri i shërbimit psiko-social duhet të trajtohet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse arsimore dhe sociale.²

4.7 Infrastruktura, mobilimi dhe kushtet fizike

Kopshti	Nr. klasave	Tavolina	Karrige	Tualete	Lavamanë	Tualet PAK	Nevojë për rikonstruksion
Nr. 1	3	6	30	3	7	Jo	Jo
K. Ylli	2	8	35	2	4	Jo	Jo
Kuvajt Nr. 2	5	20	70	6	5	Jo	Jo

Një problem i rëndësishëm është mungesa e tualeteve të përshtatura për fëmijë me aftësi të kufizuara. Në të dhënat e raportuara, kopshtet “Nr. 1” dhe “K. Ylli” nuk kanë tualet PAK. Kjo duhet të trajtohet si pjesë e planifikimit afatmesëm, jo vetëm si ndërhyrje fizike, por si detyrim për gjithëpërfshirje.

4.8 Akses, shërbimet bazë dhe siguria

Kopshtet e raportuara kanë furnizim me ujë të pijshëm dhe energji elektrike. “Nr. 1” dhe “K. Ylli” kanë akses si për këmbësorë ashtu edhe për automjete, ndërsa Sharova ka akses këmbësor. Dy kopshtet urbane kanë ndriçim në hyrje dhe rrethim.

Akresi, shërbimet bazë dhe siguria	Nr. 1	Kopshti pranë Shkollës K. Ylli	Sharovë	Kuvajt Nr. 2
Akses këmbësor/automjet	Të dyja	Të dyja	Këmbësor	Të dyja
Trotuar në hyrje	Po	Jo	Jo	Po
Sinjalistikë rrugore	Jo	Jo	Jo	Jo
Ndriçim në hyrje	Po	Po	Jo	Po
Rrethim	Po	Po	Jo	Po
Ujë i pijshëm	Po	Po	Po	Po
Energji elektrike	Po	Po	Po	Po
Internet/telefon	Po	Po	Jo	Jo

² Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

Fikëse zjarri	5	2	Jo	Po
Dalje emergjence	Po	Jo	Jo	Jo
Kamera	2	0	0	0

Të dhënat tregojnë se siguria fizike nuk është e njëtrajtshme. Kopshti “Nr. 1” ka elementët më të plotë të sigurisë, përfshirë fikëse zjarri, dalje emergjence dhe kamera. “K. Ylli” dhe Kopshti Kuvajt Nr.2 kanë ujë, energji, ngrohje dhe fikëse zjarri, por nuk ka dalje emergjence dhe kamera. Sharova ka kushtet bazë të ujit dhe energjisë, por mungojnë disa elementë të rëndësishëm të sigurisë dhe aksesit.

Për vitet 2027–2029, prioritet duhet të jenë sinjalistika, ndriçimi në hyrje, rrethimi, daljet e emergjencës dhe pajisja me fikëse zjarri, veçanërisht në kopshtet dhe grupet rurale.

4.9 Shëndeti, higjiena dhe ushqimi në kopshte

Nga të dhënat e raportuara, vetëm kopshti “Nr. 1” ofron ushqim. Në këtë kopsht ushqehen 28 fëmijë, nga të cilët 2 përfitojnë kompensim ushqimi. Menuja është e miratuar dhe nuk janë raportuar raste intolerance ushqimore. “K. Ylli” dhe “Sharovë” nuk ofrojnë ushqim.

Kopshti	Ofron ushqim	Fëmijë që ushqehen	Fëmijë me kompensim ushqimi	Menu e miratuar	Materiale higjienë të mjaftueshme	Analiza uji
Kopshti Nr. 1	Po	28	2	Po	Po	Po
Kopshti pranë shkollës “Kahreman Ylli”	Jo	0	0	Jo	Po	Po
Kopshti Sharovë	Jo	0	0	Jo	Jo	Po
Kuvajt Nr. 2	Jo	0	0	Jo	Jo	Po

Në aspektin shëndetësor, vaksinimi është i dokumentuar në kopshtet e raportuara dhe analiza e ujit rezulton e kryer. Megjithatë, kontrollet shëndetësore periodike nuk raportohen si të rregullta, por “jo gjithmonë”. Ky është një tregues që kërkon përmirësim, sidomos për një shërbim që lidhet me fëmijë të moshës së hershme.

Higjiena paraqitet më mirë në kopshtet urbane, ndërsa në Sharovë raportohet mungesë e materialeve higjienike të mjaftueshme. Për këtë arsye, plani duhet të parashikojë furnizim të rregullt minimal për të gjitha kopshtet dhe grupet, pavarësisht numrit të fëmijëve.

4.10 Mjetet didaktike, pajisjet dhe TIK

Të dhënat tregojnë se asnjë nga kopshtet e raportuara nuk ka mjete didaktike të mjaftueshme. Nevojat e përsëritura lidhen me mjete mësimore për profesione, tabela magnetike dhe të plastifikuara, komplete druri me numra dhe forma gjeometrike. Kjo është një nevojë thelbësore për cilësinë e edukimit parashkollor, sepse fëmijët në këtë moshë mësojnë përmes lojës, manipulimit të objekteve, ngjyrave, formave dhe aktiviteteve konkrete.

Kopshti	Mjete didaktike të mjaftueshme	Kompjuter/tablet për staf	Internet	Regjistër elektronik	Materiale për fëmijë PAK
Kopshti Nr. 1	Jo	1	Po	Jo	0
Kopshti pranë shkollës “Kahreman Ylli”	Jo	1	Po	Jo	0
Kopshti Sharovë	Jo	0	Jo	Jo	0
Kuvajt Nr. 2	Jo	1	Po	Jo	0

Dy kopshtet urbane kanë nga një pajisje për stafin dhe internet, por nuk përdorin regjistër elektronik. Sharova nuk ka kompjuter/tablet dhe as internet. Në asnjë rast nuk raportohen materiale për fëmijë me aftësi të kufizuara.

Për vitet 2027–2029, Bashkia duhet të planifikojë një paketë minimale didaktike për çdo kopsht/grup parashkollor, me prioritet kopshtet që nuk kanë mjete të mjaftueshme dhe grupet e përziera në zonat rurale. Paralelisht, duhet të fillojë pajisja graduale me mjete bazë TIK dhe përdorimi i një formati të unifikuar për regjistrimin dhe raportimin e të dhënave.

4.11 Bordi, këshilli i prindërve dhe pjesëmarrja komunitare

Pjesëmarrja e prindërve dhe komunitetit është e rëndësishme për mirëfunksionimin e arsimit parashkollor, sidomos në një bashki ku kopshtet dhe grupet janë të shpërndara në zona të ndryshme. Të dhënat tregojnë se “Nr. 1” dhe “K. Ylli” kanë bord të ngritur dhe funksional, si dhe këshill prindërisht. Secili prej këtyre institucioneve ka raportuar 2 mbledhje bordi dhe 2 mbledhje të këshillit të prindërve.

Në Sharovë, bordi nuk është i ngritur, ndërsa këshilli i prindërve nuk rezulton funksional. Kjo tregon se strukturat pjesëmarrëse funksionojnë më mirë në kopshtet urbane dhe më dobët në zonat rurale.

Kopshti	Bord i ngritur	Bord funksional	Mbledhje bordi	Këshill prindërisht	Mbledhje këshilli	KSHS i ngritur
Kopshti Nr. 1	Po	Po	2	Po	2	Jo
Kopshti pranë shkollës “Kahreman Ylli”	Po	Po	2	Po	2	Jo
Kopshti Sharovë	Po	Po	0	Jo	0	Jo
Kuvajt Nr. 2	Po	Po	2	Po	2	Jo

Një dobësi e rëndësishme është mungesa e Komisionit për Shëndetin, Sigurinë, Mirëmbajtjen dhe Mjedisin në kopshtet e raportuara. Për një shërbim që lidhet drejtpërdrejt me sigurinë, higjienën dhe mirëqenien e fëmijëve, ky komision duhet të ngrihet dhe të funksionojë në mënyrë reale, me kontrolle periodike dhe raportim të thjeshtë të problematikave.

4.12 Problematikat kryesore dhe nevojat për ndërhyrje

Nga analiza e të dhënave dhe e vlerësimit të infrastrukturës dhe funksionimit të kopshteve dalin disa nevoja të qarta që lidhen me funksionimin dhe cilësinë e shërbimit.

Problematikat kryesore janë:

- mungesa e mjeteve didaktike të mjaftueshme në kopshtet e raportuara;
- mungesa e materialeve për fëmijë me aftësi të kufizuara;
- mungesa e tualeteve PAK;
- mungesa e regjistrit elektronik;
- mungesa e internetit dhe pajisjeve TIK në Sharovë;
- mungesa e sinjalistikës rrugore në hyrje të kopshteve;
- mungesa e daljes së emergjencës në “K. Ylli” dhe Sharovë;
- mungesa e kamerave në “K. Ylli” dhe Sharovë;
- mungesa e rrethimit dhe ndriçimit në Sharovë;
- mungesa e materialeve higjienike të mjaftueshme në Sharovë;
- funksionimi i pamjaftueshëm i strukturave pjesëmarrëse në zonat rurale;
- nevoja për rakordim të të dhënave ndërmjet tabelave të identifikimit, regjistrimit dhe grupeve.

Ndërhyrjet prioritare duhet të ndahen në tre drejtime: së pari, masa për siguri dhe higjienë; së dyti, pajisje dhe materiale didaktike; së treti, përmirësim i të dhënave, pjesëmarrjes dhe mbështetjes për grupet vulnerabël.

4.13 Gjetje kryesore për arsimin parashkollor

Shërbimi i arsimit parashkollor në Bashkinë Skrapar është i pranishëm si në qendrën urbane, ashtu edhe në disa vendbanime rurale. Kopshtet në Çorovodë mbajnë peshën kryesore të regjistrimit dhe kanë kushte më të mira organizative, ndërsa grupet rurale kanë numër të vogël fëmijësh, por janë të domosdoshme për ruajtjen e aksesit në territor.

Frekuentimi i fëmijëve të regjistruar është shumë i mirë. Vetëm një fëmijë raportohet si jo frekuentues i rregullt në tabelën e regjistrimit. Kjo tregon se, kur fëmijët regjistrohen në kopsht, familjet e ndjekin shërbimin. Sfidë më e madhe mbetet identifikimi i fëmijëve që mund të jenë jashtë sistemit dhe rakordimi i të dhënave me gjendjen civile dhe ZVA-në.

Në aspektin e kapacitetit, nuk raportohet mbingarkesë e grupeve. Përkundrazi, në zonat rurale grupet janë të vogla dhe të përziera. Kjo kërkon qasje të veçantë pedagogjike, sepse puna me fëmijë të moshave të ndryshme brenda të njëjtit grup kërkon më shumë materiale, planifikim dhe mbështetje për edukatoren.

Kushtet bazë si uji dhe energjia elektrike janë të pranishme në kopshtet e raportuara. Megjithatë, elementët e sigurisë nuk janë të plotë në të gjitha institucionet. Sinjalistika, daljet e emergjencës, kamerat, rrethimi dhe ndriçimi në hyrje duhet të përmirësohen, sidomos në kopshtet ose grupet rurale.

Mungesa e mjeteve didaktike është një nga problematikat më të qarta dhe më të përsëritura. Të gjitha kopshtet e raportuara deklarojnë se nuk kanë mjete didaktike të mjaftueshme. Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e edukimit të hershëm dhe duhet të trajtohet si prioritet në planin e veprimit.

Strukturat pjesëmarrëse funksionojnë më mirë në kopshtet urbane dhe më dobët në zonat rurale. Komisionet e sigurisë, shëndetit, mirëmbajtjes dhe mjedisit nuk rezultojnë të ngritura, ndaj është e nevojshme që Bashkia dhe institucionet arsimore të standardizojnë ngritjen dhe funksionimin e tyre.

4.14 Tabela SWOT³ për arsimin parashkollor

Pikat e forta	Dobësitë
Shërbimi parashkollor është i pranishëm në Çorovodë dhe në disa vendbanime rurale.	Të dhënat nuk janë të rakorduara plotësisht ndërmjet tabelave të identifikimit, regjistrimit dhe grupeve.
Frekuentimi i fëmijëve të regjistruar është shumë i lartë.	Ka mungesë të mjeteve didaktike të mjaftueshme në kopshtet e raportuara.
Kopshti "Nr. 1" ofron ushqim dhe ka menu të miratuar.	Vetëm një kopsht ofron ushqim; shërbimi nuk shtrihet në kopshtet/grupet e tjera.
Kopshtet kryesore kanë furnizim me ujë dhe energji elektrike.	Mungojnë tualetet PAK dhe materialet për fëmijë me aftësi të kufizuara.
Në kopshtet urbane ka bord dhe këshill prindërisht funksional.	Komisionet e sigurisë, shëndetit, mirëmbajtjes dhe mjedisit nuk janë të ngritura.
Nuk raportohet mbingarkesë e grupeve.	Grupet rurale janë të vogla dhe të përziera, çka kërkon mbështetje pedagogjike shtesë.
Disa kopshte kanë internet dhe pajisje bazë për stafin.	Regjistri elektronik nuk përdoret dhe TIK mungon në kopshtet rurale.
Mundësitë	Rreziqet
Përmirësimi i PBA-së mund të krijojë linja të qarta për materiale didaktike, siguri, higjienë dhe mirëmbajtje.	Rënia demografike në fshatra mund të çojë në dobësim të mëtejshëm të grupeve parashkollore rurale.
Grupet e vogla mund të përdoren për qasje më individuale ndaj fëmijëve.	Distancat dhe relievi mund të vështirësojnë aksesin e rregullt në shërbim.
Bashkia mund të standardizojë paketën minimale të mjeteve didaktike për çdo kopsht/grup.	Nëse nuk plotësohen elementët e sigurisë, fëmijët dhe stafi mbeten të ekspozuar ndaj rreziqeve.
Mund të forcohet bashkëpunimi me NJMF, shërbimin social dhe ZVA-në për fëmijët në nevojë.	Mosidentifikimi i fëmijëve jashtë sistemit mund të ulë përfshirjen reale në edukimin e hershëm.

³ SWOT është një metodë analize që përdoret për të vlerësuar gjendjen e një sektori ose shërbimi përmes katër elementeve kryesore: Pikat e forta (*Strengths*), Dobësitë (*Weaknesses*), Mundësitë (*Opportunities*) dhe Rreziqet/Sfidat (*Threats*). Në këtë plan, analiza SWOT përdoret për të identifikuar faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin e arsimit parashkollor në Bashkinë Skrapar.

Mund të ngrihen dhe funksionalizohen bordet, këshillat e prindërve dhe KSHS në çdo institucion.	Mungesa e investimeve të vogla periodike mund të çojë në përkeqësim gradual të kushteve.
Digjitalizimi i të dhënave mund të përmirësojë planifikimin dhe monitorimin.	Varësia nga të dhëna jo të plota mund të ndikojë në cilësinë e vendimmarrjes.

5. Analiza e shërbimit të arsimit bazë dhe të mesëm

5.1 Rrjeti i shkollave në Bashkinë Skrapar

Rrjeti i arsimit bazë dhe të mesëm në Bashkinë Skrapar është i shtrirë në qytetin e Çorovodës dhe në njësitë administrative rurale të bashkisë. Ai përfshin shkolla 9-vjeçare, shkolla fillore, gjimnazin “Ramiz Aranitasi”, arsimin e mesëm me kohë të pjesshme, si dhe konviktin që mbështet ndjekjen e arsimit për nxënësit që kanë nevojë për strehim gjatë vitit shkollor.

Në të dhënat e raportuara janë përfshirë rreth 35 institucione/shërbime arsimore: 34 shkolla të arsimit bazë dhe një shkollë e mesme, ndërsa gjimnazi “Ramiz Aranitasi” ofron edhe arsim me kohë të pjesshme. Krahas tyre, funksionon edhe konvikti i shkollës së mesme, i cili ka rëndësi të veçantë për një bashki me vendbanime të largëta dhe reliev malor.

Rrjeti arsimor i Skraparit ka dy tipare të dukshme. Në Çorovodë janë përqendruar institucionet me numrin më të lartë të nxënësve dhe me funksion më të gjerë arsimor, ndërsa në njësitë rurale funksionojnë shumë shkolla të vogla, shpesh me numër shumë të ulët nxënësish. Këto shkolla kanë rol të rëndësishëm social dhe territorial, sepse mbajnë të hapur aksesin në arsim për fëmijët që jetojnë në fshatra të largëta.

5.2 Shpërndarja e shkollave sipas njësive administrative

Shkollat janë të shpërndara në disa njësi administrative, me përqendrim më të madh në Çorovodë, Qendër, Gjerbës, Potom, Bogovë dhe Vëndreshë. Njësitë rurale kanë numër më të madh objekteve të vogla shkollore, por me numër të kufizuar nxënësish. Kjo pasqyron qartë karakterin territorial të Bashkisë Skrapar: një territor i madh, me shumë fshatra, ku shërbimi arsimor duhet të organizohet jo vetëm sipas numrit të nxënësve, por edhe sipas distancës, aksesit dhe rolit që shkolla ka për komunitetin.

Njësia administrative	Shkollat e evidentuara në të dhëna
Çorovodë	“Kahreman Ylli”, “Zylyftar Veleshnja”, Gjimnazi “Ramiz Aranitasi”
Qendër	“Ali Zylyftari” Storo, “Hasan Methoxha” Mollas, “Hysni Shabani” Radësh, Slatinjë, Rovicë, Osojë
Leshnjë	“17 Marsi” Vlushe, “Hetem Guri” Turbohovë, “Hekuran Çela” Kapinovë
Çepan	Zabërzan, Prishtë
Gjerbës	“Ismail Alushani” Gjerbës, “Syrja Zaimi” Terrovë, “Xhevahir Sula” Zaloshnjë, “Pelivan Dorozhani”, “Haxhi Lika” Gjogovicë, “Iliaz Shmoza” Grevë, “Sadik Çoro” Straficë, “Mithat Zaimi” Dobrenj
Bogovë	“Myslym Bakerri” Bogovë, “Ilmi Koxhaj” Bargullas, “Estref Shabani” Kakrukë

Vëndreshë	“20 Gushti” Therepel, “Caush Cerenishti” Vëndreshë 1, “Ferit Bregu” Vëndreshë 2, “Azbi Kuçi” Vëndreshë 3
Potom	Potom, Gjorgjovë, Nikollarë, Backë 1, Backë 2, Visockë
Zhepë	Zhepë

Kjo shpërndarje tregon se arsimi bazë është i pranishëm në pjesën më të madhe të territorit, por me forma të ndryshme organizimi. Në qytet funksionojnë institucione me kapacitet më të madh, ndërsa në fshatra ka shkolla me 1 deri në pak nxënës. Për planifikimin vendor, kjo do të thotë se mirëmbajtja, transporti dhe siguria nuk mund të trajtohen në mënyrë të njëjtë për të gjitha shkollat; ato duhet të lidhen me rolin që çdo shkollë ka në territor.

5.3 Nxënësit sipas nivelit, klasës dhe gjinisë

Të dhënat e raportuara për nxënësit tregojnë një numër të përgjithshëm prej rreth 730 nxënësish në arsimin bazë, arsimin e mesëm dhe arsimin me kohë të pjesshme, sipas tabelave të plotësuara nga shkollat. Nga këta, rreth 490 nxënës janë në arsimin bazë dhe rreth 240 në gjimnazin “Ramiz Aranitasi”, përfshirë edhe nxënësit me kohë të pjesshme.

Në arsimin bazë, shkollat me numrin më të madh të nxënësve janë “Kahreman Ylli” dhe “Zylyftar Veleshnja”, me nga 175 nxënës secila. Pas tyre, pjesa më e madhe e shkollave rurale kanë numër shumë të ulët nxënësish, në disa raste vetëm 1–5 nxënës. Kjo tregon një rrjet arsimor me kontrast të fortë ndërmjet qendrës urbane dhe fshatrave.

Niveli / shërbimi	Nxënës gjithsej të raportuar	Vajza	Djem	Vërejtje
Arsimi bazë – grupi i shkollave të raportuara nga Burbuqe Gezhilli	281	127	154	Përfshin kryesisht shkolla në Qendër, Leshnjë, Gjerbës, Bogovë dhe Vëndreshë
Arsimi bazë – grupi i shkollave të raportuara nga Deseilda Lame	209 sipas klasave / 216 sipas tabelës së stafit	110	99	Kërkon rakordim të vogël ndërmjet tabelës C2 dhe C4
Gjimnazi “Ramiz Aranitasi”, arsim me kohë të plotë	150	71	79	Klasa X–XII
Gjimnazi “Ramiz Aranitasi”, arsim me kohë të pjesshme	90	49	41	Klasa X–XIII
Gjithsej sipas tabelave të klasave	730	357	373	Shifrat kërkojnë rakordim final me ZVA-në

Në gjimnazin “Ramiz Aranitasi”, arsimi me kohë të plotë ka 150 nxënës, ndërsa arsimi me kohë të pjesshme 90 nxënës. Kjo tregon se gjimnazi nuk shërben vetëm për nxënësit në ndjekje të rregullt, por edhe për persona që ndjekin arsimin e mesëm në një formë më fleksibël. Për Bashkinë Skrapar, kjo është e rëndësishme, sepse arsimi me kohë të pjesshme mund të shërbejë si mundësi për përfundimin e arsimit të mesëm për të rinj ose të rritur që nuk e kanë ndjekur rregullisht më parë.

5.4 Frekuentimi dhe nxënësit me mungesa të larta

Të dhënat për mungesat e larta janë të kufizuara, por japin disa sinjale të rëndësishme. Në arsimin bazë, numri i nxënësve me mungesa të larta rezulton i ulët në shumicën e shkollave të raportuara. Në shkollën “Kahreman Ylli” raportohet 1 nxënës me mungesa të larta, ndërsa në shkollën “Zylyftar Veleshnja” evidentohet gjithashtu 1 rast në klasën e tretë.

Në gjimnazin “Ramiz Aranitasi”, mungesat janë më të dukshme. Në arsimin me kohë të plotë raportohen 5 nxënës me mungesa të larta, ndërsa në arsimin me kohë të pjesshme raportohen 12 nxënës. Kjo është e pritshme deri diku, pasi arsimi me kohë të pjesshme përfshin nxënës me kushte më të ndryshme familjare, sociale ose punësimi, por duhet monitoruar me kujdes.

Institucioni / forma e ndjekjes	Nxënës me mungesa të larta
“Kahreman Ylli”	1
“Zylyftar Veleshnja”	1
“Ramiz Aranitasi”, me kohë të plotë	5
“Ramiz Aranitasi”, me kohë të pjesshme	12
Gjithsej të raportuar	19

5.5 Nxënësit nga grupet vulnerabël dhe masat mbështetëse

Të dhënat për nxënësit nga grupet vulnerabël tregojnë praninë e disa kategorive që kërkojnë mbështetje. Në shkollën “Kahreman Ylli” evidentohen 2 nxënës nga komuniteti egjiptian. Në shkollën “Zylyftar Veleshnja” raportohen 12 nxënës nga familje me ndihmë ekonomike, të gjithë frekuentues, ndërsa 6 prej tyre lidhen me mbështetje transporti.

Në nivel bashkie, evidentohen 4 fëmijë/nxënës jashtë sistemit, 2 vajza dhe 2 djem. Ky tregues është i rëndësishëm, sepse kërkon ndjekje ndër-institucionale dhe verifikim të vazhdueshëm nga shkollat, ZVA-ja, shërbimi social dhe NJMF-ja.

Kategoria e raportuar	Institucioni / burimi	Numri i raportuar
Nxënës egjiptianë	“Kahreman Ylli”	2
Nxënës me ndihmë ekonomike	“Zylyftar Veleshnja”	12
Nxënës/fëmijë jashtë sistemit	Tabela e Bashkisë	4
Nxënës që përfitojnë mbështetje për transport	“Zylyftar Veleshnja”	6

Të dhënat tregojnë nevojën për një sistem më të saktë identifikimi dhe ndjekjeje të rasteve. Në shumë shkolla rurale nuk janë raportuar kategori vulnerabël, por kjo nuk duhet interpretuar automatikisht si mungesë e nevojave. Në zona të vogla, rastet mund të jenë të pakta, por secili rast ka peshë të madhe për vazhdimësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale.

5.6 Staf mbështetës dhe shërbimet në shkolla

Të dhënat për stafin tregojnë dallime të qarta ndërmjet shkollave kryesore dhe shkollave të vogla rurale. Shkollat në Çorovodë kanë staf më të plotë dhe shërbime mbështetëse më të organizuara, ndërsa shkollat e vogla funksionojnë me numër minimal mësuesish dhe pa staf ndihmës të dedikuar.

Në “Kahreman Ylli” raportohen 17 mësues, 4 mësues ndihmës, 3 roje, 4 sanitare dhe 1 punonjës teknik. Në “Zylyftar Veleshnja” raportohen 15 mësues, 2 mësues ndihmës, 1 psikolog, 2 roje dhe 3 sanitare. Në gjimnazin “Ramiz Aranitasi” raportohen 18 mësues, 3 mësues ndihmës, 1 psikolog, 2 roje dhe 3 sanitare.

Institucioni	Nxënës gjithsej	Mësues	Mësues ndihmës	Psikolog	Roje	Sanitare
“Kahreman Ylli”	175	17	4	-	3	4
“Zylyftar Veleshnja”	175	15	2	1	2	3
“Ramiz Aranitasi”	240	18	3	1	2	3

Sipas tabelës së stafit të paguar nga Bashkia, për arsimin bazë dhe parashkollor raportohen 71 punonjës të paguar nga bashkia, për arsimin e mesëm 9 punonjës dhe për konviktin 13 punonjës. Bashkia Skrapar mban një rol të rëndësishëm në funksionimin e përditshëm të institucioneve, veçanërisht përmes stafit mbështetës, rojeve, sanitareve, kuzhinës, kujdestarëve dhe shërbimeve të tjera.

Konvikti ka një funksion të veçantë mbështetës për arsimin e mesëm. Ai nuk duhet parë vetëm si strukturë akomodimi, por si instrument që ndihmon nxënësit nga zonat më të largëta të ndjekin arsimin e mesëm pa ndërprerje. Sipas të dhënave konvikti ka 13 përfitues dhe 13 punonjës të paguar nga bashkia, çka tregon një shërbim me kosto të rëndësishme, por edhe me vlerë sociale për aksesin në arsim.

5.7 Infrastruktura dhe kapaciteti fizik i shkollave

Gjendja infrastrukture e shkollave paraqitet e ndryshme sipas zonës dhe madhësisë së institucionit. Shkollat kryesore në Çorovodë kanë kapacitet më të madh fizik, më shumë klasa dhe disa ambiente mbështetëse, ndërsa një pjesë e shkollave rurale kanë vetëm 1–2 klasa dhe funksionojnë në objekte të vogla, të vjetra ose në raste të veçanta në ambiente jo tipike shkollore.

Shkolla “Kahreman Ylli” është ndërtuar në vitin 1959 dhe është rikonstruktuar në vitin 2017; ajo ka 10 klasa, bibliotekë dhe fushë/palestër. Shkolla “Zylyftar Veleshnja” është ndërtuar në vitin 1977, rikonstruktuar në vitin 2018, ka 9 klasa, 3 laboratorë, bibliotekë dhe fushë sportive. Gjimnazi “Ramiz Aranitasi” është ndërtuar në vitin 1973 dhe është rikonstruktuar në vitin 2024; ai ka 22 klasa, 2 laboratorë dhe bibliotekë.

Institucioni	Viti i ndërtimit	Rikonstruksioni i fundit	Nr. klasave	Laboratorë	Bibliotekë	Palestër/fushë
“Kahreman Ylli”	1959	2017	10	-	Po	Po
“Zylyftar Veleshnja”	1977	2018	9	3	Po	Po
“Ramiz Aranitasi”	1973	2024	22	2	Po	Jo
Shkolla rurale të vogla	Vite të ndryshme		1–2 zakonisht	Jo	Jo	Jo

Në disa shkolla rurale janë raportuar objekte të vjetra ose ambiente me nevojë për verifikim teknik.

5.8 Akses, shërbimet bazë dhe siguria në shkolla

Akresi dhe siguria janë ndër çështjet më të rëndësishme për rrjetin arsimor të Bashkisë Skrapar. Shkollat kryesore në qytet kanë kushte më të mira për akses, ndriçim, ujë, energji dhe internet, ndërsa shumë shkolla rurale kanë mungesa të dukshme në sinjalistikë, ndriçim, rrethim, internet, tualete, lavamanë, fikëse zjarri, dalje emergjence dhe kamera.

Në shkollën “Kahreman Ylli” raportohet akses, trotuar, sinjalistikë, ndriçim, ujë, energji, internet, ngrohje me kaldajë dhe 4 fikëse zjarri, por mungon rrethimi, dalja e emergjencës dhe kamerat. Në shkollën “Zylyftar Veleshnja” raportohen kushte më të plota, përfshirë rrethim, ujë, energji, ngrohje elektrike, internet, 11 tualete, 5 lavamanë, 4 fikëse zjarri dhe 2 kamera, por nuk ka dalje emergjence. Në gjimnazin “Ramiz Aranitasi” ka akses, trotuar, sinjalistikë, ndriçim, ujë, energji, internet, ngrohje elektrike, 14 tualete, 5 lavamanë, 5 fikëse zjarri dhe 12 kamera, por rrethimi nuk është i plotë dhe 3 kamera nuk funksionojnë.

Institucioni	Ujë	Energji	Internet	Tualete	Lavamanë	Fikëse zjarri	Dalje emergjence	Kamera
“Kahreman Ylli”	Po	Po	Po	8	6	4	Jo	0
“Zylyftar Veleshnja”	Po	Po	Po	11	5	4	Jo	2
“Ramiz Aranitasi”	Po	Po	Po	14	5	5	Jo	12

Problematika më e fortë del te shkollat e vogla rurale, sidomos në grupin e shkollave të raportuara nga Njësia Qendër dhe Potom, ku për shumë shkolla raportohet mungesë tualetesh, mungesë lavamanësh, mungesë rrethimi, mungesë ndriçimi, mungesë sinjalistike dhe mungesë interneti. Kjo situatë nuk mund të trajtohet vetëm si çështje komoditeti; ajo lidhet drejtpërdrejt me sigurinë, higjienën dhe dinjitetin e shërbimit arsimor.

5.9 Pajisjet, mobilimi, mjetet didaktike dhe TIK

Pajisjet dhe TIK paraqesin një tjetër diferencë të fortë ndërmjet shkollave kryesore dhe shkollave rurale. Në shumë shkolla të vogla raportohet se bankat, tavolinat dhe karriget janë të mjaftueshme, por mungojnë kompjuterët, laboratorët, kabinetet lëndore, materialet didaktike të specializuara dhe pajisjet për nxënës me aftësi të kufizuara.

Shkolla “Kahreman Ylli” raporton 11 kompjuterë dhe 1 laborator TIK. “Zylyftar Veleshnja” ka 5 kompjuterë, 2 laboratorë TIK dhe 2 laboratorë shkencorë, por raporton se bankat dhe karriget nuk janë të mjaftueshme. Gjimnazi “Ramiz Aranitasi” ka 5 kompjuterë dhe 2 laboratorë shkencorë, por nuk ka laborator TIK dhe raporton nevojë për kompjuterë me kosto të përafërt 4,555,000 lekë.

Institucioni	Banka/karrige	Kompjuterë	Laborator TIK	Laborator shkencor	Nevoja e raportuar
“Kahreman Ylli”	Po	11	1	0	Nuk raportohet nevojë specifike

“Zylyftar Veleshnja”	Jo	5	2	2	Banka/karrige dhe përmirësim pajisjesh
“Ramiz Aranitasi”	Po	5	0	2	Kompjuterë, kosto rreth 4,555,000 lekë
Shkolla rurale të vogla	Kryesisht Po				Mungesë TIK dhe materiale mbështetëse

5.10 Transporti, bursat dhe masat kundër braktisjes

Transporti është një shërbim i rëndësishëm për Bashkinë Skrapar, për shkak të terrenit malor dhe shpërndarjes së vendbanimeve. Të dhënat e shkollave tregojnë se transporti përdoret kryesisht nga nxënës të shkollave qendrore. Në shkollën “Kahreman Ylli” raportohen 48 nxënës që përdorin transport, 22 vajza dhe 26 djem. Në shkollën “Zylyftar Veleshnja” raportohen 32 nxënës që përdorin transport, 19 vajza dhe 13 djem. Në Potom raportohet 1 nxënës që përdor transport.

Institucioni	Vajza që përdorin transport	Djem që përdorin transport	Gjithsej
“Kahreman Ylli”	22	26	48
“Zylyftar Veleshnja”	19	13	32
Potom	0	1	1
Gjithsej i raportuar	41	40	81

Një bursë jepet për një nxënës në shkollën “Zylyftar Veleshnja” dhe 12 bursa në gjimnazin “Ramiz Aranitasi”, 6 vajza dhe 6 djem.

Shërbimi	Vlera e raportuar
Nxënës që përdorin transport	81
Bursa të raportuara në “Zylyftar Veleshnja”	1
Bursa në gjimnazin “Ramiz Aranitasi”	12
Nxënës në konvikt sipas tabelës së gjimnazit	11
Përfitues konvikti sipas tabelës së stafit të Bashkisë	13

Masat kundër braktisjes duhet të lidhen ngushtë me transportin, bursat, ndihmën ekonomike, ndjekjen e mungesave dhe komunikimin me familjet. Në të dhënat e raportuara, numri i nxënësve në risk braktisjeje është i ulët, por prania e 4 fëmijëve/nxënësve jashtë sistemit kërkon ndjekje të veçantë dhe raportim periodik.

Në vijim të diskutimeve të zhvilluara gjatë konsultimit publik, një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet përdorimit më të mirë të kapaciteteve ekzistuese të konviktit të qytetit. Duke qenë se Bashkia Skrapar ka territor të gjerë, zona rurale të largëta dhe fshatra me numër të ulët nxënësish, konvikti mund të vlerësohet si një mekanizëm mbështetës për rritjen e aksesit në arsim, veçanërisht për nxënësit që përballen me distanca të mëdha nga shkollat qendrore. Për këtë qëllim, gjatë

periudhës së zbatimit të planit do të vlerësohet mundësia e përdorimit më të plotë të kapaciteteve të konviktit, përfshirë edhe rastet e nxënësve mbi 12 vjeç nga zonat rurale, gjithmonë në përputhje me kuadrin ligjor, standardet e sigurisë, mbikëqyrjen e nevojshme, kushtet e akomodimit dhe miratimin e prindërve.⁴

Për rastet kur familjet refuzojnë ambientet ekzistuese të përshtatura për zhvillimin e procesit mësimor, siç u evidentua gjatë konsultimit publik për fëmijët në zonën e Vëseshtës, plani parashikon një qasje të kujdesshme, të bazuar në verifikim, dialog dhe ndërmjetësim. Para se të propozohet ndërtimi i një godine të re, duhet të bëhet vlerësimi teknik i ambientit ekzistues, verifikimi i kushteve të sigurisë dhe përshtatshmërisë, zhvillimi i takimeve me prindërit dhe vlerësimi financiar i alternativave të mundshme. Qëllimi kryesor është garantimi i së drejtës së fëmijëve për arsim, duke gjetur një zgjidhje të pranueshme, të sigurt dhe të zbatueshme për familjet dhe institucionet përgjegjëse.⁵

5.11 Bordi i shkollës, këshilli i prindërve dhe pjesëmarrja

Strukturat pjesëmarrëse funksionojnë në mënyrë të ndryshme nga një shkollë në tjetrën. Në shkollat kryesore në Çorovodë, bordi i shkollës dhe këshilli i prindërve janë të ngritur dhe funksionalë. Në shkollën “Kahreman Ylli” raportohet bord funksional me 3 mbledhje dhe këshill prindërisht me 3 mbledhje. Në shkollën “Zylyftar Veleshnja” bordi dhe këshilli i prindërve janë funksionalë, me nga 2 mbledhje. Në “Ramiz Aranitasi” bordi ka 4 mbledhje, këshilli i prindërve 3 mbledhje dhe komisioni i sigurisë/higjienës rezulton i ngritur.

Institucioni	Bord i ngritur	Bord funksional	Mbledhje bordi	Këshill prindërisht	Mbledhje këshilli	Komision sigurie/higjiene
“Kahreman Ylli”	Po	Po	3	Po	3	Nuk raportohet
“Zylyftar Veleshnja”	Po	Po	2	Po	2	Po
“Ramiz Aranitasi”	Po	Po	4	Po	3	Po

Në shkollat rurale, të dhënat tregojnë se bordet dhe komisionet nuk janë të ngritura ose nuk funksionojnë rregullisht. Në disa raste raportohet vetëm këshilli i prindërve me mbledhje periodike, por jo bordi.

5.12 Problematikat kryesore dhe nevojat për ndërhyrje

Problematikat kryesore të raportuara lidhen me tualetet, rrethimin, sigurinë, kamerat, ujin, energjinë elektrike, izolimin dhe kushtet bazë në shkollat vartëse. Në shkollën “Kahreman Ylli” problematika kryesore është rrethimi i shkollës dhe vendosja e kamerave të sigurisë. Në shënimin e tabelës theksohet se shkollat vartëse kanë problematika me ujin, energjinë elektrike, tualetet, izolimin dhe rrethimin.

⁴ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

⁵ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

Në grupin e shkollave të raportuara nga shkolla “Zylyftar Veleshnja”, problematika më e përsëritur është mungesa ose gjendja e papërshtatshme e tualeteve. Për shkollën “Zylyftar Veleshnja” raportohet se tualetet duhen bërë të reja, jo thjesht riparuar. Për shkolla të vogla si Slatinjë, Zabërzan, Prishtë, Rovicë, Osojë, Potom, Gjorgjovë, Nikollarë, Backë 1, Backë 2 dhe Visockë raportohet mungesë tualeti.

Në gjimnazin “Ramiz Aranitasi”, problematika kryesore lidhet me rrethimin e jashtëm dhe bllokimin e lidhjes me një lokal pranë objektit, çështje që lidhet me sigurinë e shkollës. Gjithashtu, rrethimi nuk është i plotë dhe 3 kamera nuk funksionojnë.

Problematika	Institucionet ku shfaqet	Ndikimi
Mungesë ose gjendje e dobët e tualeteve	Shumë shkolla rurale dhe “Zylyftar Veleshnja”	Higjienë, shëndet, dinjitet i shërbimit
Rrethim i munguar ose i paplotë	“Kahreman Ylli”, “Ramiz Aranitasi”, disa shkolla rurale	Siguri fizike
Mungesë kamerash ose kamera jofunksionale	“Kahreman Ylli”, “Ramiz Aranitasi”, shkolla rurale	Siguri dhe kontroll i mjedisit
Mungesë sinjalistike/ndriçimi/trotuari	Shumë shkolla rurale	Akses i sigurt
Mungesë interneti dhe TIK	Shkolla rurale	Cilësi dhe barazi në mësim
Probleme me ujë, energji dhe izolim	Shkolla vartëse sipas shënimeve të tabelave	Funksionim i përditshëm dhe kushte mësimi
Mungesë dalje emergjence	Shkollat kryesore dhe shumica e ruraleve	Siguri në emergjencë

Prioriteti i parë duhet të jetë zgjidhja e kushteve higjieno-sanitare dhe elementëve bazë të sigurisë. Më pas duhet të vijojnë ndërhyrjet për rrethim, kamera, ndriçim, sinjalistikë, izolim dhe TIK.

5.13 Gjetje kryesore për arsimin bazë dhe të mesëm

Rrjeti i shkollave në Bashkinë Skrapar është i gjerë dhe mbulon një territor të madh, por ka dallime të theksuara ndërmjet qendrës urbane dhe fshatrave. Shkollat në Çorovodë kanë numër më të madh nxënësish, staf më të plotë dhe kushte më të mira, ndërsa shumë shkolla rurale kanë numër shumë të ulët nxënësish dhe kushte më të kufizuara.

Të dhënat tregojnë se arsimi bazë mbështetet në disa shkolla qendrore dhe në një rrjet shkollash të vogla. Këto të fundit mund të mos jenë eficiente nga pikëpamja numerike, por kanë rëndësi të madhe për aksesin në arsim në zonat malore. Për këtë arsye, çdo vendimmarrje për rrjetin duhet të marrë parasysh jo vetëm numrin e nxënësve, por edhe distancën, rrugët, transportin dhe ndikimin social në komunitet.

Një çështje e ngritur gjatë konsultimit publik lidhet me nevojën për rishikimin dhe rikonceptimin e ofertës arsimore në nivel vendor, veçanërisht në drejtim të arsimit profesional. Mungesa e programeve të arsimit profesional në Bashkinë Skrapar mund të ndikojë në largimin e nxënësve pas përfundimit të arsimit bazë drejt qyteteve të tjera, duke rritur kostot për familjet dhe duke mos

shfrytëzuar plotësisht kapacitetet ekzistuese të gjimnazit dhe konviktit. Për këtë arsye, plani parashikon që Bashkia, në bashkëpunim me ZVA-në dhe institucionet përgjegjëse arsimore, të nxisë vlerësimin e mundësisë për hapjen e drejtimeve, moduleve ose formave të arsimit profesional që i përgjigjen nevojave të territorit, ekonomisë lokale dhe interesit të nxënësve.⁶

Gjimnazi “Ramiz Aranitasi” është institucioni qendror për arsimin e mesëm dhe ka rol të rëndësishëm edhe për arsimin me kohë të pjesshme. Prania e konviktit dhe bursave e bën këtë institucion pikë kyçe për vazhdimësinë e arsimit të mesëm, sidomos për nxënësit nga zonat e largëta.

Problematikat më të dukshme lidhen me tualetet, rrethimin, kamerat, daljet e emergjencës, sinjalistikën, ndriçimin, internetin dhe kushtet bazë në shkollat rurale. Në shkollat kryesore ka nevoja më të fokusuar, si përmirësimi i sigurisë, pajisjet TIK dhe mirëmbajtja e ambienteve.

Gjimnazi “Ramiz Aranitasi” duhet të forcohet më tej si institucioni qendror i arsimit të mesëm në Bashkinë Skrapar. Përveç nevojës për përmirësimin e rrethimit të jashtëm dhe rritjen e sigurisë në ambientet shkollore, gjatë konsultimit publik u evidentua edhe nevoja për krijimin e një laborator bashkëkohor të informatikës. Rrethimi dhe elementët e sigurisë duhet të trajtohen si përgjegjësi e lidhur me planifikimin vendor dhe PBA-në, ndërsa pajisja me laborator informatike duhet të formulohet si kërkesë zyrtare dhe e argumentuar pranë MAS/ZVA-së, buxhetit qendror ose programeve/projekteve të posaçme mbështetëse.⁷

Transporti dhe bursat janë instrumente të rëndësishme për ruajtjen e frekuentimit. Raportohen 81 nxënës që përdorin transport, 13 bursa të raportuara në shkollat përkatëse dhe 13 përfutues konvikti sipas tabelës së stafit të bashkisë. Këto shërbime duhet të planifikohen si pjesë e pandarë e sistemit arsimor, jo si masa dytësore.

Të dhënat kanë nevojë për rakordim të mëtejshëm, sidomos për numrin final të nxënësve, nxënësit në konvikt, grupet vulnerabël dhe gjendjen teknike të çdo objekti. Ky rakordim duhet të bëhet çdo vit mes Bashkisë, ZVA-së, shkollave dhe shërbimit social.

5.14 Tabela SWOT për arsimin bazë dhe të mesëm

Pikat e forta	Dobësitë
Rrjeti i shkollave mbulon një territor të gjerë dhe ruan aksesin në shumë fshatra.	Shumë shkolla rurale kanë numër shumë të ulët nxënësish dhe kushte të kufizuara.
Çorovoda ka institucione qendrore me numër më të madh nxënësish dhe staf më të plotë.	Ka mungesë tualetesh ose gjendje të dobët sanitare në disa shkolla.
Gjimnazi “Ramiz Aranitasi” ofron arsim me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.	Në shumë shkolla mungojnë sinjalistika, ndriçimi, rrethimi, kamerat dhe daljet e emergjencës.
Konvikti dhe bursat mbështesin ndjekjen e arsimit të mesëm.	Shkollat rurale kanë akses të kufizuar në internet, kompjuterë dhe laboratorë.

⁶ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

⁷ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

Transporti përdoret nga një numër i konsiderueshëm nxënësish.	Të dhënat nuk janë plotësisht të rakorduara ndërmjet tabelave.
Në shkollat kryesore funksionojnë bordet dhe këshillat e prindërve.	Strukturat pjesëmarrëse janë të dobëta ose mungojnë në shumë shkolla rurale.
Disa shkolla kanë psikolog, mësues ndihmës dhe staf mbështetës.	Ka mungesë materialesh dhe pajisjesh për nxënës me aftësi të kufizuara.
Mundësitë	Rreziqet
PBA-ja mund të përdoret për të lidhur më mirë investimet me nevojat reale të shkollave.	Rënia demografike mund të dobësojë më tej shkollat e vogla rurale.
Konvikti mund të forcohet si mekanizëm për aksesin në arsimin e mesëm.	Distancat dhe kushtet rrugore mund të ndikojnë në frekuentim, sidomos në dimër.
Digjitalizimi dhe pajisja me TIK mund të ulë pabarazitë mes qytetit dhe fshatit.	Mungesa e ndërhyrjeve në tualete, ujë, energji dhe siguri mund të përkeqësojë kushtet e mësimit.
Bashkëpunimi Bashki–ZVA–shërbim social mund të përmirësojë ndjekjen e rasteve në risk.	Nxënësit me mungesa të larta mund të kalojnë në rrezik braktisjeje nëse nuk ndiqen individualisht.
Strukturat e prindërve mund të aktivizohen më mirë në shkollat rurale.	Shkollat me pak nxënës mund të mbeten jashtë vëmendjes nëse planifikimi bazohet vetëm te numrat.
Investimet në siguri, rrethim dhe ndriçim mund të japin ndikim të shpejtë në mirëqenien e nxënësve.	Të dhënat e paplota mund të çojnë në prioritarizim jo të saktë të ndërhyrjeve.

6. Analiza sipas njësive administrative

6.1 Qëllimi i analizës territoriale

Analiza sipas njësive administrative ndihmon për të kuptuar se si shpërndahet shërbimi i arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë Skrapar dhe cilat janë nevojat kryesore në çdo zonë. Për shkak të relievit malor, distancave dhe vendbanimeve të shpërndara, planifikimi i arsimit në Skrapar nuk mund të mbështetet vetëm në numrin e nxënësve, por duhet të marrë parasysh edhe aksesin, transportin, gjendjen e objekteve dhe rolin që shkolla apo kopshti ka për komunitetin.

6.2 Njësia Administrative Çorovodë

Çorovoda është qendra kryesore administrative dhe arsimore e Bashkisë Skrapar. Në këtë njësi përqendrohen institucionet me numrin më të lartë të fëmijëve dhe nxënësve, si kopshtet urbane, shkollat 9-vjeçare “Kahreman Ylli” dhe “Zylyftar Veleshnja”, gjimnazi “Ramiz Aranitasi”, arsimi me kohë të pjesshme dhe konvikti. Kjo e bën Çorovodën njënjë kryesore të shërbimit arsimor për të gjithë bashkinë.

Nevojat kryesore lidhen me mirëmbajtjen e objekteve, përmirësimin e sigurisë, rrethimin, kamerat, daljet e emergjencës, pajisjet TIK dhe mbështetjen e konviktit. Gjimnazi dhe konvikti kanë rëndësi të veçantë për nxënësit që vijnë nga zona të largëta.

6.3 Njësia Administrative Qendër Skrapar

Njësia Qendër Skrapar ka një rrjet të shpërndarë shkollash në fshatra si Store, Mollas, Radësh, Slatinjë, Zabërzan, Prishtë, Rovicë dhe Osojë. Shumë prej këtyre shkollave kanë numër të ulët nxënësish, por mbajnë të hapur aksesin në arsim për fëmijët e zonave rurale pranë Çorovodës.

Problematikat kryesore lidhen me tualetet, ujin, energjinë, rrethimin, ndriçimin, sinjalistikën dhe mungesën e pajisjeve TIK. Në këtë njësi nevojitet vlerësim i kujdesshëm i çdo objekti, sepse disa shkolla kanë pak nxënës, por janë të rëndësishme për të shmangur largësinë e tepërt nga shërbimi arsimor.

6.4 Njësia Administrative Bogovë

Në Bogovë janë evidentuar shkolla si “Myslym Bakerri” Bogovë, “Ilmi Koxhaj” Bargullas dhe “Estref Shabani” Kakrukë. Njësia ka karakter rural dhe turistik, me vendbanime të shpërndara dhe terren kodrinor-malor. Shkollat kanë numër të kufizuar nxënësish, por shërbejnë për mbulimin arsimor të një zone me potencial ekonomik dhe turistik.

Nevojat lidhen kryesisht me mirëmbajtjen e objekteve, kushtet higjieno-sanitare, pajisjet bazë dhe përmirësimin e aksesit. Për shkak të karakterit rural, planifikimi duhet të ruajë shërbimin pranë komunitetit dhe të sigurojë kushte minimale të barabarta me shkollat në qendër.

6.5 Njësia Administrative Gjerbës

Gjerbësi ka një rrjet të gjerë shkollash të vogla në fshatra, si Gjerbës, Terrrovë, Zaloshnjë, Zhepë, Gjogovicë, Grevë, Straficë dhe Dobrenj. Njësia ka territor malor dhe vendbanime të shpërndara, çka e bën më të vështirë organizimin e shërbimit arsimor.

Shumë shkolla kanë numër shumë të ulët nxënësish dhe kërkojnë vëmendje për kushtet bazë: tualete, ujë, energji, izolim, rrethim dhe siguri. Prioritet duhet të jetë ruajtja e aksesit, por edhe vlerësimi teknik i objekteve që përdoren për mësim.

6.6 Njësia Administrative Leshnjë

Në Leshnjë janë evidentuar shkolla si “17 Marsi” Vlushe, “Hetem Guri” Turbohovë dhe “Hekuran Çela” Kapinovë. Kjo njësi ka popullsi të ulët dhe karakter të theksuar rural, ku shkollat funksionojnë me pak nxënës dhe shpesh me kushte të kufizuara infrastrukturore.

Nevojat kryesore lidhen me mirëmbajtjen e ambienteve, sigurimin e kushteve higjieno-sanitare dhe verifikimin e objekteve ku zhvillohet mësimi. Për këtë njësi, planifikimi duhet të jetë realist dhe i lidhur me distancat, sepse mbyllja apo dobësimi i një pike shërbimi mund të ndikojë drejtpërdrejt te frekuentimi.

6.7 Njësia Administrative Potom

Potomi është një nga njësitë më të largëta dhe më malore të Bashkisë Skrapar. Në këtë njësi janë evidentuar shkolla në Potom, Gjorgjovë, Nikollarë, Backë 1, Backë 2 dhe Visockë. Shumë prej tyre kanë numër shumë të ulët nxënësish, por funksioni i tyre është i rëndësishëm për të garantuar aksesin në arsimin bazë.

Problematikat më të shpeshta lidhen me mungesën e tualeteve, mungesën e lavamanëve, mungesën e internetit, mungesën e fikëseve të zjarrit dhe mungesën e elementëve bazë të sigurisë. Për Potomin, transporti, mirëmbajtja periodike dhe siguri i kushteve minimale duhet të jenë pjesë e prioritetëve të planit.

6.8 Njësia Administrative Çepan

Çepani është një njësi me relief malor dhe vendbanime të shpërndara. Edhe pse të dhënat e detajuara të shkollave në anekset e ngarkuara janë më të kufizuara për këtë njësi, profili territorial tregon se aksesit në arsim ndikohet nga distancat dhe kushtet rrugore.

Për këtë arsye, planifikimi për Çepanin duhet të përqendrohet në identifikimin e fëmijëve të moshës shkollore, ndjekjen e frekuentimit, verifikimin e nevojave për transport dhe vlerësimin e gjendjes së objekteve arsimore që mbulojnë këtë zonë.

6.9 Njësia Administrative Zhepë

Zhepë është një njësi malore dhe e largët, me vendbanime të shpërndara dhe lidhje më të vështira me qendrën e bashkisë. Në të dhënat e shkollave, emri Zhepë shfaqet edhe në rrjetin e shkollave të raportuara nga njësia Gjerbës, çka tregon nevojën për rakordim administrativ dhe arsimor të të dhënave.

Nevojat për këtë zonë lidhen me aksesin, transportin, mirëmbajtjen e objekteve dhe sigurimin e kushteve minimale për zhvillimin e mësimin. Për shkak të distancave, çdo ndërhyrje duhet të planifikohet duke marrë parasysh jo vetëm numrin e nxënësve, por edhe kohën reale të lëvizjes dhe mundësinë e familjeve për të ndjekur shkollën rregullisht.

6.10 Njësia Administrative Vëndreshë

Në Vëndreshë janë evidentuar shkolla si “20 Gushti” Therepel, “Caush Cerenishti” Vëndreshë 1, “Ferit Bregu” Vëndreshë 2 dhe “Azbi Kuçi” Vëndreshë 3. Njësia ndodhet relativisht pranë Çorovodës, por ka vendbanime rurale dhe shkolla me numër të ulët nxënësish.

Nevojat kryesore lidhen me mirëmbajtjen, tualetet, sigurinë, rrethimin dhe pajisjet bazë. Për shkak të afërsisë relative me qendrën, kjo njësi mund të përfitojë nga një organizim më i mirë i transportit dhe nga ndërhyrje të shpejta mirëmbajtjeje.

6.11 Tipologjia e nevojave sipas njësive administrative

Nga analiza territoriale dalin disa tipologji të qarta nevojash. Në Çorovodë, prioritet janë siguria, mirëmbajtja, TIK, mbështetja e gjimnazit dhe funksionimi i konviktit. Në njësitë rurale pranë qendrës, si Qendër Skrapar dhe Vëndreshë, nevojat lidhen me mirëmbajtjen, kushtet higjieno-sanitare dhe aksesin e sigurt. Në njësitë më të largëta dhe malore, si Potom, Gjerbës, Zhepë, Leshnjë dhe Çepan, prioritet janë ruajtja e aksesit, transporti, kushtet minimale të objekteve dhe ndjekja e frekuentimit.

Në përgjithësi, nevojat mund të grupohen në katër kategori: kushte bazë dhe higjienë; siguri fizike dhe emergjenca; transport dhe akses; pajisje, TIK dhe materiale didaktike. Kjo ndarje ndihmon që ndërhyrjet të mos planifikohen njësoj për të gjitha njësitë, por sipas problematikave konkrete të territorit.

6.12 Planifikimi territorial të shërbimit arsimor

Planifikimi territorial i arsimit në Bashkinë Skrapar duhet të mbështetet në një qasje të diferencuar. Çorovoda duhet të trajtohet si qendra kryesore e shërbimeve arsimore, ku përqendrohen gjimnazi, konvikti dhe institucionet me numër më të lartë nxënësish. Njësitë rurale duhet të trajtohen me fokus te ruajtja e aksesit, sidomos aty ku shkollat dhe grupet parashkollore janë të vogla, por të domosdoshme për komunitetin.

Për periudhën 2027–2029, Bashkia Skrapar do të orientojë ndërhyrjet drejt përmirësimit të kushteve minimale në çdo njësi administrative, duke vendosur prioritet për tualetet, ujin, energjinë, sigurinë, rrethimin, ndriçimin, transportin dhe pajisjet bazë. Kjo qasje do të ndihmojë që shërbimi arsimor të mos përqendrohet vetëm në qytet, por të mbetet i aksesueshëm edhe për fëmijët dhe nxënësit që jetojnë në zonat më të largëta të bashkisë.

7. Qendra Kulturore e Fëmijëve “Meleq Staravecka”

7.1 Roli i Qendrës Kulturore të Fëmijëve në arsimin parauniversitar

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Meleq Staravecka” është një institucion i rëndësishëm mbështetës i Bashkisë Skrapar për zhvillimin artistik, kulturor, sportiv dhe social të fëmijëve dhe nxënësve. Ajo plotëson procesin arsimor formal që zhvillohet në kopshte dhe shkolla, duke ofruar mundësi për zhvillimin e talenteve, përfshirjen në aktivitete jashtëshkollore, edukimin qytetar, rritjen e vetëbesimit dhe socializimin e fëmijëve.

Në kuadër të Planit të Arsimit Parauniversitar, QKF konsiderohet si një strukturë me rol të veçantë në mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës, në pasurimin e jetës kulturore të fëmijëve dhe në forcimin e lidhjes ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit. Përmes aktiviteteve të saj, Qendra kontribuon në zhvillimin e aftësive krijuese, artistike, sportive, komunikuese dhe bashkëpunuese të fëmijëve.

Në vijim të rekomandimeve të konsultimit publik, roli i Qendrës Kulturore të Fëmijëve duhet të lidhet më ngushtë edhe me nxitjen e leximit dhe kulturës së librit. Përveç kurseve artistike, kulturore dhe sportive, QKF mund të shërbejë si një hapësirë mbështetëse për aktivitete letrare, lexime publike, konkurse eseje, takime me autorë, pasdite poetike dhe veprimtari që nxisin interesin e fëmijëve dhe të rinjve për librin. Në këtë kuadër, krijimi ose funksionalizimi i një biblioteke të qytetit, apo i hapësirave të dedikuara për lexim pranë QKF-së dhe institucioneve arsimore, do të kontribuonte në reduktimin e varësisë nga pajisjet elektronike dhe në zhvillimin kulturor të fëmijëve.⁸

7.2 Kurset dhe pjesëmarrja e fëmijëve

Për vitin shkollor 2025–2026, Qendra Kulturore e Fëmijëve ka organizuar një sërë kursesh artistike, kulturore dhe sportive. Të dhënat e regjistrimeve tregojnë pjesëmarrje të fëmijëve në fusha të ndryshme si dramatizim, valle, kërcim modern, këngë, qëndisje, futboll, bilardo, shah, interpretim, ping-pong dhe lojëra popullore. Këto të dhëna përfaqësojnë **regjistrime në kurse**, jo domosdoshmërisht numër unik fëmijësh, pasi një fëmijë mund të marrë pjesë në më shumë se një kurs.

Nr.	Kursi / fusha e aktivitetit	Numri i regjistrimeve	Fusha kryesore
-----	-----------------------------	-----------------------	----------------

⁸ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

1	Kurs dramatizimi	10	Art skenik / interpretim
2	Kurs valleje	26	Art / trashëgimi kulturore
3	Kërcim modern	25	Art / lëvizje skenike
4	Kurs kënge	12	Muzikë
5	Kurs qëndisjeje	17	Artizanat / trashëgimi
6	Futboll	32	Sport
7	Bilardo	11	Sport / lojë zhvillimore
8	Shah	12	Lojë mendore / logjikë
9	Interpretim	13	Art skenik / komunikim
10	Ping-pong	13	Sport
11	Lojëra popullore	33	Traditë / lojë / sport
	Gjithsej regjistrime	204	

Pjesëmarrja më e lartë rezulton në lojërat popullore, futboll, valle dhe kërcim modern. Kjo tregon interes të lartë të fëmijëve për aktivitete që ndërthurin lëvizjen, sportin, traditën dhe shprehjen artistike. Njëkohësisht, kurset si shah, interpretim, dramatizim dhe këngë kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të komunikimit, përqendrimit, kujtesës, të folurit publik dhe vetëbesimit.

7.3 Kalendar i vjetor i aktiviteteve

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Meleq Staravecka” ka hartuar kalendarin e aktiviteteve për periudhën shtator–qershor, viti shkollor 2025–2026, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Kalendar përfshin aktivitete artistike, kulturore, sportive, letrare, edukative dhe ndërgjegjëse, të lidhura me data të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me nevojat edukative të fëmijëve.

Muaji	Numri i aktiviteteve të planifikuara	Fokusi kryesor i aktiviteteve
Shtator	8	Fillimi i shkollës, paqja, trashëgimia kulturore, sporti, gjuhët
Tetor	7	Muzika, libri, letërsia, interneti, aktivitetet me kopshte dhe gara me biçikleta
Nëntor	6	Të drejtat e fëmijëve, alfabeti, lojërat popullore, festat kombëtare
Dhjetor	6	Rinia, ping-pong, poezi, lojëra, kartolina, festat e fundvitit
Janar	7	Vizatime, qëndisje, sport, recitime, gjuhë amtare, muzikë
Shkurt	5	Bilardo, lojëra popullore, punime dore, Pavarësia e Kosovës, futboll
Mars	6	Poezi, 7–8 Marsi, Dita e Verës, kundër diskriminimit, libri për fëmijë
Prill	6	Autizmi, kënga popullore, krosi pranveror, Dita e Tokës, libri

Maj	5	Ese, sport, Dita e Europës, fjala artistike, familja
Qershor	4	1 Qershori, aktivitete poetike, lojëra sportive, ekspozitë përmbyllëse
Gjithsej	60	Aktivitete artistike, kulturore, sportive dhe edukative

Kalendari tregon se QKF zhvillon një program të qëndrueshëm përgjatë gjithë vitit shkollor, me një mesatare prej rreth **6 aktiviteteve në muaj**. Aktivitetet janë të shpërndara në mënyrë të balancuar ndërmjet fushave artistike, sportive, kulturore, letrare dhe ndërgjegjëse.

7.4 Kontributi i QKF-së në zhvillimin e fëmijëve

Qendra Kulturore e Fëmijëve kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave që nuk kufizohen vetëm te mësimi formal. Përmes kurseve dhe aktiviteteve të saj, fëmijët zhvillojnë:

- aftësi artistike dhe krijuese përmes këngës, valles, kërcimit modern, dramatizimit dhe interpretimit;
- aftësi fizike dhe sportive përmes futbollit, ping-pongut, bilardos, lojërave popullore dhe garave sportive;
- aftësi sociale përmes punës në grup, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete komunitare;
- aftësi qytetare përmes aktiviteteve për paqen, të drejtat e fëmijëve, mjedisin, familjen dhe kundër diskriminimit;
- ruajtjen e identitetit kulturor dhe trashëgimisë përmes valles, lojërave popullore, qëndisjes dhe aktiviteteve për festat kombëtare.

7.5 Bashkëpunimi me shkollat, kopshtet dhe komunitetin

Një element i rëndësishëm i funksionimit të QKF-së është bashkëpunimi me shkollat, kopshtet dhe familjet. Kalendari vjetor parashikon aktivitete të posaçme me fëmijët e kopshteve, nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të arsimit të mesëm, duke e kthyer Qendrën në një hapësirë të hapur për komunitetin arsimor lokal.

Aktivitetet si “Gatuajmë së bashku” me fëmijët e kopshteve, “Miku i vogël i librit”, aktivitetet për Ditën e Librit, lojërat popullore, garat sportive dhe veprimtaritë artistike me shkollat e qytetit krijojnë mundësi për lidhje më të fortë ndërmjet institucioneve arsimore dhe jetës kulturore të bashkisë.

7.6 Çështje për vëmendje dhe nevoja për përmirësim

Për të forcuar më tej rolin e QKF-së në arsimin parauniversitar të Bashkisë Skrapar, është e nevojshme që në vitet në vijim të përmirësohen disa aspekte të planifikimit dhe monitorimit:

Fusha	Çështja për përmirësim	Masa e propozuar
Të dhënat	Të dhënat aktuale paraqesin regjistrime sipas kurseve, por jo gjithmonë numër unik fëmijësh	Të krijohet një regjistër i konsoliduar i fëmijëve pjesëmarrës

Gjithëpërfshirja	Nuk evidentohen të dhëna të ndara për fëmijë nga grupe vulnerabël ose fëmijë me aftësi të kufizuara	Të shtohen fusha për gjininë, moshën, shkollën/kopshtin dhe kategoritë mbështetëse
Monitorimi	Aktivitetet janë të shumta, por nevojitet matje më e qartë e pjesëmarrjes dhe rezultateve	Të përdoret raport mujor me numër pjesëmarrësish, foto, listë prezence dhe rezultate
Lidhja me shkollat	Bashkëpunimi ekziston, por duhet strukturuar në mënyrë të qëndrueshme	Të hartohet plan bashkëpunimi QKF–shkolla–kopshte
Financimi	Aktivitetet kërkojnë mbështetje me materiale, pajisje dhe fonde operative	Të parashikohen zëra të veçantë në PBA për QKF-në

7.7 Drejtimit prioritarë për periudhën e planit

Për periudhën e zbatimit të Planit të Arsimit Parauniversitar, Qendra Kulturore e Fëmijëve duhet të mbështetet për të forcuar rolin e saj si qendër edukative, kulturore dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët e Bashkisë Skrapar. Drejtimit prioritarë janë:

Nr.	Drejtimi prioritar	Veprimet kryesore
1	Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve	Zgjerimi i kurseve, informimi i shkollave/kopshteve, përfshirja e njësive administrative
2	Mbështetja e talenteve	Organizimi i konkurseve, festivaleve, ekspozitave dhe shfaqjeve publike
3	Edukimi përmes sportit	Zhvillimi i kampionateve të futbollit, ping-pongut, bilardos, shahut dhe lojërave popullore
4	Ruajtja e trashëgimisë kulturore	Kurse për valle, qëndisje, lojëra popullore dhe aktivitete për festat kombëtare
5	Gjithëpërfshirja	Pjesëmarrje e fëmijëve nga zona rurale, familje në nevojë dhe fëmijë me aftësi të kufizuara
6	Monitorimi dhe raportimi	Raporte periodike mbi numrin e fëmijëve, aktivitetet, rezultatet dhe nevojat

8. Analiza dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve në kopshte dhe shkolla

8.1 Qëllimi i prioritarizimit

Prioritarizimi i ndërhyrjeve në kopshte dhe shkolla ka për qëllim të ndihmojë Bashkinë Skrapar të orientojë burimet financiare, njerëzore dhe teknike drejt nevojave më të rëndësishme të shërbimit arsimor. Duke qenë se bashkia ka territor të gjerë, relief malor, shumë fshatra dhe një rrjet arsimor me institucione të mëdha në Çorovodë dhe shkolla/grupe të vogla në zona rurale, ndërhyrjet nuk mund të trajtohen të gjitha me të njëjtën urgjencë.

Qëllimi kryesor është që në periudhën 2027–2029 të garantohet fillimisht siguria, higjiena dhe funksionimi bazë i çdo institucioni arsimor, dhe më pas të përmirësohen pajisjet, mjetet didaktike, TIK-u, aksesueshmëria dhe cilësia e mjedisit mësimor. Ky prioritarizim shërben edhe si bazë për lidhjen e planit me buxhetin vendor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm.

8.2 Kriteret e prioritarizimit

Prioritarizimi i ndërhyrjeve është bërë duke marrë në konsideratë nevojat e raportuara nga kopshtet dhe shkollat, numrin e fëmijëve dhe nxënësve përfitues, shkallën e rrezikut, ndikimin në frekuentim dhe mundësinë reale të financimit.

Kriteret kryesore të përdorura janë:

Kriteri	Përshkrimi
Siguria e fëmijëve dhe nxënësve	Përparësi kanë ndërhyrjet që lidhen me rrethimin, daljet e emergjencës, fikëset e zjarrit, kamerat, ndriçimin dhe sinjalistikën.
Higjiena dhe shëndeti	Përparësi kanë tualetet, lavamanët, uji i pijshëm, materialet higjienike dhe kushtet sanitare.
Akresi dhe gjithëpërfshirja	Përparësi kanë institucionet që mbulojnë zona të largëta, fëmijë në nevojë, fëmijë me aftësi të kufizuara ose nxënës që varen nga transporti.
Numri i përfituesve	Ndërhyrjet në institucionet me më shumë fëmijë/nxënës marrin peshë më të madhe, sidomos kur lidhen me sigurinë dhe higjienën.
Roli territorial i institucionit	Shkollat ose kopshtet me pak nxënës, por që janë të vetmet pika shërbimi në një zonë të largët, trajtohen si prioritare për aksesin.
Kostoja dhe mundësia e zbatimit	Ndërhyrjet me kosto të ulët dhe ndikim të shpejtë, si materiale higjienike, sinjalistikë, fikëse zjarri apo riparime të vogla, planifikohen më herët.
Lidhja me PBA-në	Ndërhyrjet që mund të përfshihen në mirëmbajtje, shpenzime operative ose investime kapitale duhet të pasqyrohen në PBA.

8.3 Klasifikimi i ndërhyrjeve sipas urgjencës

Për të lehtësuar planifikimin, ndërhyrjet janë ndarë në katër nivele urgjence.

Niveli	Kategoria	Përshkrimi
P1	Emergjente / shumë prioritare	Ndërhyrje që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë, higjienën, tualetet, ujin, energjinë, rrethimin dhe daljet e emergjencës.
P2	Prioritare	Ndërhyrje që përmirësojnë funksionimin e përditshëm: ndriçim, sinjalistikë, kamera, internet, mobilim bazë, pajisje minimale.
P3	Të rëndësishme	Ndërhyrje për cilësinë e mësimdhënies dhe edukimit: mjete didaktike, laboratorë, kompjuterë, materiale për fëmijë/nxënës me aftësi të kufizuara.
P4	Zhvillimore	Ndërhyrje afatmesme për modernizim, digjitalizim, eficiencë energjie, zgjerim shërbimesh dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.

Ky klasifikim nuk nënkupton që ndërhyrjet e nivelit P3 ose P4 janë të parëndësishme. Ai thjesht ndihmon që, në kushtet e burimeve të kufizuara, Bashkia të nisë me nevojat që prekin sigurinë, shëndetin dhe aksesin bazë.

8.4 Ndërhyrjet prioritare në kopshte

Në arsimin parashkollor, ndërhyrjet më të rëndësishme lidhen me sigurinë, mjetet didaktike, kushtet higjieno-sanitare, aksesin dhe funksionimin e strukturave pjesëmarrëse. Të dhënat tregojnë se kopshtet e raportuara kanë furnizim me ujë dhe energji, por jo të gjitha kanë elementë të plotë sigurie, TIK, materiale didaktike apo struktura funksionale komunitare.

Kopshti / grupi	Nevoja kryesore	Prioriteti
Kopshti Nr. 1, Çorovodë	Plotësim me mjete didaktike, materiale për fëmijë me aftësi të kufizuara, përmirësim i pajisjeve dhe mirëmbajtje e vazhdueshme e shërbimit me ushqim.	P2–P3
K. Ylli	Dalje emergjence, kamera, sinjalistikë, mjete didaktike, tualet PAK dhe përmirësim i elementëve të sigurisë.	P1–P3
Sharovë	Ndriçim, rrethim, sinjalistikë, materiale higjienike, internet, fikëse zjarri, strukturat pjesëmarrëse dhe mjete didaktike.	P1
Kuvajt Nr. 2	Dalje emergjence, kamera, sinjalistikë, mjete didaktike, tualet PAK dhe përmirësim i elementëve të sigurisë.	P2
Grupet rurale në Kalanjas, Therepel, Backë, Potom, Osojë, Zaloshnjë, Gjerbës, Kakrukë, Bogovë	Mbështetje me mjete didaktike, materiale për grupe të përziera, ndjekje të frekuentimit dhe vlerësim i kushteve fizike.	P2–P3

Ndërhyrjet në kopshte duhet të fillojnë me elementët bazë të sigurisë dhe higjienës, sidomos në grupet rurale. Në të njëjtën kohë, duhet të planifikohet një paketë minimale didaktike për çdo kopsht ose grup parashkollor. Mungesa e mjeteve didaktike është problem i përbashkët dhe ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e edukimit të hershëm.

8.5 Ndërhjert prioritare në shkollë

Në shkollë, prioritetet kryesore lidhen me tualetet, rrethimin, kamerat, daljet e emergjencës, ndriçimin, sinjalistikën, ujin, energjinë, izolimin dhe pajisjet TIK. Të dhënat tregojnë dallime të mëdha ndërmjet institucioneve kryesore në Çorovodë dhe shkollave të vogla rurale.

Institucioni / grupi i shkollave	Nevoja kryesore	Prioriteti
“Kahreman Ylli”	Rrethim i shkollës, vendosje kamerash sigurie, dalje emergjence, mirëmbajtje e vazhdueshme.	P1
“Zylyftar Veleshnja”	Rikonstruksion i tualeteve, plotësim i bankave/karrigeve, përmirësim i sigurisë dhe mirëmbajtje.	P1–P2
Gjimnazi “Ramiz Aranitasi”	Rrethim i jashtëm, bllokim i lidhjes së pasigurt me lokalit pranë objektit, riparim kamerash, kompjuterë dhe përmirësim TIK.	P1–P3
Shkollat e vogla në Qendër, Potom dhe njësi të tjera	Tualet, lavamanë, ujë, ndriçim, rrethim, fikëse zjarri, sinjalistikë dhe internet.	P1
Shkollat që funksionojnë në ambiente jo tipike / banesa private	Verifikim teknik, vlerësim sigurie dhe përcaktim i zgjidhjes afatmesme.	P1
Konvikti	Mirëmbajtje e ambienteve, kushte të mira jetese, higjienë, siguri dhe mbështetje për nxënësit nga zonat e largëta.	P1–P2

Në shkollat rurale, mungesa e tualeteve dhe lavamanëve është ndër problematikat më urgjente. Kjo lidhet drejtpërdrejt me shëndetin, dinjitetin dhe frekuencimin e nxënësve. Ndërkohë, në shkollat kryesore në Çorovodë, prioritet janë siguria, rrethimi, kamerat, daljet e emergjencës dhe pajisjet TIK.

8.6 Ndërhjert për siguri, higjienë dhe akses PAK

Siguria dhe higjiena duhet të trajtohen si prioriteti i parë i planit. Në shumë institucione arsimore mungojnë ose janë të pamjaftueshme elementët që lidhen me mbrojtjen fizike, reagimin në emergjencë dhe kushtet sanitare.

Ndërhjert prioritare për siguri janë:

Fusha	Ndërhjerta e nevojshme	Institucionet ku duhet vlerësuar me përparësi
Rrethimi	Rrethim ose plotësim i rrethimit ekzistues	“Kahreman Ylli”, “Ramiz Aranitasi”, Sharovë, shkollë rurale pa rrethim
Kamera sigurie	Vendosje ose riparim kamerash	“Kahreman Ylli”, “K. Ylli”, “Ramiz Aranitasi”, shkollë kryesore
Dalje emergjence	Verifikim dhe krijim daljeje emergjence	Shkollat dhe kopshtet ku raportohet mungesë

Fikëse zjarri	Pajisje me fikëse zjarri dhe kontroll periodik	Kopshtet/grupet rurale dhe shkollat e vogla
Sinjalistikë dhe ndriçim	Vendosje sinjalistike rrugore dhe ndriçim në hyrje	Shkollat dhe kopshtet rurale
Akses PAK	Tualetet PAK, rampa dhe materiale mbështetëse	Kopshtet dhe shkollat kryesore, më pas rrjeti rural

Ndërhyrjet për higjienë duhet të përqendrohen fillimisht te tualetet dhe lavamanët. Në disa shkolla të vogla raportohet mungesë e plotë e tualeteve, ndërsa në “Zylyftar Veleshnja” theksohet se tualetet duhen bërë të reja dhe jo thjesht të riparohen. Në kopshtet e raportuara, Sharova kërkon vëmendje të veçantë për materiale higjienike, ndërsa kopshtet e tjera kanë nevojë për furnizim të rregullt dhe monitorim.

Akresi për fëmijët dhe nxënësit me aftësi të kufizuara duhet të bëhet pjesë e çdo ndërhyrjeje infrastrukturore. Aktualisht, mungesa e tualeteve PAK dhe materialeve të përshtatura tregon se gjithëpërfshirja ka nevojë për masa konkrete, jo vetëm për identifikim të rasteve.

8.7 Ndërhyrjet për pajisje, mobilim, TIK dhe mjete didaktike

Pajisjet, mobilimi, TIK-u dhe mjetet didaktike ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit arsimor. Në kopshte, nevoja më e qartë është mungesa e mjeteve didaktike të mjaftueshme. Në shkolla, sidomos në zonat rurale, mungojnë kompjuterët, laboratorët dhe pajisjet TIK. Në gjimnazin “Ramiz Aranitasi” është raportuar nevojë për kompjuterë, me kosto të përafërt 4,555,000 lekë. Financimet në shkolla duhet të sigurohen përmes Ministrisë së arsimit e cila e ka në kompetencë adresimin e këtyre sfidave.

Fusha	Ndërhyrja	Prioriteti
Mjete didaktike në kopshte	Paketë minimale për çdo kopsht/grup: lodra edukative, forma, numra, tabela, materiale pune.	P2
Mobilim në shkolla	Plotësim bankash, karrigesh dhe tavolinash ku raportohet mungesë.	P2
TIK në shkolla	Kompjuterë, internet, pajisje bazë dhe mirëmbajtje e pajisjeve ekzistuese.	P3
Gjimnazi “Ramiz Aranitasi”	Pajisje me kompjuterë dhe forcim i kapaciteteve TIK.	P3
Materiale për PAK	Pajisje dhe materiale didaktike të përshtatura për fëmijë/nxënës me aftësi të kufizuara.	P2
Regjistër elektronik / të dhëna	Përmirësim i regjistrimit dhe raportimit të të dhënave nga kopshtet dhe shkollat.	P3

Në planifikim, pajisjet nuk duhet të lihen vetëm për vitin e fundit të planit. Një pjesë e tyre mund të realizohen çdo vit me buxhet të vogël, sidomos paketat didaktike për kopshte dhe pajisjet bazë për shkollat rurale.

8.8 Prioritetet territoriale sipas njësive administrative

Prioritetet territoriale ndryshojnë sipas profilit të çdo njësie administrative. Çorovoda ka institucione me numër të lartë nxënësish dhe shërbime qendrore, ndërsa njësitë rurale kanë nevojë për ruajtje të aksesit dhe kushte minimale funksionale.

Njësia administrative	Prioritetet kryesore
Çorovodë	Siguria në shkollat kryesore, rrethimi, kamerat, TIK, mirëmbajtja e gjimnazit dhe konviktit, mbështetja e arsimit me kohë të pjesshme.
Qendër Skrapar	Tualetë, lavamanë, ujë, ndriçim, rrethim, sinjalistikë, mirëmbajtje e shkollave me pak nxënës.
Bogovë	Mirëmbajtje objektësh, kushte higjieno-sanitare, pajisje bazë dhe mbështetje për shkollat/grupet rurale.
Gjerbës	Verifikim teknik i objekteve, tualetë, ujë, energji, rrethim dhe mbështetje për shkollat me numër të ulët nxënësish.
Leshnjë	Kushte minimale funksionale, vlerësim i ambienteve ku zhvillohet mësimi, mirëmbajtje dhe akses.
Potom	Tualetë, lavamanë, internet, fikëse zjarri, ndriçim, transport dhe ruajtje e aksesit në zonat e largëta.
Çepan	Verifikim i të dhënave, ndjekje e frekuentimit, vlerësim i transportit dhe i objekteve arsimore që mbulojnë zonën.
Zhepë	Akses, transport, mirëmbajtje dhe rakordim i të dhënave për mbulimin arsimor të zonës.
Vëndreshë	Tualetë, siguri, rrethim, mirëmbajtje, pajisje bazë dhe organizim më i mirë i shërbimeve mbështetëse.

8.9 Lidhja e ndërhyrjeve me buxhetin dhe PBA-në

Që prioritetet të jenë të zbatueshme, ato duhet të lidhen drejtpërdrejt me buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm. Të dhënat e PBA-së së Bashkisë Skrapar për arsimin bazë/parashkollor dhe arsimin e mesëm përfshijnë paga, sigurime, shpenzime operative, mirëmbajtje, higjienë, energji, ujë, ngrohje, materiale didaktike, ushqim, bursa dhe zëra të tjerë mbështetës.

Megjithatë, në tabelat e ngarkuara, zërat e investimeve kapitale për rikonstrukcion, zgjerim, pajisje kapitale, sisteme ngrohjeje, siguri/aksesueshmëri dhe TIK paraqiten me vlerë 0 për vitet e PBA-së. Kjo tregon se nevojat e evidentuara në kopshte dhe shkolla duhet të përkthehen më qartë në programim buxhetor, sidomos për ndërhyrjet që nuk mund të mbulohen me mirëmbajtje të zakonshme.

Lloji i ndërhyrjes	Zëri buxhetor ku mund të lidhet
Riparime të vogla, bojatisje, dyer/dritare, hidrosanitare të lehta	602 – Mirëmbajtje e zakonshme
Higjienë, detergjentë, dezinfektantë, materiale pastrimi	602 – Higjienë dhe pastrim
Fikëse zjarri, sinjalistikë, materiale sigurie	602 – Siguri dhe emergjenca

Mjete didaktike dhe materiale edukative	602 – Materiale didaktike
Pajisje të vogla, tavolina, karrige, inventar i imët	602 – Pajisje të vogla / inventar i imët
Bursa dhe mbështetje për nxënës	606 – Bursa / mbështetje për nxënës
Rikonstrukcion tualetesh, rrethim, akses PAK, kamera, TIK kapital	230/231 – Shpenzime kapitale / investime

Për periudhën 2027–2029 Bashkia Skrapar do të hartojë një listë vjetore ndërhyrjesh prioritare, të ndarë në mirëmbajtje të zakonshme dhe investime kapitale. Ndërhyrjet P1 duhet të planifikohen të parat dhe të përfshihen në buxhetin vjetor, ndërsa ndërhyrjet më të mëdha, si rikonstrukcioni i tualeteve, rrethimet, kamerat, TIK-u dhe aksesueshmëria PAK, do të përfshihen në PBA ose do të kërkohen përmes financimeve të tjera, përfshirë fondet qendrore, donatorët apo partneritetet.

9. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe rezultatet

9.1 Vizioni i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar

Bashkia Skrapar synon të garantojë një shërbim arsimor parauniversitar të aksesueshëm, të sigurt, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe nxënës, pavarësisht vendbanimit, kushteve sociale apo distancës nga qendra e bashkisë.

Ky vizion mbështetet në nevojën për të ruajtur shërbimin arsimor në një territor të gjerë, me reliev malor, fshatra të shpërndara dhe numër të ulët fëmijësh në disa zona rurale. Për Skraparin, arsimi nuk është vetëm një shërbim publik, por edhe një mënyrë për të mbajtur komunitetet të lidhura me territorin, për të mbështetur familjet dhe për të krijuar kushte më të mira zhvillimi për fëmijët dhe të rinjtë.

Në periudhën 2027–2029, Bashkia Skrapar do të orientojë përpjekjet drejt përmirësimit gradual të kushteve në kopshte, shkolla dhe konvikt, forcimit të sigurisë dhe higjienës, mbështetjes së nxënësve që jetojnë larg qendrave arsimore, pajisjes me mjete didaktike dhe TIK, si dhe ndërtimit të një sistemi më të mirë të dhënash për planifikim dhe vendimmarrje.

9.2 Qëllimi strategjik 1: Përmirësimi i kushteve fizike, sigurisë dhe higjienës

Qëllimi i parë strategjik lidhet me nevojën për të garantuar kushte minimale të sigurta dhe dinjitoze në çdo kopsht, shkollë dhe në konvikt. Analiza e të dhënave tregon se problematikat më të shpeshta lidhen me tualetet, lavamanët, rrethimin, daljet e emergjencës, kamerat, sinjalistikën, ndriçimin, furnizimin me materiale higjienike dhe mirëmbajtjen e objekteve.

Në shkollat dhe kopshtet e qytetit, ndërhyrjet kryesore lidhen më shumë me përmirësimin e sigurisë, kamerave, rrethimit, TIK-ut dhe mirëmbajtjes. Në njësitë rurale, prioritet mbeten tualetet, uji, energjia, rrethimi, fikëset e zjarrit, ndriçimi dhe kushtet bazë për zhvillimin normal të mësimi.

Objektivat kryesore:

1. Të përmirësohen kushtet higjiëno-sanitare në kopshtet dhe shkollat ku janë evidentuar mungesa ose problematika me tualetet, lavamanët dhe materialet higjiënike.
2. Të rritet siguria fizike e institucioneve arsimore përmes rrethimit, ndriçimit, sinjalistikës, kamerave, fikëseve të zjarrit dhe daljeve të emergjencës.
3. Të sigurohet mirëmbajtje periodike për objektet arsimore, me prioritet ndërhyrjet që lidhen me shëndetin, sigurinë dhe funksionimin e përditshëm.
4. Të vlerësohen teknikisht objektet shkollore me problematika të theksuara, sidomos ato që funksionojnë në ambiente të vogla, të vjetra ose jo plotësisht të përshtatura për mësim.

Rezultatet e pritshme:

- Përmirësim i kushteve higjiëno-sanitare në shkollat dhe kopshtet me nevoja më urgjente.
- Rritje e sigurisë në institucionet kryesore arsimore dhe në objektet rurale me mungesa bazë.
- Pajisje graduale e institucioneve me elementë sigurie dhe emergjence.
- Ulje e problematikave të përsëritura që lidhen me mirëmbajtjen e përditshme.

9.3 Qëllimi strategjik 2: Rritja e aksesit dhe gjithëpërfshirjes

Qëllimi i dytë strategjik lidhet me garantimin e aksesit në arsim për të gjithë fëmijët dhe nxënësit, veçanërisht për ata që jetojnë në fshatra të largëta, në familje në nevojë, me aftësi të kufizuara ose në kushte që rrezikojnë frekuentimin e rregullt.

Në Bashkinë Skrapar, aksesit nuk lidhet vetëm me praninë fizike të shkollës apo kopshtit, por edhe me distancën, rrugën, transportin, konviktin, bursat dhe mbështetjen sociale. Për këtë arsye, shërbimi arsimor duhet të planifikohet duke marrë parasysh edhe rolin që kanë shkollat e vogla në zonat rurale, edhe pse ato mund të kenë numër të ulët nxënësish.

Konvikti i gjimnazit “Ramiz Aranitasi” ka rol të rëndësishëm në mbështetjen e nxënësve nga zonat e largëta dhe duhet të trajtohet si pjesë e sistemit të aksesit në arsimin e mesëm. Po ashtu, transporti dhe bursat duhet të lidhen me ndjekjen e frekuentimit dhe me parandalimin e braktisjes shkollore.

Në kuadër të këtij qëllimi strategjik, konvikti duhet të trajtohet si instrument i rëndësishëm për garantimin e aksesit në arsim për nxënësit nga zonat e largëta. Gjatë zbatimit të planit do të vlerësohet mundësia e përdorimit më të mirë të kapaciteteve ekzistuese të konviktit, duke përfshirë nxënësit që përballen me distanca të mëdha ose kushte të vështira transporti. Çdo zgjerim i përdorimit të konviktit duhet të mbështetet në kuadrin ligjor, kapacitetet akomoduese, standardet e sigurisë, mbikëqyrjen, kushtet e ushqimit dhe dakordësinë e prindërve.⁹

Objektivat kryesore:

⁹ Reflektuar bazuar në komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

1. Të ruhet dhe përmirësohet aksesit në arsimin bazë dhe parashkollor në zonat rurale dhe malore.
2. Të forcohet shërbimi i transportit për nxënësit që jetojnë larg institucioneve arsimore.
3. Të mbështeten nxënësit në nevojë përmes bursave, transportit, konviktit dhe masave sociale.
4. Të identifikohen dhe ndiqen fëmijët/nxënësit jashtë sistemit, me mungesa të larta ose në risk braktisjeje.
5. Të përmirësohet aksesueshmëria për fëmijët dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, përfshirë tualetet PAK, rampat dhe materialet mbështetëse.
6. Të vlerësohet përdorimi më i mirë i konviktit si mekanizëm për rritjen e aksesit në arsim për nxënësit nga zonat rurale dhe të largëta, në bashkëpunim me ZVA-në, gjimnazin, drejtuesit e konviktit dhe prindërit.¹⁰

Rezultatet e pritshme:

- Rritje e ndjekjes së rregullt të shkollës dhe kopshtit nga fëmijët në zonat rurale.
- Ulje e rrezikut të braktisjes shkollore përmes ndjekjes më të afërt të rasteve.
- Mbështetje më e mirë për nxënësit që përdorin transport, përfitojnë bursë ose qëndrojnë në konvikt.
- Identifikim më i saktë i fëmijëve dhe nxënësve në nevojë.
- Përmirësim gradual i aksesueshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

9.4 Qëllimi strategjik 3: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit edukativ

Qëllimi i tretë strategjik lidhet me përmirësimin e cilësisë së mjedisit ku fëmijët mësojnë, luajnë dhe zhvillohen. Kushtet fizike janë të domosdoshme, por nuk mjaftojnë. Kopshtet dhe shkollat kanë nevojë për mjete didaktike, mobilim të përshtatshëm, pajisje TIK, laboratorë, materiale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbështetje për stafin.

Në arsimin parashkollor, nevoja më e qartë është pajisja me mjete didaktike. Të gjitha kopshtet e raportuara kanë evidentuar mungesa në këtë drejtim. Në arsimin bazë dhe të mesëm, sidomos në shkollat rurale, mungojnë kompjuterët, laboratorët dhe pajisjet që mbështesin mësimdhënien moderne. Gjimnazi “Ramiz Aranitasi” ka raportuar nevojë të veçantë për kompjuterë, ndërsa shkollat e vogla kanë nevojë për pajisje bazë dhe akses digjital.

Cilësia e mjedisit edukativ lidhet edhe me mënyrën se si organizohet jeta e përditshme në shkollë, përfshirë përdorimin e teknologjisë personale, ushqyerjen, higjienën dhe aktivitetet që ndikojnë në mirëqenien e nxënësve. Gjatë konsultimit publik u propozua që shkollat, në bashkëpunim me ZVA-në dhe këshillat e prindërve, të vlerësojnë vendosjen e rregullave të brendshme për përdorimin e telefonave dhe pajisjeve personale gjatë procesit mësimor, me qëllim rritjen e përqendrimit dhe

¹⁰ Reflektuar/shtuar bazuar në komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

mbrojtjen e nxënësve nga përmbajtjet e papërshtatshme. Bashkia mund të ketë rol mbështetës dhe sensibilizues në këtë proces, pa zëvendësuar kompetencat e shkollave dhe ZVA-së.¹¹

Objektivat kryesore:

1. Të pajisen gradualisht kopshtet dhe grupet parashkollore me paketa minimale didaktike.
2. Të përmirësohet mobilimi bazë në shkollat ku janë evidentuar mungesa në banka, karrige dhe pajisje.
3. Të forcohet përdorimi i TIK-ut në shkollat kryesore dhe të nisë pajisja graduale e shkollave rurale me mjete bazë digjitale.
4. Të mbështetet gjimnazi me pajisje kompjuterike dhe materiale që ndihmojnë mësimdhënien në lëndët shkencore dhe teknologjike.
5. Të sigurohen materiale të përshtatura për fëmijët dhe nxënësit me aftësi të kufizuara.

Rezultatet e pritshme:

- Kopshtet dhe grupet parashkollore pajisen me mjete bazë për zhvillimin e aktiviteteve edukative.
- Shkollat me mungesa në mobilim plotësohen gradualisht me pajisje bazë.
- Rritet përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor.
- Gjimnazi përmirëson kushtet për mësimdhënie moderne.
- Fëmijët dhe nxënësit me nevoja të veçanta përfitojnë më shumë mbështetje në mjedisin arsimor.

9.5 Qëllimi strategjik 4: Forcimi i menaxhimit vendor, të dhënave dhe pjesëmarrjes

Qëllimi i katërt strategjik lidhet me mënyrën se si planifikohet, menaxhohet dhe monitorohet shërbimi arsimor në nivel vendor. Analiza e të dhënave tregoi se disa tabela kanë nevojë për rakordim, veçanërisht për numrin e fëmijëve, nxënësve, grupeve parashkollore, stafit, konviktit dhe kategorive vulnerabël. Kjo tregon se përmirësimi i shërbimit kërkon jo vetëm investime, por edhe të dhëna më të sakta dhe bashkëpunim më të rregullt ndërmjet Bashkisë, ZVA-së, shkollave, kopshteve dhe shërbimit social.

Në këtë qëllim përfshihet edhe funksionimi i bordeve, këshillave të prindërve dhe komisioneve të sigurisë, shëndetit, mirëmbajtjes dhe mjedisit. Në shkollat dhe kopshtet kryesore këto struktura janë më aktive, ndërsa në zonat rurale funksionimi i tyre është më i kufizuar. Për planin vendor, pjesëmarrja e prindërve dhe komunitetit është e rëndësishme jo vetëm për konsultim, por edhe për ndjekjen e frekuentimit, raportimin e problematikave dhe rritjen e përgjegjësisë së përbashkët.

Objektivat kryesore:

¹¹ Reflektuar bazuar në komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

1. Të krijohet një sistem i përditësuar vjetor i të dhënave për kopshtet, shkollat, konviktin, transportin, bursat dhe fëmijët/nxënësit në nevojë.
2. Të rakordohen çdo vit të dhënat ndërmjet Bashkisë, ZVA-së, institucioneve arsimore dhe shërbimit social.
3. Të forcohet roli i bordeve, këshillave të prindërve dhe komisioneve të sigurisë në raportimin e nevojave dhe monitorimin e kushteve.
4. Të lidhet çdo vit plani i ndërhyrjeve me buxhetin vendor dhe PBA-në.
5. Të rritet transparenca për investimet, mirëmbajtjen dhe masat e marra në institucionet arsimore.

Rezultatet e pritshme:

- Bashkia disponon një bazë më të saktë dhe të përditësuar të të dhënave për arsimin.
- Prioritetet e planit përkthehen më qartë në buxhet dhe PBA.
- Raportimi vjetor për arsimin bëhet më i strukturuar dhe më i kuptueshëm.
- Prindërit dhe komuniteti përfshihen më shumë në identifikimin e nevojave dhe ndjekjen e zbatimit.
- Vendimmarrja për arsimin bëhet më transparente dhe më e mbështetur në të dhëna.

9.6 Qëllimi strategjik 5: Forcimi i rolit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve në zhvillimin artistik, kulturor, sportiv dhe social të fëmijëve

Qëllimi i pestë strategjik lidhet me forcimin e rolit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Meleq Staravecka” si një strukturë mbështetëse e rëndësishme për arsimin parauniversitar në Bashkinë Skrapar. Qendra kontribuon në zhvillimin e fëmijëve dhe nxënësve përtej procesit të mësimi formal, duke ofruar mundësi për pjesëmarrje në kurse artistike, kulturore, sportive, letrare, krijuese dhe aktivitete komunitare.

Në një bashki me territor të gjerë dhe me shumë zona rurale, Qendra Kulturore e Fëmijëve ka një rol të veçantë në rritjen e mundësive për socializim, zhvillim talentesh, edukim qytetar dhe përfshirje aktive të fëmijëve në jetën kulturore e sportive të komunitetit. Përmes kurseve të dramatizimit, këngës, valles, kërcimit modern, interpretimit, qëndisjes, futbollit, ping-pongut, shahut, bilardos dhe lojërave popullore, QKF mbështet zhvillimin e aftësive krijuese, fizike, komunikuese dhe sociale të fëmijëve. Lista e kurseve të vitit shkollor 2025–2026 tregon pjesëmarrje të fëmijëve në fusha të ndryshme artistike, kulturore dhe sportive.

Në kuadër të forcimit të rolit të QKF-së, një drejtim i rëndësishëm duhet të jetë nxitja e leximit dhe krijimi i hapësirave funksionale për librin, bibliotekën dhe aktivitetet letrare për fëmijë e të rinj. QKF, në bashkëpunim me Bashkinë, shkollat dhe komunitetin, mund të organizojë aktivitete të rregullta për promovimin e leximit, konkurse letrare, takime tematike, ekspozita libri dhe veprimtari që lidhin arsimin formal me edukimin kulturor. Kjo masë kontribuon në zhvillimin e aftësive gjuhësore,

krijuese dhe qytetare të fëmijëve, si dhe në reduktimin e ekspozimit të tepruar ndaj telefonave dhe pajisjeve digjitale.¹²

Objektivat kryesore:

1. Të forcohet roli i Qendrës Kulturore të Fëmijëve si pjesë mbështetëse e sistemit vendor të arsimit parauniversitar.
2. Të rritet pjesëmarrja e fëmijëve dhe nxënësve në aktivitete artistike, kulturore, sportive dhe edukative, përfshirë edhe fëmijët nga zonat rurale.
3. Të zgjerohet bashkëpunimi i QKF-së me kopshtet, shkollat, gjimnazin, konviktin, prindërit dhe komunitetin.
4. Të mbështeten talentet e fëmijëve në fushën e artit, kulturës, sportit, interpretimit, muzikës, valles, trashëgimisë kulturore dhe lojërave zhvillimore.
5. Të përmirësohet sistemi i regjistrimit, monitorimit dhe raportimit të pjesëmarrjes së fëmijëve në kurse dhe aktivitete, duke evidentuar numrin unik të fëmijëve, moshën, gjininë, shkollën/kopshtin dhe pjesëmarrjen nga grupet në nevojë.

Rezultatet e pritshme:

- QKF forcohet si qendër vendore për zhvillimin artistik, kulturor, sportiv dhe social të fëmijëve.
- Rritet numri i fëmijëve që marrin pjesë në kurse dhe aktivitete jashtëshkollore.
- Bashkëpunimi me shkollat, kopshtet dhe komunitetin bëhet më i strukturuar.
- Aktivitetet e QKF-së lidhen më mirë me kalendarin arsimor, kulturor dhe komunitar të Bashkisë.
- Fëmijët nga zonat rurale dhe grupet në nevojë përfshihen më shumë në aktivitetet kulturore dhe sportive.
- Bashkia disponon të dhëna më të sakta për pjesëmarrjen, rezultatet dhe nevojat e QKF-së.

9.7 Rezultatet e pritshme deri në vitin 2029

Deri në vitin 2029, Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar synon të sjellë përmirësime të dukshme në kushtet, aksesin dhe menaxhimin e shërbimit arsimor në Bashkinë Skrapar. Rezultatet nuk lidhen vetëm me investime fizike, por edhe me mënyrën se si bashkia planifikon, bashkëpunon dhe i përgjigjet nevojave të institucioneve arsimore.

Fusha	Rezultatet e pritshme deri në vitin 2029
Siguria dhe higjiena	Kopshtet, shkollat dhe konvikti kanë kushte më të mira higjieno-sanitare, elementë më të plotë sigurie dhe mirëmbajtje më të rregullt.

¹² Reflektuar bazuar në komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

Infrastruktura	Ndërhyrjet prioritare për tualete, rrethim, ndriçim, sinjalistikë, ujë, energji dhe dalje emergjence janë planifikuar dhe zbatuar gradualisht.
Aksesi	Fëmijët dhe nxënësit në zonat rurale kanë mbështetje më të mirë për ndjekjen e arsimit, përmes transportit, bursave, konviktit dhe ndjekjes së rasteve në risk.
Arsimi parashkollor	Kopshtet dhe grupet parashkollore kanë më shumë mjete didaktike, kushte më të mira funksionimi dhe ndjekje më të mirë të fëmijëve 3–6 vjeç.
Arsimi bazë	Shkollat me problematika bazë përfitojnë ndërhyrje për higjienë, siguri dhe pajisje minimale.
Arsimi i mesëm	Gjimnazi “Ramiz Aranitasi” dhe konvikti forcohen si qendra kryesore për vazhdimësinë e arsimit të mesëm në bashki.
Qendra Kulturore e Fëmijëve	QKF “Meleq Staravecka” forcohet si strukturë mbështetëse për zhvillimin artistik, kulturor, sportiv dhe social të fëmijëve, me kurse më të konsoliduara, kalendar aktiviteteve të rregullt, bashkëpunim më të mirë me shkollat/kopshtet dhe raportim më të saktë të pjesëmarrjes.
TIK dhe mjete didaktike	Rritet gradualisht pajisja me kompjuterë, mjete didaktike dhe materiale mbështetëse për mësimdhënien.
Gjithëpërfshirja	Fëmijët me aftësi të kufizuara, nxënësit nga familje në nevojë dhe nxënësit në zona të largëta identifikohen dhe mbështeten më mirë.
Të dhënat dhe menaxhimi	Bashkia, ZVA-ja dhe institucionet arsimore rakordojnë çdo vit të dhënat dhe përdorin planin si bazë për buxhetimin.
Pjesëmarrja	Bordet, këshillat e prindërve dhe komisionet e sigurisë funksionojnë më mirë dhe kontribuojnë në monitorimin e kushteve.

Zbatimi i këtij vizioni kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet Bashkisë Skrapar, Këshillit Bashkiak, ZVA-së, institucioneve arsimore, shërbimit social, prindërve dhe komunitetit. Vetëm përmes këtij bashkëpunimi, plani mund të kthehet nga një dokument planifikimi në një instrument real për përmirësimin e arsimit parauniversitar në të gjithë territorin e bashkisë.

10. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të arsimit parauniversitar

10.1 Qëllimi i planifikimit buxhetor

Planifikimi buxhetor i arsimit parauniversitar ka për qëllim të lidhë nevojat e evidentuara në kopshte, shkolla dhe konvikt me burimet financiare që Bashkia Skrapar planifikon në buxhetin vjetor dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm. Ky kapitull e trajton buxhetin jo vetëm si tabelë shpenzimesh, por si instrument për të mbështetur zbatimin real të planit vendor.

Analiza e mëparshme tregoi se nevojat më të rëndësishme lidhen me tualetet, higjienën, sigurinë, rrethimin, daljet e emergjencës, kamerat, ndriçimin, pajisjet didaktike, TIK-un, transportin, bursat dhe funksionimin e konviktit. Për këtë arsye, planifikimi buxhetor duhet të sigurojë që këto nevoja të mos mbeten vetëm si konstatime, por të përkthehen në zëra konkretë buxhetorë, me afate dhe përgjegjësi të qarta.

Vlerat e përdorura në këtë kapitull janë në lekë dhe bazohen në të dhënat e plotësuara nga Bashkia Skrapar për vitin 2025, planin e rishikuar 2026 dhe PBA-në 2027–2029.

10.2 Programet buxhetore që lidhen me arsimin parauniversitar

Shërbimi i arsimit parauniversitar në Bashkinë Skrapar lidhet kryesisht me tre linja buxhetore: arsimi bazë dhe parashkollor, arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe konvikti i shkollës së mesme. Programi i parë mbulon pjesën më të madhe të rrjetit arsimor, përfshirë kopshte, grupe parashkollore dhe shkolla të arsimit bazë. Programi i dytë lidhet me funksionimin e gjimnazit “Ramiz Aranitasi”, ndërsa konvikti mbështet nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm dhe kanë nevojë për akomodim.

Programi / shërbimi	2025 realizimi	2026 plani i rishikuar	2027 PBA	2028 PBA	2029 PBA	Totali 2025–2029
Arsimi bazë, përfshirë arsimin parashkollor	69,088,562	82,009,098	79,305,231	79,305,231	80,081,284	389,789,406
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	13,513,376	15,109,069	14,309,210	14,309,210	14,574,115	71,814,980
Konvikti i shkollës së mesme	11,756,455	15,670,822	14,281,312	14,281,312	14,281,312	70,271,213
Gjithsej	94,358,393	112,788,989	107,895,753	107,895,753	108,936,711	531,875,599

Për periudhën e planit 2027–2029, shpenzimet e planifikuara arrijnë në rreth 324.7 milionë lekë. Pjesën më të madhe e zë arsimi bazë dhe parashkollor, për shkak të rrjetit më të gjerë të kopshteve, grupeve parashkollore dhe shkollave 9-vjeçare në territor.

10.3 Shpenzimet për arsimin bazë dhe parashkollor

Arsimi bazë dhe parashkollor përbën programin më të madh buxhetor të lidhur me arsimin parauniversitar në Bashkinë Skrapar. Për vitin 2027 janë planifikuar 79,305,231 lekë, e njëjta vlerë ruhet edhe për vitin 2028, ndërsa në vitin 2029 parashikimi rritet lehtë në 80,081,284 lekë.

Zëri ekonomik	2025 realizimi	2026 plani i rishikuar	2027 PBA	2028 PBA	2029 PBA	Totali 2025–2029
600 – Paga	54,227,109	64,235,366	60,864,720	60,864,720	60,864,720	301,056,635
601 – Sigurime	9,351,452	10,503,423	10,164,408	10,164,408	10,164,408	50,348,099
602 – Shpenzime operative	5,078,479	7,270,309	8,276,103	8,276,103	9,052,156	37,953,150
606 – Transferta	431,522					431,522
Total programi	69,088,562	82,009,098	79,305,231	79,305,231	80,081,284	389,789,406

Paga dhe sigurimet zënë pjesën dominuese të shpenzimeve. Për periudhën 2025–2029, ato përbëjnë rreth 90% të totalit të programit. Kjo tregon se buxheti është kryesisht i orientuar drejt funksionimit të përditshëm dhe mbulimit të kostove të personelit.

Shpenzimet operative rriten nga 5,078,479 lekë në vitin 2025 në 9,052,156 lekë në vitin 2029. Kjo është pozitive, sepse krijon më shumë hapësirë për mirëmbajtje, materiale didaktike, higjienë, energji, ujë, ngrohje, pajisje të vogla dhe aktivitete edukative.

10.4 Shpenzimet për arsimin e mesëm të përgjithshëm

Arsimi i mesëm i përgjithshëm lidhet kryesisht me funksionimin e gjimnazit “Ramiz Aranitasi”, i cili ka rol qendror për të gjithë territorin e Bashkisë Skrapar. Ky institucion ofron arsim me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, ndaj buxheti i tij duhet parë jo vetëm si mbështetje për një shkollë, por si mbështetje për vazhdimësinë e arsimit të mesëm në nivel bashkie.

Zëri ekonomik	2025 realizimi	2026 plani i rishikuar	2027 PBA	2028 PBA	2029 PBA	Totali 2025–2029
600 – Paga	8,322,451	8,805,276	8,100,000	8,100,000	8,100,000	41,427,727
601 – Sigurime	1,385,017	1,580,215	1,352,700	1,352,700	1,352,700	7,023,332
602 – Shpenzime operative	3,241,908	4,723,578	4,856,510	4,856,510	5,121,415	22,799,921
230/231 – Investime	564,000					564,000
Total programi	13,513,376	15,109,069	14,309,210	14,309,210	14,574,115	71,814,980

Në këtë program vërehet se shpenzimet operative kanë peshë më të lartë krahasuar me programin e arsimit bazë/parashkollor. Kjo lidhet me nevojat e gjimnazit për mirëmbajtje, materiale didaktike, energji, ujë, higjienë, pajisje dhe funksionim të përditshëm.

10.5 Shpenzimet për konviktin/QKF

Në Bashkinë Skrapar është i aplikueshëm shërbimi i konviktit të shkollës së mesme. Konvikti ka rëndësi të veçantë, sepse mbështet nxënësit që jetojnë në zona të largëta dhe që përndryshe do ta kishin më të vështirë ndjekjen e arsimit të mesëm. Në të dhënat e stafit, konvikti raportohet me 13 përfitues dhe 13 punonjës të paguar nga Bashkia.

Zëri ekonomik	2025 realizimi	2026 plani i rishikuar	2027 PBA	2028 PBA	2029 PBA	Totali 2025–2029
600 – Paga	8,653,691	10,783,209	10,626,900	10,626,900	10,626,900	51,317,600
601 – Sigurime	1,445,301	1,805,111	1,774,412	1,774,412	1,774,412	8,573,648
602 – Shpenzime operative	1,627,463	3,082,502	1,880,000	1,880,000	1,880,000	10,349,965
606 – Transferta	30,000	0	0	0	0	30,000
Total konvikti	11,756,455	15,670,822	14,281,312	14,281,312	14,281,312	70,271,213

Buxheti i konviktit është i orientuar kryesisht drejt pagave dhe sigurimeve të stafit. Shpenzimet operative mbulojnë elementë të domosdoshëm si ushqimi, energjia, uji, higjiena, kancelaria dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Vetëm për ushqimin e konviktit janë parashikuar 1,000,000 lekë në vit për periudhën 2026–2029.

Në kuadër të mbështetjes së nxënësve që qëndrojnë në konvikt, një çështje që kërkon vlerësim të veçantë është niveli i kuotës ditore të ushqimit. Gjatë konsultimit publik u ngrit shqetësimi se kuota aktuale mund të mos jetë e mjaftueshme për të garantuar cilësinë dhe sasinë e nevojshme të ushqimit për nxënësit. Për këtë arsye, Bashkia, në bashkëpunim me drejtuesin e konviktit, financën dhe institucionet përgjegjëse, duhet të kryejë një vlerësim të kostos reale të ushqimit dhe, nëse rezulton e nevojshme, të përcjellë kërkesë për rishikimin ose indeksimin e kuotës, në përputhje me kuadrin ligjor dhe burimet e mundshme të financimit.¹³

10.6 Shpenzimet operative: mirëmbajtje, higjienë, energji, ujë, ngrohje

Shpenzimet operative janë zëri më i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve të përditshme në kopshte, shkolla dhe konvikt. Ato lidhen drejtpërdrejt me problematikat e evidentuara në analizë: higjiena, tualetet, uji, energjia, ngrohja, mirëmbajtja e zakonshme, siguria dhe funksionimi normal i institucioneve.

Programi / shërbimi	2027 PBA	2028 PBA	2029 PBA	Totali 2027–2029
Arsimi bazë dhe parashkollor	8,276,103	8,276,103	9,052,156	25,604,362
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	4,856,510	4,856,510	5,121,415	14,834,435
Konvikti	1,880,000	1,880,000	1,880,000	5,640,000
Gjithsej operative	15,012,613	15,012,613	16,053,571	46,078,797

Në arsimin bazë dhe parashkollor, zërat kryesorë operacionalë lidhen me mirëmbajtjen e zakonshme, ujin dhe kanalizimet, energjinë elektrike, ushqimin/shërbimin e vaktit, materialet higjienike, ngrohjen dhe materialet didaktike. Në arsimin e mesëm, mirëmbajtja e zakonshme rritet në 1,200,000 lekë në vit për periudhën 2027–2029, ndërsa janë parashikuar fonde edhe për materiale didaktike, siguri, energji, ujë dhe pajisje të vogla.

Këto shpenzime janë të domosdoshme, por nuk mjaftojnë për nevojat që kërkojnë ndërhyrje më të mëdha, si rikonstruksioni i tualeteve, rrethimet, kamerat, rampat, tualetet PAK dhe investimet TIK.

10.7 Shpenzimet për bursa dhe mbështetje sociale

Për bursat dhe mbështetjen për nxënësit, në arsimin bazë/parashkollor është parashikuar 200,000 lekë në vit për periudhën 2026–2029. Në arsimin e mesëm, zëri i bursave/mbështetjes për nxënësit është parashikuar 120,000 lekë në vit për periudhën 2026–2029.

Lloji i mbështetjes	Parashikimi buxhetor
Bursa/mbështetje në arsimin bazë dhe parashkollor	200,000 lekë në vit për 2026–2029
Bursa/mbështetje në arsimin e mesëm	120,000 lekë në vit për 2026–2029
Konvikti	Mbështetje për aksesin në arsimin e mesëm për nxënësit që kanë nevojë për akomodim

Mbështetja sociale për nxënësit nuk duhet të kufizohet vetëm te bursat, por duhet të përfshijë edhe shërbimet që ndihmojnë ndjekjen e rregullt të arsimit, si transporti, konvikti, ushqimi, mbikëqyrja dhe ndjekja e rasteve në risk. Në këtë kuadër, shpenzimet për konviktin dhe ushqimin e nxënësve që vijnë nga zonat rurale duhet të analizohen çdo vit në raport me nevojat reale, koston e jetesës dhe

¹³ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

mundësitë financiare të bashkisë ose të buxhetit qendror. Kjo do të ndihmojë që mbështetja për nxënësit të jetë më e drejtë, më efektive dhe më e lidhur me garantimin e aksesit në arsim.¹⁴

10.8 Shpenzimet për materiale didaktike, TIK dhe pajisje

Analiza e kopshteve dhe shkollave tregoi se mungesa e mjeteve didaktike, kompjuterëve, TIK-ut dhe materialeve mbështetëse është një nga nevojat e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së mjedisit edukativ. Buxheti aktual parashikon disa fonde për materiale didaktike dhe pajisje të vogla, por nuk ka investime kapitale për TIK ose pajisje të mëdha.

Zëri	Arsimi bazë/parashkollor 2027–2029	Arsimi i mesëm 2027–2029
Materiale didaktike	300,000	600,000
Pajisje të vogla / inventar i imët	300,000	1,050,000
Internet / telefoni / komunikim	260,000	300,000

Për arsimin parashkollor, rekomandohet që Bashkia të planifikojë çdo vit një paketë minimale didaktike për çdo kopsht dhe grup parashkollor, sidomos për grupet rurale të përziera. Për shkollat, duhet të planifikohet gradualisht pajisja me kompjuterë, internet dhe mjete bazë, duke filluar nga gjimnazi dhe shkollat që mbulojnë më shumë nxënës. Financimi për shkollat kërkohet të realizohet nga Buxheti qendror, përmes Miistrisë së arsimit, e cila e ka në kopmetencë.

11. Plani i veprimit 2027–2029

11.1 Qëllimi i planit të veprimit

Plani i veprimit 2027–2029 përkthen vizionin, qëllimet strategjike dhe prioritetet e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar në aktivitete konkrete, të zbatueshme dhe të matshme. Ai synon të orientojë punën e Bashkisë Skrapar, institucioneve arsimore, ZVA-së, shërbimeve sociale dhe partnerëve të tjerë drejt përmirësimit gradual të kushteve, aksesit, sigurisë dhe cilësisë së shërbimit arsimor.

Plani merr në konsideratë karakterin territorial të Bashkisë Skrapar: një bashki me reliev malor, fshatra të shpërndara, shkolla të vogla rurale dhe institucione qendrore në Çorovodë, përfshirë gjimnazin dhe konviktin. Për këtë arsye, ndërhyrjet janë ndarë sipas përgjegjësi dhe burimeve të mundshme të financimit.

Bashkia është përgjegjëse kryesisht për mirëmbajtjen, sigurinë, higjienën, shërbimet mbështetëse, stafin ndihmës, transportin vendor, bursat sipas kompetencave, konviktin dhe kushtet fizike të objekteve. Për shkollat, pajisjet pedagogjike, mjetet didaktike, kompjuterët, laboratorët, bibliotekat dhe pajisjet e lidhura drejtpërdrejt me procesin mësimor janë përgjegjësi kryesore e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit/ZVA-së dhe duhet të financohen nga buxheti qendror ose programe të dedikuara kombëtare.

11.2 Matrica e aktiviteteve sipas qëllimeve strategjike

Qëllimi strategjik	Aktiviteti kryesor	Institucioni përgjegjës	Burimi i financimit	Periudha
--------------------	--------------------	-------------------------	---------------------	----------

¹⁴ Reflektuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

Qëllimi 1: Përmirësimi i kushteve fizike, sigurisë dhe higjienës	Hartimi i listës vjetore të ndërrhyrjeve prioritare në kopshte, shkolla dhe konvikt	Bashkia, shkollat, kopshtet, ZVA	Buxhet vendor / PBA	Çdo vit
	Rikonstrukcion ose përmirësim i tualeteve dhe lavamanëve në institucionet me problematika	Bashkia	Buxhet vendor, transfertë, fonde qendrore, donatorë	2027–2029
	Përmirësim i rrethimit, ndriçimit, sinjalistikës dhe kamerave në institucionet prioritare	Bashkia	Buxhet vendor / PBA	2027–2029
	Pajisje me fikëse zjarri dhe kontroll periodik i sigurisë	Bashkia, institucione arsimore	Buxhet vendor	Çdo vit
Qëllimi 2: Rritja e aksesit dhe gjithëpërfshirjes	Përditësim i listës së nxënësve që kanë nevojë për transport	Bashkia, ZVA, shkollat	Buxhet vendor / qendror sipas skemës	Çdo vit
	Mbështetje për nxënësit në konvikt dhe nxënësit përfitues të bursave	Bashkia, shkolla e mesme, ZVA	Buxhet vendor / transfertë specifike / buxhet qendror	2027–2029
	Identifikim dhe ndjekje e fëmijëve/nxënësve jashtë sistemit ose në risk braktisjeje	Bashkia, NJMF, shërbimi social, ZVA, shkollat	Buxhet vendor / burime institucionale	Çdo vit
	Përmirësim gradual i aksesueshmërisë PAK në institucione prioritare	Bashkia, MAS/ZVA sipas kompetencës	Buxhet vendor, qendror, donatorë	2027–2029
Qëllimi 3: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit edukativ	Pajisje e kopshteve me paketa minimale didaktike	Bashkia	Buxhet vendor / PBA	2027–2029
	Evidentim dhe kërkesë zyrtare për kompjuterë, laboratorë, biblioteka dhe mjete didaktike në shkolla	Shkollat, ZVA, Bashkia në rol koordinues	Buxhet qendror / MAS	Çdo vit
	Mirëmbajtje e mobilimit dhe pajisjeve bazë në kopshte dhe ambiente mbështetëse	Bashkia	Buxhet vendor	2027–2029
Qëllimi 4: Forcimi i menaxhimit vendor, të	Krijimi i një baze vjetore të dhënash për	Bashkia, ZVA, shkollat, kopshtet	Buxhet vendor / burime institucionale	Çdo vit

dhënave dhe pjesëmarrjes	arsimin në nivel bashkie			
	Rakordim vjetor i të dhënave për fëmijë, nxënës, staf, transport, bursa dhe konvikt	Bashkia, ZVA, institucione arsimore	Pa kosto të veçantë / buxhet operacional	Çdo vit
	Funksionim i bordeve, këshillave të prindërve dhe komisioneve të sigurisë	Shkollat, kopshtet, ZVA, Bashkia	Burime institucionale	Çdo vit
	Raportim vjetor në Këshillin Bashkiak për zbatimin e planit	Bashkia	Buxhet vendor	Çdo vit
Qëllimi 5: Forcimi i rolit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve në zhvillimin artistik, kulturor, sportiv dhe social të fëmijëve	Konsolidimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve të QKF-së	QKF, Bashkia	Buxhet vendor	Çdo vit
	Zgjerimi i bashkëpunimit të QKF-së me shkollat, kopshtet dhe komunitetin	QKF, Bashkia, shkollat kopshtet	Burime institucionale (Buxhet vendor)	Çdo vit
	Mbështetje me materiale artistike, kulturore dhe sportive për kurset e QKF-së	QKF, shkollat, kopshtet, Bashkia, OJF	Buxhet vendor / PBA / donatorë	2027 – 2029
	Raportim vjetor për aktivitetet, pjesëmarrjen dhe nevojat e QKF-së	Bashkia, QKF	Burime institucionale (Buxhet vendor)	Çdo vit

Aktivitetet për përmirësimin e infrastrukturës dhe sigurisë

Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurisë është fusha më urgjente e planit të veprimit. Analiza tregoi se në disa shkolla dhe kopshte mungojnë ose janë të pamjaftueshme tualetet, lavamanët, rrethimi, daljet e emergjencës, kamerat, sinjalistika, ndriçimi dhe pajisjet bazë të emergjencës.

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Përgjegjës	Burimi i financimit	Afati
1	Vlerësim teknik i objekteve arsimore	Kontroll i gjendjes së kopshteve, shkollave dhe konviktit, me fokus sigurinë, tualetet, rrethimin, emergjencat dhe aksesin	Bashkia, drejtuesit, ZVA	Buxhet vendor	2027
2	Përmirësim i tualeteve dhe lavamanëve	Ndërhyrje në shkollat ku raportohen mungesa ose gjendje e dobët, me prioritet	Bashkia	Buxhet vendor / fonde	2027–2029

		“Zylyftar Veleshnja” dhe shkollat rurale pa tualete		qendrore / donatorë	
3	Rrethim i institucioneve prioritare	Rrethim ose plotësim rrethimi në shkollat/kopshtet ku lidhet me sigurinë e fëmijëve	Bashkia	Buxhet vendor / PBA	2027–2029
4	Kamera dhe ndriçim sigurie	Vendosje/riparim kamerash në “Kahreman Ylli”, “Ramiz Aranitasi” dhe institucione të tjera prioritare	Bashkia	Buxhet vendor / PBA	2027–2028
5	Sinjalistikë dhe akses i sigurt në hyrje	Vendosje sinjalistike rrugore dhe përmirësim i ndriçimit në hyrje të shkollave/kopshteve	Bashkia	Buxhet vendor	2027–2029
6	Fikëse zjarri dhe plan emergjence	Pajisje me fikëse zjarri, kontroll periodik dhe ushtrime të thjeshta emergjence	Bashkia, institucione arsimore	Buxhet vendor	Çdo vit
7	Mirëmbajtje e konviktit	Ndërhyrje për higjienë, siguri, pajisje bazë dhe mirëmbajtje të ambienteve të konviktit	Bashkia, gjimnazi	Buxhet vendor / transfertë	2027–2029

Aktivitetet për aksesin, transportin dhe gjithëpërfshirjen

Në Bashkinë Skrapar, aksesin në arsim ndikohet nga distancat, relievi dhe shpërndarja e fshatrave. Për këtë arsye, transporti, bursat, konvikti dhe ndjekja sociale e rasteve në nevojë janë pjesë e rëndësishme e planit të veprimit.

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Përgjegjës	Burimi i financimit	Afati
1	Hartimi i listës së nxënësve që kanë nevojë për transport	Rakordim i të dhënave nga shkollat, ZVA-ja dhe njësitë administrative	Bashkia, ZVA, shkollat	Buxhet vendor / qendror sipas skemës	Çdo vit
2	Planifikimi i transportit shkollor	Vlerësim i linjave, distancave, numrit të nxënësve dhe koston reale	Bashkia, ZVA	Buxhet vendor / qendror	2027–2029
3	Mbështetje për nxënësit në konvikt	Sigurim i kushteve të përshtatshme për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm dhe qëndrojnë në konvikt	Bashkia, gjimnazi	Buxhet vendor / transfertë specifike	Çdo vit

4	Ndjekja e bursave dhe mbështetjes sociale	Identifikim i nxënësve në nevojë, aplikim dhe ndjekje e përfitimit	Bashkia, ZVA, shkollat, shërbimi social	Buxhet vendor / qendror	Çdo vit
5	Identifikimi i fëmijëve/nxënësve jashtë sistemit	Krahasim i të dhënave të gjendjes civile me listat e shkollave dhe kopshteve	Bashkia, ZVA, NJMF, shkollat	Burime institucionale	Çdo vit
6	Ndjekja e nxënësve me mungesa të larta	Takime me familjet dhe plan individual mbështetjeje për rastet në risk	Shkollat, ZVA, shërbimi social	Burime institucionale	Çdo vit
7	Përmirësim i aksesit PAK	Identifikim i institucioneve ku nevojiten rampa, tualete PAK dhe përshtatje fizike	Bashkia, ZVA	Buxhet vendor / qendror / donatorë	2027–2029
8 ¹⁵	Vlerësim i mundësisë së përdorimit më të mirë të konviktit për nxënës nga zonat rurale, përfshirë nxënës mbi 12 vjeç, sipas kuadrit ligjor dhe kapaciteteve ekzistuese	Bashkia, ZVA, gjimnazi, konvikti, prindërit	Burime institucionale / buxhet vendor sipas rastit	2027	Vlerësim i mundësisë së përdorimit më të mirë të konviktit për nxënës nga zonat rurale, përfshirë nxënës mbi 12 vjeç, sipas kuadrit ligjor dhe kapaciteteve ekzistuese
9 ¹⁶	Informim periodik i prindërve për kushtet, sigurinë, mbikëqyrjen dhe ushqimin në konvikt	Konvikti, Bashkia, gjimnazi	Burime institucionale	Çdo vit	Informim periodik i prindërve për kushtet, sigurinë,

¹⁵ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

¹⁶ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

					mbikëqyrjen dhe ushqimin në konvikt
10 ¹⁷	Verifikim dhe ndërmjetësim për rastet kur familjet refuzojnë ambientin ekzistues të mësimi, përfshirë rastin e Vëseshtës	Bashkia, ZVA, shkolla, NJMF, prindërit	Burime institucionale	2027	Verifikim dhe ndërmjetësim për rastet kur familjet refuzojnë ambientin ekzistues të mësimi, përfshirë rastin e Vëseshtës

Aktivitetet për cilësinë e mjedisit edukativ dhe pajisjet

Për këtë fushë duhet bërë dallim i qartë midis kopshteve dhe shkollave. Në kopshte, Bashkia ka përgjegjësi më të drejtpërdrejtë për pajisje, mobilim dhe materiale të nevojshme për funksionimin e përditshëm. Në shkolla, mjetet didaktike, kompjuterët, laboratorët, bibliotekat dhe pajisjet që lidhen me procesin mësimor janë përgjegjësi kryesore e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit/ZVA-së dhe duhet të financohen nga buxheti qendror.

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Përgjegjës	Burimi i financimit	Afati
1	Paketë minimale didaktike për kopshtet	Pajisje e çdo kopshti/grupi me lodra edukative, forma, numra, tabela, materiale pune dhe mjete zhvillimore	Bashkia	Buxhet vendor / PBA	2027–2029
2	Mobilim bazë në kopshte	Plotësim me tavolina, karrige, rafte dhe pajisje të vogla ku ka mungesa	Bashkia	Buxhet vendor	2027–2029
3	Materiale për fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshte	Pajisje me materiale të përshtatura për fëmijët me nevoja të veçanta	Bashkia, shërbimi social, ZVA	Buxhet vendor / donatorë	2027–2029

¹⁷ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

4	Evidentim i nevojave për TIK në shkolla	Përgatitje e listës së kompjuterëve, laboratorëve, bibliotekave dhe mjeteve didaktike që mungojnë në shkolla	Shkollat, ZVA, Bashkia në rol koordinues	Pa kosto / burime institucional e	Çdo vit
5	Kërkesë zyrtare për financim qendror	Dërgim i listës së nevojave për TIK, laboratorë, biblioteka dhe mjete didaktike pranë MAS/ZVA-së	ZVA, shkollat, Bashkia	Buxhet qendror / MAS	Çdo vit
6	Pajisje TIK për gjimnazin dhe shkollat kryesore	Kompjuterë, laboratorë, materiale laboratorike dhe biblioteka shkollore	MAS/ZVA	Buxhet qendror / projekte kombëtare	2027–2029
7	Mirëmbajtje e pajisjeve ekzistuese	Për shkollat, mirëmbajtja e lehtë e pajisjeve mund të mbështetet nga bashkia kur është pjesë e funksionimit të objektit	Bashkia, shkollat	Buxhet vendor / qendror sipas rastit	Çdo vit
8 ¹⁸	Kërkesë zyrtare për vlerësimin e mundësisë së hapjes së drejtimeve/programeve të arsimit profesional në Bashkinë Skrapar	Bashkia, ZVA, MAS/institucionet përgjegjëse	Buxhet qendror / burime institucional e	2027–2028	Kërkesë zyrtare për vlerësimin e mundësisë së hapjes së drejtimeve/programeve të arsimit profesional në Bashkinë Skrapar
9 ¹⁹	Vlerësim dhe kërkesë për laborator bashkëkohor	Gjimnazi, ZVA, Bashkia në rol koordinues	Buxhet qendror / projekte	2027–2029	Vlerësim dhe kërkesë për laborator bashkëkohor informatike në

¹⁸ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

¹⁹ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

	informatike në Gjimnazin “Ramiz Aranitasi”		kombëtare / donatorë		Gjimnazin “Ramiz Aranitasi”
10²⁰	Nxitja e rregullave të brendshme për përdorimin e telefonave/pajisjeve e personale gjatë procesit mësimor	Shkollat, ZVA, këshillat e prindërve	Burime institucional e	Çdo vit	Nxitja e rregullave të brendshme për përdorimin e telefonave/pajisjeve personale gjatë procesit mësimor
11²¹	Krijimi i hapësirave të përshtatshme për konsumimin e ushqimit të sjellë nga shtëpia në shkollat e qytetit	Bashkia, shkollat, ZVA	Buxhet vendor / mirëmbajtje	2027–2028	Krijimi i hapësirave të përshtatshme për konsumimin e ushqimit të sjellë nga shtëpia në shkollat e qytetit

Shënim: Për shkollat, Bashkia Skrapar nuk mund të marrë përsipër si përgjegjësi kryesore financimin e mjeteve didaktike, kompjuterëve, laboratorëve, bibliotekave dhe laboratorëve të edukimit. Këto janë përgjegjësi të arsimit qendror. Roli i Bashkisë është të mbledhë të dhënat, të koordinojë me ZVA-në, të pasqyrojë nevojat në plan dhe të mbështesë me bashkëfinancim vetëm kur kjo është e mundur dhe e miratuar në buxhet.

Aktivitetet për forcimin e rolit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Meleq Staravecka” është pjesë e rëndësishme e mbështetjes vendore për zhvillimin e fëmijëve dhe nxënësve jashtë procesit formal të mësimi. Ajo ofron mundësi për zhvillim artistik, kulturor, sportiv, social dhe komunitar, duke mbështetur fëmijët në fusha si kënga, vallja, kërcimi modern, dramatizimi, interpretimi, qëndisja, futboll, shah, bilardo, ping-pong dhe lojëra popullore.

Në kuadër të Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar, QKF do të forcohet si strukturë plotësuese e sistemit arsimor vendor, me rol të veçantë në zhvillimin e talenteve, përfshirjen e fëmijëve nga shkollat dhe kopshtet, organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive dhe rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në jetën komunitare.

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Përgjegjës	Burimi i financimit	Afati
1	Konsolidimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve të QKF-së	Hartimi, miratimi dhe zbatimi i kalendarit të aktiviteteve artistike, kulturore, sportive dhe edukative për	QKF, Bashkia	Buxhet vendor	Çdo vit

²⁰ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

²¹ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

		periudhën shtator–qershor			
2	Përditësimi i regjistrit të fëmijëve pjesëmarrës	Krijimi i një regjistri të konsoliduar me numrin unik të fëmijëve, moshën, gjininë, shkollën/kopshtin, kursin dhe njësinë administrative	QKF, Bashkia, shkollat	Burime institucionale	Çdo vit
3	Bashkëpunim i strukturuar me shkollat dhe kopshtet	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me kopshtet, shkollat 9-vjeçare, gjimnazin dhe konviktin	QKF, shkollat, kopshtet, ZVA, Bashkia	Burime institucionale / buxhet vendor	Çdo vit
4	Zgjerimi i pjesëmarrjes së fëmijëve nga njësiti administrative	Identifikimi dhe përfshirja graduale e fëmijëve nga zonat rurale në kurse, gara, shfaqje, aktivitete sportive dhe kulturore	Bashkia, QKF, njësiti administrativ e, shkollat	Buxhet vendor / donatorë	2027–2029
5	Mbështetje me materiale artistike dhe kulturore	Sigurimi i materialeve për dramatizim, interpretim, këngë, valle, kërcim modern, qëndisje, ekspozita dhe aktivitete krijuese	Bashkia, QKF	Buxhet vendor / PBA / donatorë	2027–2029

6	Mbështetje me materiale dhe pajisje sportive	Sigurimi i materialeve bazë për futboll, ping-pong, shah, bilardo, lojëra popullore dhe aktivitete sportive	Bashkia, QKF	Buxhet vendor / PBA / donatorë	2027–2029
7	Organizimi i konkurseve, ekspozitave dhe shfaqjeve publike	Zhvillimi i konkurseve letrare, pasditeve poetike, ekspozitave, koncerteve, shfaqjeve artistike dhe veprimtarive për festa kombëtare e ndërkombëtare	QKF, Bashkia, shkollat	Buxhet vendor	Çdo vit
8	Organizimi i aktiviteteve sportive dhe lojërave zhvillimore	Kampionate dhe gara në futboll, ping-pong, shah, bilardo, lojëra popullore, gara me biçikleta dhe aktivitete sportive ndërmjet shkollave	QKF, shkollat, Bashkia	Buxhet vendor	Çdo vit
9	Përfshirja e fëmijëve nga grupet në nevojë	Evidentimi dhe nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve nga familje në nevojë, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve me talente të veçanta	QKF, Bashkia, shërbimi social, shkollat	Buxhet vendor / donatorë	Çdo vit

10	Raportim vjetor për aktivitetet e QKF-së	Përgatitja e raportit me numrin e kurseve, aktivitetëve, pjesëmarrësve, rezultateve, problematikave dhe nevojave për mbështetje	QKF, Bashkia	Burime institucional e	Çdo vit
11	Raportim në Këshillin Bashkiak si pjesë e zbatimit të planit	Përfshirja e rezultateve të QKF-së në raportimin vjetor për zbatimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar	Bashkia, QKF	Burime institucional e	Çdo vit
12 ²²	Nxitja e leximit dhe zhvillimi i aktivitetëve letrare përmes QKF-së dhe bibliotekës/hapësirave të leximit në qytet	QKF, Bashkia, shkollat	Buxhet vendor / donatorë	Çdo vit	Nxitja e leximit dhe zhvillimi i aktivitetëve letrare përmes QKF-së dhe bibliotekës/hapësirave të leximit në qytet
13 ²³	Vlerësim i mundësisë për funksionalizimin e bibliotekës së qytetit si hapësirë edukative për fëmijët dhe të rinjtë	Bashkia, QKF, institucionet arsimore	Buxhet vendor / donatorë	2027–2029	Vlerësim i mundësisë për funksionalizimin e bibliotekës së qytetit si hapësirë edukative për fëmijët dhe të rinjtë

Aktivitetet për të dhënat, koordinimin dhe pjesëmarrjen

Zbatimi i planit kërkon të dhëna të sakta, bashkëpunim të rregullt dhe përfshirje të komunitetit. Në analizë u evidentua se disa të dhëna kanë nevojë për rakordim, sidomos për numrin e fëmijëve, nxënësve, stafit, transportit, bursave, konviktit dhe grupeve vulnerabël.

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Përgjegjës	Afati
-----	------------	------------	------------	-------

²² Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

²³ Shtuar nga komentet dhe sugjerimet në procesin e konsultimit publik

1	Krijimi i bazës së të dhënave për arsimin	Tabelë e unifikuar për kopshte, shkolla, konvikt, nxënës, staf, infrastrukturë dhe nevoja	Bashkia, ZVA	2027
2	Përditësimi vjetor i të dhënave	Mbledhje e të dhënave çdo vit shkollor dhe rakordim me gjendjen civile/ZVA	Bashkia, shkollat, kopshtet, ZVA	Çdo vit
3	Takim vjetor Bashki–ZVA–drejtues institucionesh	Diskutim i nevojave, prioriteteve, transportit, bursave dhe investimeve	Bashkia, ZVA	Çdo vit
4	Funksionimi i bordeve dhe këshillave të prindërve	Nxitje e mbledhjeve periodike dhe raportimit të problematikave	Shkollat, kopshtet, ZVA	Çdo vit
5	Ngritja/funksionimi i komisioneve të sigurisë	Komisionet të evidentojnë rreziqet dhe nevojat për siguri, higjienë e mirëmbajtje	Institucionet arsimore, Bashkia	2027–2029
6	Raport vjetor për zbatimin e planit	Raportim në Këshillin Bashkiak mbi masat e realizuara dhe nevojat e pambuluara	Bashkia	Çdo vit
7	Lidhja me PBA-në	Përfshirja e ndërhyrjeve prioritare në buxhetin vjetor dhe PBA	Bashkia, Këshilli Bashkiak	Çdo vit

11.3 Plani sipas viteve: 2027, 2028, 2029

Në vitin 2027, fokusi do të jetë te krijimi i bazës së saktë të të dhënave, vlerësimi teknik i objekteve dhe nisja e ndërhyrjeve më urgjente për siguri, higjienë dhe akses.

Fusha	Aktivitetet kryesore 2027
Të dhënat	Krijimi i bazës së të dhënave për kopshte, shkolla, konvikt, transport, bursa dhe nevoja infrastrukturore
Siguria	Vlerësim teknik i institucioneve, pajisje me fikëse zjarri, evidentim i daljeve të emergjencës
Higjiena	Fillimi i ndërhyrjeve në tualetet më problematike dhe sigurimi i materialeve higjienike
Akresi	Hartimi i listës së nxënësve që kanë nevojë për transport dhe konvikt
Kopshtet	Pajisja e kopshteve me paketën e parë minimale didaktike
Shkollat	Përgatitja e kërkesës zyrtare për MAS/ZVA për TIK, laboratorë, biblioteka dhe mjete didaktike
Pjesëmarrja	Ngritja/funksionimi i komisioneve të sigurisë dhe aktivizimi i bordeve/këshillave

Në vitin 2028, do të vijojë zbatimi i ndërhyrjeve të nisura dhe të përqendrohet puna te institucionet me numër më të madh përfituesish dhe me problematika të përsëritura.

Fusha	Aktivitetet kryesore 2028
Infrastruktura	Ndërhyrje në tualete, lavamanë, rrethime dhe ndriçim sipas listës prioritare

Siguria	Vendosje/riparim kamerash, sinjalistikë dhe masa për akses të sigurt në hyrje
Konvikti	Mirëmbajtje dhe përmirësim i kushteve të jetesës, higjienës dhe sigurisë
Kopshtet	Plotësim i mëtejshëm me mjete didaktike, materiale higjienike dhe mobilim bazë
Akresi PAK	Nisja e përshtatjeve në institucionet prioritare
Shkollat	Ndjekje me MAS/ZVA për financimin qendror të pajisjeve, laboratorëve dhe TIK
Menaxhimi	Raport i dytë vjetor për zbatimin dhe rishikim i prioriteteve në PBA

Në vitin 2029, fokusi do të jetë te konsolidimi i ndërhyrjeve, vlerësimi i rezultateve dhe përgatitja e ciklit të ri të planifikimit.

Fusha	Aktivitetet kryesore 2029
Vlerësimi	Vlerësim i zbatimit të planit 2027–2029 dhe identifikim i boshllëqeve të mbetura
Infrastruktura	Përfundim i ndërhyrjeve prioritare në shkolla, kopshte dhe konvikt
Cilësia	Plotësim i paketave didaktike në kopshte dhe ndjekje e financimeve qendrore për shkollat
Akresi	Rishikim i skemës së transportit, bursave dhe funksionimit të konviktit
Pjesëmarrja	Raportim publik dhe konsultim me prindërit, shkollat dhe komunitetin
PBA	Përfshirje e nevojave të mbetura në PBA-në pas vitit 2029

11.4 Treguesit kryesorë të zbatimit

Treguesit e zbatimit do të përdoren për të matur progresin vjetor të planit. Ata duhet të raportohen çdo vit nga Bashkia, në bashkëpunim me ZVA-në dhe institucionet arsimore.

Nr.	Treguesit dhe të dhënat	Njësia matëse	Burimi i të dhënave	Frekuenca
1	Numri i kopshteve dhe shkollave të vlerësuara teknikisht	Numër	Bashkia	Vjetore
2	Numri i institucioneve ku janë përmirësuar tualetet/lavamanët	Numër	Bashkia, institucionet arsimore	Vjetore
3	Numri i institucioneve të pajisura me fikëse zjarri funksionale	Numër	Bashkia, shkollat/kopshtet	Vjetore
4	Numri i institucioneve ku është përmirësuar rrethimi, ndriçimi ose sinjalistika	Numër	Bashkia	Vjetore
5	Numri i kopshteve/grupeve të pajisura me paketa didaktike	Numër	Bashkia, kopshtet	Vjetore
6	Numri i fëmijëve/nxënësve që përfitojnë transport	Numër	Bashkia, ZVA, shkollat	Vjetore
7	Numri i nxënësve që përfitojnë bursë ose mbështetje sociale	Numër	Bashkia, ZVA, shkollat	Vjetore
8	Numri i nxënësve që përfitojnë shërbimin e konviktit	Numër	Bashkia, gjimnazi	Vjetore

9	Numri i fëmijëve/nxënësve jashtë sistemit të identifikuar dhe ndjekur	Numër	Bashkia, NJMF, ZVA	Vjetore
10	Numri i nxënësve me mungesa të larta që ndiqen me plan mbështetjeje	Numër	Shkollat, ZVA, shërbimi social	Vjetore
11	Numri i institucioneve me bord/këshill prindërisht funksional	Numër	Shkollat, kopshtet, ZVA	Vjetore
12	Numri i institucioneve me komision sigurie funksional	Numër	Shkollat, kopshtet, Bashkia	Vjetore
13	Numri i kërkesave zyrtare të dërguara pranë MAS/ZVA për TIK, laboratorë, biblioteka dhe mjete didaktike në shkolla	Numër	Bashkia, ZVA	Vjetore
14	Vlera e fondeve të parashikuara në PBA për arsimin parauniversitar	Lekë	PBA / Drejtoria e Financës	Vjetore
15	Vlera e fondeve të siguruar nga buxheti qendror/donatorë për shkolla	Lekë	Bashkia, ZVA, MAS	Vjetore
16	Numri i nxënësve nga zonat rurale për të cilët është vlerësuar mundësia e akomodimit në konvikt	Numër	Bashkia, ZVA, konvikti	Vjetore
17	Numri i takimeve informuese me prindërit për kushtet dhe sigurinë në konvikt	Numër	Konvikti, Bashkia	Vjetore
18	Raport/kërkesë zyrtare për mundësinë e zhvillimit të arsimit profesional në Bashkinë Skrapar	Po/Jo	Bashkia, ZVA	Vjetore
19	Numri i institucioneve ku janë zëvendësuar/përmirësuar pajisjet hidrosanitare me standarde më të përshtatshme për moshën dhe gjininë	Numër	Bashkia, shkollat	Vjetore
20	Numri i shkollave me rregulla të brendshme për përdorimin e telefonave gjatë procesit mësimor	Numër	Shkollat, ZVA	Vjetore
21	Numri i shkollave me hapësirë të dedikuar ose të përshtatur për konsumimin e ushqimit të sjellë nga shtëpia	Numër	Bashkia, shkollat	Vjetore
22	Numri i kopshteve ku është siguruar paketë didaktike minimale standarde	Numër	Bashkia, kopshtet	Vjetore
23	Numri i fëmijëve të identifikuar/referuar për mbështetje psiko-sociale në arsimin parashkollor	Numër	Kopshtet, ZVA, shërbimi social	Vjetore
24	Numri i aktiviteteve të QKF-së/bibliotekës për nxitjen e leximit dhe kulturës së librit	Numër	QKF, Bashkia	Vjetore

Ky plan veprimi do të rishikohet çdo vit, në përputhje me buxhetin vendor, PBA-në, të dhënat e përditësuara të institucioneve arsimore dhe vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak. Në këtë mënyrë, ai mbetet një instrument praktik dhe i përdorshëm, jo vetëm një pjesë formale e dokumentit të planit.

12. Plani i investimeve kapitale

12.1 Qëllimi i planit të investimeve kapitale

Plani i investimeve kapitale synon të përcaktojë ndërhyrjet kryesore që kërkojnë financim më të madh se mirëmbajtja e zakonshme, me fokus sigurinë, higjienën, aksesueshmërinë dhe përmirësimin e kushteve fizike në kopshte, shkolla dhe konvikte.

Në kopshte, nevojat kryesore lidhen me përmirësimin e sigurisë, plotësimin e rrethimit, ndriçimin, daljet e emergjencës, tualetet PAK dhe pajisjen me mjete bazë didaktike. Prioritet kanë kopshtet dhe grupet që kanë mungesa në siguri, higjienë dhe akses, sidomos në zonat rurale.

Në shkolla, nevojat më urgjente janë rikonstruksioni i tualeteve, vendosja ose plotësimi i rrethimeve, përmirësimi i ndriçimit dhe sinjalistikës, vendosja/riparimi i kamerave, daljet e emergjencës dhe verifikimi teknik i objekteve me problematika. Shkollat rurale kanë nevojë për kushte minimale funksionale, ndërsa shkollat kryesore në Çorovodë kërkojnë më shumë ndërhyrje për siguri dhe modernizim.

Investimet për aksesueshmëri dhe siguri duhet të përfshijnë rampa, tualete PAK, ndriçim, sinjalistikë, rrethime, kamera, fikëse zjarri dhe dalje emergjence. Këto ndërhyrje duhet të trajtohen si prioritare, sepse lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve.

Për shkollat, investimet në TIK, kompjuterë, laboratorë, biblioteka dhe mjete didaktike janë përgjegjësi kryesore e Ministrisë së Arsimit dhe duhet të financohen nga buxheti qendror. Bashkia duhet të evidentojë nevojat, t'i rakordojë me ZVA-në dhe t'i përcjellë zyrtarisht për financim. Për kopshtet, Bashkia mund të planifikojë pajisje bazë didaktike dhe mobilim të vogël për funksionimin e përditshëm.

12.2 Prioritarizimi i investimeve sipas viteve 2027–2029

Viti	Prioritetet kryesore
2027	Vlerësim teknik i objekteve, ndërhyrje urgjente në tualete, siguri, fikëse zjarri, ndriçim dhe rrethim.
2028	Zbatim i ndërhyrjeve kryesore në shkollat/kopshtet me problematika më të mëdha dhe përmirësim i konviktit.
2029	Konsolidim i ndërhyrjeve, plotësim i aksesueshmërisë PAK dhe përgatitje e listës së investimeve për ciklin e ri të PBA-së.

12.3 Burimet e mundshme të financimit

Burimet e mundshme janë buxheti vendor, transfera specifike, buxheti qendror, fondet e Ministrisë së Arsimit, fondet e zhvillimit rajonal, donatorët dhe partneritetet me programe mbështetëse. Për ndërhyrjet që lidhen me shkollat dhe pajisjet pedagogjike, duhet të kërkohet mbështetje nga buxheti qendror.

Bashkia Skrapar do të përfshijë në PBA një listë të qartë investimesh kapitale për arsimin, të ndarë sipas viteve dhe sipas institucioneve.

13. Monitorimi dhe vlerësimi

13.1 Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi kanë për qëllim të ndjekin zbatimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar 2027–2029 dhe të vlerësojnë nëse masat e parashikuara po sjellin përmirësime reale në kopshte, shkolla dhe konvikte.

Monitorimi nuk duhet të jetë vetëm një proces formal raportimi, por një mënyrë për të parë çdo vit çfarë është realizuar, çfarë ka mbetur pezull dhe cilat ndërhyrje duhet të rishikohen. Për Bashkinë Skrapar, kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të territorit të gjerë, shkollave të vogla rurale, nevojave për transport, kushteve të ndryshme infrastrukturore dhe rolit të konviktit për nxënësit nga zonat e largëta.

13.2 Struktura përgjegjëse për monitorimin

Për monitorimin e planit, Bashkia Skrapar do të caktojë një strukturë përgjegjëse brenda administratës, e cila të koordinojë mbledhjen e të dhënave, ndjekjen e aktiviteteve dhe përgatitjen e raportit vjetor.

Në proces duhet të përfshihen:

Struktura / institucioni	Roli në monitorim
Bashkia Skrapar	Koordinon procesin, ndjek buxhetin, investimet, mirëmbajtjen, transportin, konviktin dhe raportimin vjetor
Këshilli Bashkiak	Shqyrton raportin e progresit dhe kërkon llogaridhënie për zbatimin e masave
ZVA	Jep të dhëna për nxënësit, frekuentimin, cilësinë e procesit arsimor dhe nevojat e institucioneve
Kopshtet dhe shkollat	Raportojnë të dhëna për fëmijët/nxënësit, kushtet, problematikat dhe nevojat
Konvikti	Raporton përfituesit, kushtet, shpenzimet dhe nevojat për mirëmbajtje
Shërbimi social dhe NJMF	Raportojnë rastet e fëmijëve/nxënësve në nevojë, në risk braktisjeje ose jashtë sistemit
Bordet dhe këshillat e prindërve	Japin mendim mbi kushtet, sigurinë, frekuentimin dhe nevojat e komunitetit

13.3 Treguesit kryesorë të monitorimit

Treguesit e monitorimit do të jenë të thjeshtë, të matshëm dhe të raportueshëm çdo vit. Ata do të lidhen me objektivat kryesore të planit: sigurinë, higjienën, aksesin, gjithëpërfshirjen, cilësinë e mjedisit edukativ dhe menaxhimin vendor.

Fusha	Treguesi
Infrastruktura	Numri i kopshteve dhe shkollave ku janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje ose rikonstruksioni
Higjiena	Numri i institucioneve ku janë përmirësuar tualetet, lavamanët dhe materialet higjienike

Siguria	Numri i institucioneve të pajisura me rrethim, ndriçim, sinjalistikë, kamera, fikëse zjarri ose dalje emergjence
Akresi PAK në institucionet arsimore	Numri i institucioneve ku janë realizuar përshtatje për fëmijë/nxënës me aftësi të kufizuara
Transporti	Numri i nxënësve që përfitojnë transport
Bursat	Numri i nxënësve që përfitojnë bursë ose mbështetje sociale
Konvikti	Numri i nxënësve përfitues dhe gjendja e kushteve të konviktit
Frekuentimi në shkollë dhe kopshte	Numri i fëmijëve/nxënësve me mungesa të larta dhe numri i rasteve të ndjekura
Fëmijët jashtë sistemit	Numri i rasteve të identifikuar dhe të rikthyera në sistem
Kopshtet	Numri i kopshteve/grupeve të pajisura me mjete didaktike bazë
Pjesëmarrja	Numri i institucioneve me bord, këshill prindërisht dhe komision sigurie funksional
Qendra Kulturore e Fëmijëve	Numri i kurseve aktive të Qendrës Kulturore të Fëmijëve
	Numri i regjistrimeve të fëmijëve në kurset e QKF-së
	Numri i fëmijëve unikë që marrin pjesë në kurset dhe aktivitetet e QKF-së
	Numri i aktiviteteve artistike, kulturore, sportive dhe edukative të zhvilluara nga QKF
	Numri i aktiviteteve të QKF-së të zhvilluara në bashkëpunim me shkollat dhe kopshtet
	Numri i fëmijëve nga zonat rurale që marrin pjesë në aktivitetet e QKF-së
	Numri i fëmijëve nga grupe në nevojë / me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në aktivitetet e QKF-së
	Numri i aktiviteteve të QKF-së për trashëgiminë kulturore, artin, sportin dhe edukimin qytetar
	Vlera e fondeve të parashikuara në PBA për Qendrën Kulturore të Fëmijëve
	Vlera e fondeve të përdorura për materiale artistike, kulturore dhe sportive për QKF-në
	Numri i raporteve vjetore të përgatitura për aktivitetet dhe pjesëmarrjen në QKF
	Përqindja e aktiviteteve të planifikuara në kalendarin e QKF-së që janë realizuar
	Numri i takimeve koordinuese Bashki–ZVA–QKF–institucione arsimore për aktivitetet jashtëshkollore
Buxheti	Vlera e fondeve të planifikuara dhe të realizuara për arsimin në buxhet/PBA

13.4 Raportimi vjetor i progresit

Bashkia Skrapar do të përgatisë një raport vjetor të zbatimit të planit.

Raporti vjetor do të përmbajë:

- masat e realizuara sipas planit të veprimit;

- fondet e planifikuara dhe të shpenzuara;
- ndërhyrjet në kopshte, shkolla dhe konvikt;
- ndryshimet në numrin e fëmijëve dhe nxënësve;
- të dhënat për transportin, bursat dhe konviktin;
- rastet e fëmijëve/nxënësve në risk ose jashtë sistemit;
- problematikat që mbeten të pazgjidhura;
- propozimet për vitin pasardhës.

Raporti vjetor i progresit do të përfshijë edhe statusin e rekomandimeve të dala nga konsultimet publike dhe institucionale, duke treguar cilat rekomandime janë reflektuar në plan dhe janë zbatuar, cilat janë në proces dhe cilat kërkojnë vendimmarrje ose financim të mëtejshëm.²⁴

Raporti do të paraqitet në Këshillin Bashkiak dhe të shërbejë si bazë për diskutimin e buxhetit dhe PBA-së.

13.5 Vlerësimi i ndikimit në akses, siguri dhe cilësi

Në fund të çdo viti, Bashkia dhe partnerët institucionalë do të vlerësojnë jo vetëm nëse aktivitetet janë kryer, por edhe çfarë ndikimi kanë pasur ato. Për shembull, nuk mjafton të raportohet se është bërë një ndërhyrje në tualete; duhet parë nëse janë përmirësuar kushtet higjieno-sanitare. Nuk mjafton të raportohet transporti; duhet parë nëse ai ka ndihmuar frekuentimin.

Vlerësimi do të përqendrohet në tre pyetje kryesore:

1. A është bërë më i sigurt dhe më funksional mjedisi arsimor?
2. A është përmirësuar aksesimi për fëmijët dhe nxënësit në zona të largëta ose në nevojë?
3. A janë përmirësuar kushtet për edukim, mësim dhe zhvillim?

Ky vlerësim do të sigurojë që plani të mos mbetet dokument statik, por të përshtatet çdo vit me nevojat reale.

13.6 Përfshirja e shkollave, kopshteve, ZVA-së dhe komunitetit në monitorim

Monitorimi do të bëhet me pjesëmarrjen e institucioneve arsimore dhe komunitetit. Shkollat dhe kopshtet janë burimi kryesor i informacionit për gjendjen reale të shërbimit, ndërsa prindërit dhe komuniteti mund të ndihmojnë në identifikimin e problematikave që nuk duken gjithmonë në raportet administrative.

ZVA-ja do të jetë partner i rregullt në monitorim, sidomos për të dhënat e nxënësve, frekuentimin, mungesat, cilësinë e procesit arsimor dhe nevojat që lidhen me buxhetin qendror. Bashkia duhet të koordinojë të dhënat vendore me të dhënat e ZVA-së, në mënyrë që vendimmarrja të jetë sa më e saktë.

²⁴ Reflektuar me kontributin dhe komentet në procesin e konsultimit publik

Bordet e shkollave, këshillat e prindërve dhe komisionet e sigurisë do të përfshihen në vlerësimin e kushteve, sigurisë dhe nevojave për mirëmbajtje. Kjo rrit transparencën dhe krijon më shumë përgjegjësi të përbashkët për zbatimin e planit.

14. Rishikimi dhe përshtatja e planit

14.1 Procesi i rishikimit vjetor

Plani i Veprimit shërbimit të Arsimit Parauniversitar do të rishikohet çdo vit, në mënyrë që të mbetet i lidhur me realitetin e bashkisë. Rishikimi do të bëhet pas përfundimit të vitit shkollor dhe para finalizimit të buxhetit të vitit pasardhës.

Rishikimi vjetor do të analizojë:

- numrin e fëmijëve në kopshte;
- numrin e nxënësve në shkollë;
- ndryshimet në frekuentim;
- nevojat për transport dhe bursa;
- gjendjen e konviktit;
- ndërhyrjet e realizuara;
- nevojat që kanë mbetur pa financim;
- ndryshimet në prioritetet infrastrukturore;
- kërkesat për mbështetje nga buxheti qendror.

14.2 Lidhja me procesin e buxhetit dhe PBA-së

Rishikimi i planit duhet të lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e buxhetit vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Çdo vit, masat që rezultojnë më prioritare duhet të përfshihen në PBA, me kosto të përafërt, burim financimi dhe afat zbatimi.

Kjo është e rëndësishme sidomos për ndërhyrjet që kërkojnë investime kapitale, si tualetet, rrethimet, aksesueshmëria PAK, kamerat, rikonstrukcionet, përmirësimet në konvikt dhe ndërhyrjet për siguri. Pa lidhje me PBA-në, plani rrezikon të mbetet një dokument orientues, por jo zbatues.

14.3 Përditësimi i të dhënave dhe prioritetëve

Të dhënat do të përditësohen çdo vit nga Bashkia, ZVA-ja, shkollat dhe kopshtet. Përditësimi do të përfshijë jo vetëm numrin e fëmijëve dhe nxënësve, por edhe gjendjen e objekteve, stafin mbështetës, transportin, bursat, fëmijët në nevojë, nxënësit me mungesa të larta dhe nevojat për ndërhyrje.

Prioritetet mund të ndryshojnë nga viti në vit. Një shkollë që sot ka nevojë për mirëmbajtje të zakonshme mund të ketë më vonë nevojë për ndërhyrje më të thellë. Një kopsht me pak fëmijë mund të bëhet më i rëndësishëm nëse ndryshon numri i fëmijëve në zonë. Për këtë arsye, plani duhet të mbetet i hapur për përditësime të arsyetuara.

14.4 Përshtatja e masave sipas ndryshimeve demografike, financiare dhe infrastrukturore

Bashkia Skrapar ka një territor me vendbanime të shpërndara dhe me ndryshime demografike që ndikojnë drejtpërdrejt në rrjetin arsimor. Rënia ose rritja e numrit të fëmijëve në një zonë duhet të merret në konsideratë gjatë rishikimit të planit.

Masat do të përshtaten edhe me mundësitë financiare. Nëse buxheti vendor nuk mjafton për investime të mëdha, Bashkia do të kërkojë financim nga burime të tjera, si buxheti qendror, programet kombëtare, donatorët ose fondet e zhvillimit rajonal.

Përshtatja do të bëhet edhe kur shfaqen problematika të reja infrastrukturore, si dëmtime objektivësh, nevoja për siguri, ndryshime në transport ose nevoja për ndërhyrje emergjente.

14.5 Miratimi i ndryshimeve nga strukturat vendore

Çdo ndryshim i rëndësishëm në plan do të kalojë përmes strukturave vendore përgjegjëse. Ndryshimet që kanë ndikim në buxhet, investime ose organizimin e shërbimit do të shqyrtohen nga administrata e Bashkisë dhe të miratohen nga Këshilli Bashkiak, sipas procedurave përkatëse.

Për ndryshime më të vogla, si përditësimi i të dhënave, rakordimi i treguesve ose rishikimi i listës së nevojave, mjafton miratimi në nivel teknik dhe përfshirja në raportin vjetor të zbatimit. Ky proces siguron që plani të jetë fleksibël, por edhe i kontrolluar, transparent dhe i lidhur me vendimmarrjen zyrtare të bashkisë.

15. Raportimi dhe transparenca

15.1 Raportimi në Këshillin Bashkiak

Raportimi në Këshillin Bashkiak është një pjesë e rëndësishme e zbatimit të planit. Bashkia do të paraqesë të paktën një herë në vit një raport për progresin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar.

Ky raport do të përfshijë:

- aktivitetet e realizuara;
- ndërhyrjet në kopshte, shkolla dhe konvikt;
- fondet e përdorura;
- masat për transport, bursa dhe mbështetje sociale;
- nevojat që kanë mbetur pa financim;
- ndryshimet e propozuara për vitin pasardhës.

Këshilli Bashkiak do të mund ta përdorë këtë raport për të orientuar vendimmarrjen buxhetore dhe për të ushtruar rolin mbikëqyrës mbi shërbimin arsimor.

15.2 Publikimi i planit dhe raporteve të zbatimit

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar dhe raportet vjetore të zbatimit do të publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Skrapar. Publikimi rrit transparencën dhe u jep prindërve, institucioneve arsimore dhe komunitetit mundësinë të ndjekin se çfarë është planifikuar dhe çfarë është realizuar.

Përveç publikimit të plotë të dokumentit, Bashkia do të përgatisë edhe një përmbledhje të shkurtër për publikun, me gjuhë të thjeshtë, ku të paraqiten prioritetet, investimet dhe masat kryesore të planit.

15.3 Konsultimi me prindërit, shkollat, kopshtet dhe komunitetin

Konsultimi do të jetë pjesë e rregullt e zbatimit të planit. Prindërit, drejtuesit e shkollave dhe kopshteve, mësuesit, edukatorët dhe komuniteti duhet të kenë mundësi të japin mendime për nevojat, problematikat dhe prioritetet.

Konsultimi mund të zhvillohet përmes:

- takimeve me drejtuesit e institucioneve arsimore;
- mbledhjeve me këshillat e prindërve;
- diskutimeve në bordet e shkollave;
- takimeve në njësitë administrative;
- formularëve të thjeshtë për mbledhjen e propozimeve;
- dëgjësive publike për buxhetin dhe PBA-në.

Bashkia do të përdorë procesverbalet e konsultimeve publike, takimet me prindërit dhe diskutimet me institucionet arsimore si burim të drejtpërdrejtë për përditësimin e planit. Rekomandimet e komunitetit do të pasqyrohen në një tabelë ndjekjeje, me statusin “reflektuar”, “në proces”, “kërkon verifikim” ose “jashtë kompetencës së Bashkisë”.²⁵

15.4 Transparenca mbi investimet, mirëmbajtjen dhe shpenzimet

Bashkia do të sigurojë transparencë mbi fondet që përdoren për arsimin. Kjo përfshin shpenzimet për mirëmbajtje, higjienë, energji, ujë, ngrohje, transport, bursa, konvikt dhe investime kapitale.

Për çdo ndërhyrje të rëndësishme, Bashkia do të bëjë të qartë:

- institucioni ku është ndërhyrë;
- lloji i ndërhyrjes;
- vlera e financimit;
- burimi i financimit;
- afati i realizimit;

²⁵ Reflektuar me kontributin dhe komentet në procesin e konsultimit publik

- statusi i zbatimit.

15.5 Mekanizmat e reagimit dhe propozimeve nga komuniteti

Bashkia Skrapar do të krijojë mekanizma të thjeshtë për marrjen e reagimeve dhe propozimeve nga komuniteti. Prindërit, mësuesit, edukatorët dhe nxënësit duhet të kenë mundësi të raportojnë problematika ose të propozojnë ndërhyrje.

Mekanizmat mund të përfshijnë:

- adresë emaili ose kontakt të dedikuar në bashki;
- formular online për problematikat në shkolla dhe kopshte;
- kuti sugjerimesh në institucione arsimore;
- raportim përmes bordeve dhe këshillave të prindërve;
- takime periodike në njësitë administrative.

Çdo propozim ose shqetësim do të regjistrohet, të shqyrtohet dhe, kur është i arsyeshëm, të përfshihet në listën vjetore të nevojave. Në këtë mënyrë, komuniteti bëhet pjesë aktive e përmirësimit të arsimit dhe jo vetëm përfitues i shërbimit.

16. Anekset

Aneks A1. Përmbledhje e Kuadrit ligjor dhe nënligjor për arsimin parauniversitar

Akti / dokumenti	Lidhja me Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	Garanton të drejtën për arsim dhe parimin e barazisë
Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar	Përcakton strukturën, parimet dhe qeverisjen e arsimit parauniversitar
Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar	Përcakton rolin e bashkisë në shërbimet vendore, përfshirë arsimin parashkollor dhe infrastrukturën arsimore
Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar	Rregullon financimin vendor dhe lidhjen e planit me PBA-në
Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”	Orienton mbrojtjen, referimin dhe mbështetjen e fëmijëve në nevojë
Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”	Lidh arsimin me shërbimet sociale dhe mbështetjen e familjeve
Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020	Rregullon funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare
Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	Përcakton numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore
Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018	Rregullon ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor
Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar	Rregullon shërbimin psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar
Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit, 2024	Jep bazë për vlerësimin e cilësisë në arsimin parashkollor
Udhëzimi i përbashkët nr. 658, datë 23.09.2019	Lidhet me mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital
Udhëzimet vjetore për vitin shkollor	Rregullojnë organizimin konkret të vitit shkollor

Aneks A2. Pasqyrë e popullsisë dhe territorit sipas të dhënave territoriale

Njësia / Bashkia	Sipërfaqe	Popullsia gjithsej	Femra	Meshkuj	Burimi	Viti
Skrapar	833 km ²	10450	5331	5419	CENSI i Popullsisë	2023
Çorovodë	3.9 km ²	3918	2028	1890	CENSI i Popullsisë	2023
Qendër	107.3 km ²	2331	1152	1179	CENSI i Popullsisë	2023
Bogovë	86.36 km ²	932	442	490	CENSI i Popullsisë	2023
Vëndreshë	52.5 km ²	806	384	422	CENSI i Popullsisë	2023
Çepan	99.7km ²	583	279	304	CENSI i Popullsisë	2023
Potom	110.1km ²	729	349	380	CENSI i Popullsisë	2023
Leshnje	104.8 km ²	340	162	178	CENSI i Popullsisë	2023
Gjerbës	108.6 km ²	603	294	309	CENSI i Popullsisë	2023
Zhepë	127.9 km ²	508	241	267	CENSI i Popullsisë	2023

Aneks 3. Të dhëna administrative dhe territoriale sipas njësive administrative (burimi - CENSI i Popullsisë viti 2023)

Njësia administrative	Qytet/Fshat	Sipërfaqe km ²	Popullsia gjithsej	Femra	Meshkuj
Çorovodë	Qyteti i Çorovodes dhe 103 Fshatra	833 km ²	10450	5331	5419
	Qytet	3.9 km ²	3918	2028	1890
Qendër	24 Fshatra	107.3 km ²	2331	1152	1179
Bogovë	9 fshatra	86.36 km ²	932	442	490
Vëndreshë	8 fshatra	52.5 km ²	806	384	422
Çepan	14 fshatra	99.7km ²	583	279	304
Potom	11 fshatra	110.1km ²	729	349	380
Leshnje	8 fshatra	104.8 km ²	340	162	178
Gjerbës	14 fshatra	108.6 km ²	603	294	309
Zhepë	15 fshatra	127.9 km ²	508	241	267

Aneks A4. Të dhëna për fëmijët/nxënësit jashtë sistemit ose në risk

Njësia administrative	Mosha/niveli	Fëmijë/nxënës jashtë sistemit - femra	Fëmijë/nxënës jashtë sistemit - meshkuj	Gjithsej	Arsyeja kryesore	Masat e ndërmarra	Institucioni përgjegjës	Burimi
Bashkia Skrapar	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. Qënder	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. BOGOVE	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. Gjerbes	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. Vëndresh	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. ÇEPAN	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. Potom	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. Leshnje	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar
Nj. A. Zhep	0	0	0	0	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk ka pas raste	Nuk jane referuar

Tabela e të dhënave për kopshtet

Aneks B. Përmbledhje e të dhënave sipas kopshtit / grupit

Kopshti / grupi	Regjistruar B2	Frekuentojnë B2	Grupe B3	Fëmijë B3	Edukatorë aktualë	Staf ndihmës
Tekst	Numër	Numër	Numër	Numër	Numër	Numër
Backe			1	5		
Bogove			1	3		
Gjebes			1	3		
Kopshti në shkollën "Kahreman Ylli"	31	31	3	31	2	1
Kakruke			1	4		
Kalanjas			1	5		
Kuvajt Nr. 2	31	31			14	1
Nr.1	28	27	3	28	6	3
Osoje			1	3		
Potom			1	7		
Sharove	3	3	1	3	1	0
Therepel			1	6		
Zaloshnje			1	4		

Aneks B1. Identifikimi i kopshtit

Emri i kopshtit	Njësia administrative	Vendbanimi	Qytet/Fshat	Kopsht më vete / grup pranë shkolle	Me ushqim / Pa ushqim	Publik/Privat	Personi që plotëson	Kontakt	Data
NR.1	Corovde	Corovode	Qytet	Me vete	Me ushqim	Publik	Drejtuesi	0692618066	26.06.2026
Kopshti në shkollën “Kahremani Ylli”	Corovode	Corovode	Qytet	Pranë shkolles	Pa ushqim	Publik	Drejtuesi	0692618066	26.06.2026
Sharove	Njesia. Qender	Sharove	Fshat	Me vete	Pa ushqim	Publik	Drejtuesi	0692618066	26.06.2026
Kuvajt Nr 2	Corovode	Skrapar	Qytet	Me vete	Pa ushqim	Publik	Drejtuesi	0697202582	26.06.2026

Aneks B2. Regjistrimi dhe frekuentimi i fëmijëve sipas moshës dhe gjinisë

Emri i kopshtit	Viti shkollor	Mosha (3/4/5/6/Klasë përgatitore)	Të regjistruar femra	Të regjistruar meshkuj	Gjithsej të regjistruar	Frekuentojnë rregullisht femra	Frekuentojnë rregullisht meshkuj	Gjithsej frekuentojnë	Nuk frekuentojnë rregullisht
Kopshti NR .1	2025-2026	3-vjec	2	8	10	2	8	10	
		4-vjec	6	5	11	6	5	11	
		5-vjec	3	4	7	3	3	6	1
Kopshti në shkollën “Kahremani Ylli”	2025-2026	3-vjec	2	7	9	2	7	9	
		4-vjec	2	5	7	2	5	7	
		5-vjec	9	6	15	9	6	15	
Sharove	2025-2026	3-vjec		1	1		1	1	
		4-vjec		1	1		1	1	
		5-vjec		1	1		1	1	
Kopshti Kuvajt Nr 2	2025-2026	3-vjec	0	8	8	0	8	8	
		4-vjec	9	8	17	9	8	17	
		5-vjec	2	4	6	6	4	6	

Aneks B3. Grupet, kapaciteti dhe mbingarkesa

Emri i kopshtit	Tipi i grupit	Nr. grupeve	Fëmijë femra	Fëmijë meshkuj	Gjithsej fëmijë	Kapaciteti maksimal	Mesatarja fëmijë/grup	A tejkalohet standardi?	Nevojë për grup/klasë shtesë
Kopshti Nr.1	Grupi I I-re	1	2	8	10	10	10	Jo	Jo
	Grupi I II-te	1	6	5	11	11	11	Jo	Jo
	Grupi I III-te	1	3	4	7	7	7	Jo	Jo
Kopshti në shkollën “Kahremani Ylli”	Grupi I perzier	2	4	12	16	20	16	Jo	Jo
	Grupi I III-te	1	9	6	15	20	15	Jo	Jo
Sharove	Grupi I perzier	1		3	3	10	3	Jo	Jo
Kuvajt Nr.2	Grupi I I-re	1	0	8	8	25	8	Jo	Jo
	Grupi I II-te	1	9	8	17	10	17	Jo	Jo
	Grupi I III-te	1	2	4	6	25	6	Jo	Jo
Kalanjas	Grupi I perzier	1	2	3					
Therapel	Grupi I perzier	1	4	2	6				
Backe	Grupi I perzier	1	2	3	5				
Potom	Grupi I perzier	1	3	4	7				
Osoje	Grupi I perzier	1	3	0	3				
Zaloshnje	Grupi I perzier	1	1	3	4				
Gjërbes	Grupi I perzier	1	2	1	3				
Kakruke	Grupi I perzier	1	2	2	4				
Bogove	Grupi I perzier	1	2	1	3				

Aneks B4. Fëmijë nga grupe vulnerabël dhe mbështetja sociale

Kategoria: R&E, PAK, ndihmë ekonomike, situatë rruge, të kthyer nga emigracioni, risk braktisjeje, pakica kombëtare.

Emri i kopshtit	Kategoria	Femra të identifikuara	Meshkuj të identifikuar	Gjithsej të identifikuar	Femra që frekuentojnë	Meshkuj që frekuentojnë	Gjithsej frekuentojnë
Kopshti Nr.1	Egjiptian	1		1	1		1

Aneks B5. Stafi i kopshtit dhe nevojat për burime njerëzore

Emri i kopshtit	Edukatorë aktualë	Edukatorë të nevojshëm	Mësues ndihmës aktualë	Mësues ndihmës të nevojshëm	Staf ndihmës aktual	Staf ndihmës i nevojshëm	Psikolog/Punonjës social - shërbim	Fëmijë për edukator	Trajnime gjatë vitit	Nevoja për trajnim
Kopshti Nr.1	6	6	0	0	3	3	0	5	1	Po
Kopshti në shkollën “Kahremani Ylli”	2	2	0	0	1	1	0	15	1	Po
Sharove	1	1	0	0	0	0	0	3	1	Po
Kuvajt Nr.2	14	0	0	1	1	0	0	6	1	Po

Aneks B6. Infrastruktura, kapaciteti fizik dhe mobilimi

Emri i kopshtit	Sipërfaqe totale m2	Sipërfaqe ndërtese m2	Sipërfaqe oborri m2	Nr. klasave	Nr. tavolinave	Nr. karrigeve	Nr. Tualetëve	Nr. lavamanëve	Tualetë të përshtatshme për fëmijë Po/Jo	Tualet PAK Po/Jo	Nevojë për rikonstruksion
Kopshti Nr.1				3	6	30	3	7	Po	Jo	Jo
Kopshti në shkollën “Kahremani Ylli”				2	8	35	2	4	Jo	Jo	Jo
Kuvajt Nr.2	420	260	166	5	20	70	6	5	5		
Sharove											

Aneks B7. Akses, shërbimet bazë dhe siguria

Emri i kopshtit	Akses këmbësor/autom jet	Trotuar në hyrje	Sinjalisti kë rrugore	Ndriçim në hyrje	Rrethim	Ujë i pijshëm	Burimi i ujit	Energji elektrike	Ngrohje	Internet/telefon	Fikëse zjarri	Dalje emergjence	Kamera
Kopshti Nr.1	Te dyja	Po	Jo	Po	Po	Po	Ujesjell es	Po	Qendrore,elektrike	Po	5	Po	2
Kopshti në shkollën “Kahremani Ylli”	Te dyja	Jo	Jo	Po	Po	Po	Ujesjell es	Po	Kaldaje	Po	2	Jo	0
Sharove	Kembësor	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Ujesjell es	Po	Dru	Jo	Jo	Jo	0
Kuvajt Nr.2	Te dyja	Po	Jo	Po	Po	Po	Ujesjell es	Po	Elektrik	Po	Po	Jo	

Aneks B8. Shëndeti, ushqimi, higjiena dhe siguria ushqimore

Emri i kopshtit	Ofron ushqim Po/Jo	Nr. fëmijëve që ushqehen	Fëmijë me kompensim ushqimi	Menu e miratuar Po/Jo	Intoleranca ushqimore nr.	Kontrolle shëndetësore periodike	Vaksinim i dokumentuar	Materiale higjienë të mjaftueshme	Analiza uji
Kopshti Nr.1	Po	28	2	Po	0	Jo gjithmone	Po	Po	Po
Kopshti në shkollën “Kahremani Ylli”	Jo	0	0	Jo	0	Jo gjithmone	Po	Po	Po
Sharove	Jo	0	0	Jo	0	Jo gjithmone	Po	Jo	Po
Kuvajt Nr.2	Jo	0	0	Jo	0	Jo gjithmone	Po	Jo	Po

Aneks B9. Mjete didaktike, pajisje dhe TIK

Emri i kopshtit	Mjete didaktike të mjaftueshme Po/Jo	Lloji mjeteve që mungojnë	Vlera e nevojshme	Kompjuter/tablet për staf	Internet	Përdor regjistër elektronik Po/Jo	Materiale për fëmijë PAK	Burimi financimit
